



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program



Zhvillimi i Shkathësive të **LEXIMIT NË** **KLASAT FILLORE**



BOTIM EKSPERIMENTAL

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (Basic Education Program) të USAID-it të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë



Basic Education Program

Zhvillimi i Shkathtësive të **LEXIMIT NË** **KLASAT FILLORE**

HARTUAR NGA

David Carroll

Jehona Xhaferi

Lektor

Bora Shpuza-Kasapolli

DIZAJNI GRAFIK

indesign

BOTIMI I PARË

Nëntor, 2013

FALËNDERIM

Basic Education Program (Programi i Arsimit Themelor) falënderon të gjithë ata që kontribuan në hartimin e këtij doracaku. Një falënderim i veçantë shkon për grupin bazë të fasilitatorëve, mësuesit dhe përfshirë në grupin punues dhe shkollat përkatëse. Gjithashtu dëshirojmë të shprehim mirënjohje për Karen Wiener për themelimin e strukturës mbi të cilën u bazuan hulumtimet për përmbajtjen e këtij doracaku.

PËRMBAJTJA

Mirë se vini	6
Si mund t'ju ndihmojë ky libër?	7
Si të përdorni ky libër?	8
PJESA 1 - HYRJE	15
1.1 Pse duhet ta ndryshojmë mënyrën se si ua mësojmë leximin nxënësve?	16
1.2 Pengesat në të lexuar: Pse disa fëmijë kanë vështirësi në mësimin e leximit?	18
1.3 Mënyra për t'i tejkaluar pengesat në lexim	20
1.4 Shkrimi	22
1.5 Pengesat e mia: Sfidat për mësimdhënësit e Kosovës	24
1.6 Krijimi i një mjedisi mësimor që nxit leximin	28
1.7 Qendra e leximit në klasë	30
1.8 Përdorimi i TIK-ut për zhvillimin e kompetencave të leximit dhe shkrimit	32
PJESA 2 - KOMPETENCAT THEMELORE TË LEXUESVE TË SUKSESSHËM	35
2.1 Dëgjim Kuptimi	36
2.2 Vetëdija tingullore	39
2.3 Fonetika	42
2.4 Zhvillimi i Rrjedhshmërisë në Lexim	45
2.5 Fjalori fotografik	47
2.6 Lexim-Kuptimi	51
PJESA 3 - LEXIMI FUNKSIONAL	61
Përdorimi i leximit në situata të jetës së përditshme	62
Të kuptuarit e pyetjeve të shkruara	64
PJESA 4 - TË SHKRUARIT	69
Fazat zhvillimore në shkrim	70
Komponentët e shkrimit	71
Mësimdhënia e të shkruarit	73
PJESA 5 - VLERËSIMI I LEXIMIT	79
Vlerësimi formativ dhe diagnostifikues i leximit	80
Vlerësimi i leximit të klasat e ulëta (EGRA)	86
PJESA 6 - PËRFSHIRJA E FAMILJES	89
Çka mund të bëjnë prindërit?	90
Prindërit dhe shkollat punojnë së bashku	90
PJESA 7 - LEXIMI DHE BARAZIA GJINORE	94
Si mund ta promovojmë barazinë gjinore?.....	95
PJESA 8 - AKTIVITETE MËSIMORE PËR KLASËN TUAJ	99
PJESA 9 - BURIME PËR KLASËN TUAJ	146
Pako e leximit - Lista e artikujve	146
Lista e fjalëve kryesore për t'u mësuar në klasën I dhe II	147
Burimet online për lexim dhe shkrim	148
Teknika për krijimin e librave	149
PJESA 10 - REFERENCA	155

Mirë se vini

Leximi është shkathtësia më e rëndësishme që duhet të zhvillojë secili fëmijë gjatë shkollimit. Përveç të qenit shkathtësi themelore jetësore, leximi është thelbësor për nxënien e të gjitha lëndëve të tjera në shkollë. Fëmijët të cilët nuk kanë shkathtësi të mira leximi gjatë nivelit fillor ka shumë mundësi që në të ardhmen të kenë përparim të kufizuar arsimor dhe mundësi të kufizuara ekonomike dhe zhvillimore. Leximi është gjithashtu ushtrim i mirë për mendjen – leximi të shkathtëson trurin dhe rrit aftësinë për të menduar dhe arsyetuar.

Çdo mësimdhënës i arsimit fillor është mësimdhënës i leximit. Ndoshta ky është roli i tyre më i rëndësishëm. Por dëshmitë nga hulumtimet e fundit tregojnë se standardi i leximit në mesin e lexuesve të vegjël nuk është aq i lartë sa do të donim, sidomos në fusha të rëndësishme siç është lexim-kuptimi.

Ekzistojnë shumë faktorë që i kontribuojnë kësaj situatë; secili mësimdhënës do të dëshironte të dinte cilët janë këta faktorë dhe çka mund të bëjë për t'i përmirësuar shkathtësitë e leximit të hershëm.

Ky doracak është dizajnuar për t'u ndihmuar këtyre mësimdhënësve. Ai përshkruan këndvështrimin e konsensusit momental mbi procesin e leximit dhe praktikat më të mira për mësimdhënien e leximit në klasat e hershme të mbështetura me shembuj dhe teknika. Ai gjithashtu ofron udhëzime se si të përkrahen lexuesit me vështirësi në të lexuar dhe mbështet rolin e prindërve në përkrahjen dhe inkurajimin e fëmijëve të tyre.

Nëse jeni duke u marrë me mësimdhënien e leximit dhe dëshironi të mësoni më shumë për vetë natyrën e leximit, si mësohet ai dhe si ua mësojmë të tjerëve, atëherë ky doracak është vend shumë i mirë për të filluar.



Si mund t'ju ndihmojë ky libër?

Ky doracak ka për qëllim të ndihmojë mësime/mësueset/it të zhvillojnë të kuptuarit e tyre mbi leximin dhe mënyrën si t'ua mësojnë të tjerëve. Ai përmbledh hulumtimet e fundit dhe shembujt e praktikave më të mira për të përkrahur mësime/mësueset/it që:

- ta kuptojnë më mirë procesin e të lexuarit dhe komponentët e tij;
- t'i zhvillojnë shkathtësitë për mësimdhënien e leximit në klasat e ulëta dhe të kenë qasje në teknikat dhe materialet të cilat mund të jenë të dobishme;
- të mësojnë si ta monitorojnë përparimin dhe si t'i përdorin informatat nga vlerësimi për t'i planifikuar udhëzimet; dhe
- të jenë më të vetëdijshëm mbi kërkesat për një mjedis të këndshëm për lexim si në shkollë ashtu edhe në shtëpitë e nxënësve.

Libri ofron një model të procesit të leximit të bazuar në konsensus nga hulumtimet e fundit.

- Në vazhdim ai e merr secilin komponent të këtij modeli dhe e shpjegon pse është i rëndësishëm dhe si mund t'u mësohet të tjerëve.
- Në vazhdim ju tregon si ta bëni këtë me shembuj të teknikave të dobishme për mësimdhënien e secilit komponent.
- Në vazhdim shpjegon pse vlerësimi është i rëndësishëm në mësimdhënien e leximit dhe si të vlerësohet leximi në klasat e hershme.
- Në vazhdim duke pasur parasysh të gjitha këto, shpjegon si mund t'i ndihmoni nxënësit që kanë vështirësi dhe si ta dini kur keni nevojë për ndihmën e specialistit.

Ky libër gjithashtu do t'ju ndihmojë të kuptoni rolin thelbësor që mund të luajnë prindërit dhe mënyrat se si shkolla mund t'i ndihmojë dhe angazhojë ata.

Në fund, libri i përmbledh të gjitha mësimet në udhëzime për krijimin e një mjedisi të të nxëniti i cili përkrah zhvillimin e leximit, me shembuj nga shkollat e Kosovës.



Si të përdoret ky libër?

Pjesa 1 e këtij libri është përmbledhje e përmbajtjes kryesore të librit. Ajo i prezanton konceptet që diskutohen në libër në një gjuhë më të thjeshtë.

Pjesa 2 ofron informata më të detajuara dhe e ndan leximin në gjashtë komponentë thelbësorë të cilët i nevojiten një lexuesi të suksesshëm:

- Dëgjim-kuptimi
- Vetëdija tingullore
- Fonetika
- Rrjedhshmëria në lexim
- Njohja e fjalëve; dhe
- Lexim-kuptimi.

Ajo e shoshit secilin komponent me radhë, shpjegon pse janë të rëndësishëm dhe ofron udhëzime për mësimdhënien dhe vlerësimin e secilit element, së bashku me shembuj.

Pjesa 3 diskuton si mund t'iu ndihmojmë nxënësve të zhvillojnë shkathtësi më të larta të leximit për t'iu mundësuar që me anë të leximit të gjejnë informata, t'i përcjellin udhëzimet, të bëjnë hulumtime dhe të zgjidhin probleme.

Pjesa 4 ka të bëjë me zhvillimin e shkathtësisë së shkrimit dhe si mund t'iu ndihmojmë nxënësit të bëhen komunikues kreativë dhe efektivë përmes shkrimit.

Pjesa 5 ofron udhëzime për mënyrat e vlerësimit të shkathtësive të leximit tek nxënësit, të analizohen vështirësitë e tyre dhe të ofrohet përkrahja e përshtatshme për nxënësit e rëndomtë dhe për lexuesit me vështirësi.

Pjesa 6 merret me rolin që luajnë prindërit për t'iu ndihmuar fëmijët të mësojnë të lexojnë. Ai ofron sugjerime dhe shembuj se si shkolla mund të bëhet partner me prindërit për të ndihmuar fëmijët të mësojnë të lexojnë.





Pjesa 7 diskuton çështjet gjinore në kuadër të leximit.

Pjesa 8 ofron teknika praktike të mësimdhënies për t'iu ndihmuar nxënësit tuaj në zhvillimin e kompetencave të leximit dhe shkrimit.

Pjesa 9 ju tregon si t'u qaseni burimeve relevante që janë në dispozicion online për ju dhe nxënësit tuaj.

Në fund, **Pjesa 10** ju informon për burimet që janë shfrytëzuar për hartimin e këtij doracakut dhe ju ofron referenca për lexim të mëtutjeshëm.

Legjenda

	Shembuj / tregime nga shkolla
	Informata shtesë
	Pika thelbësore të rëndësishme
	Vegëza p.sh. www apo shko në faqe numër ..., më shumë informata në pjesën ...

FJALORI I TERMAVE KRYESORË

Parimi alfabetik	Baza e secilit sistem alfabetik të shkrimit (ndryshe nga gjuha kineze dhe japoneze të cilat përdorin sisteme logografike dhe të rrokjeve). Shkronjat dhe kombinimi i shkronjave përfaqësojnë tingujt e gjuhës, duke u bazuar në marrëdhënie sistematike dhe të parashikueshme në mes të shkronjave të shkruara, simboleve dhe fjalëve të thëna.
Vlerësimi për Nxënie (VpN)	VpN, i quajtur edhe vlerësimi formativ, është i integruar në pedagogji. Ai përfshin: përcaktimin e synimeve; marrjen e informatës së shpejtë kthyesë; ofrimin e informatave të menjëhershme për nxënësit; vetë-vlerësimin; dhe vlerësimin e moshatarëve.
Kurrikula Bazë	Kurrikula e Re Bërthamë e Kosovës. Në të leximi është shkathtësia kryesore e komunikimit, së bashku me shkrimin dhe të folurit. Lexuesi i suksesshëm: lexon tekstin me zë; diskuton dhe interpreton atë që ka lexuar; identifikon porosinë, ngjarjen dhe personazhet kryesore të tregimit; identifikon konceptin kryesor në shkrimin faktik; dhe zhvillon strategji të lexim-kuptimit.
Dekodimi	Përdorimi i njohurive të marrëdhënies shkronjë-tingull për t'i shqiptuar saktë fjalët e shkruara. Dekodimi u mundëson fëmijëve t'i shqiptojnë fjalët të cilat nuk i kanë parë të shkruara më parë.
Vlerësimi diagnostifikues (i leximit)	Vlerësimi i nxënësve individualë apo grupeve të vogla, për të vlerësuar komponentët specifikë të leximit, për shembull, shkathtësitë e fonetikës, rrjedhshmërinë orale, apo fjalorin e fjalëve fotografike dhe identifikimi i nevojave.
Disleksia	Vështirësi në mësimin e leximit, germëzimit dhe shkrimit, përkundër inteligjencës së mjaftueshme dhe mësimdhënies së përshtatshme. Fëmijët e diagnostifikuar kanë nevojë për ndihmë të veçantë nga psikologë të trajnuar apo mësimdhënës të specializuar për disleksi.
Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta (EGRA)	Test i leximit për klasat 1-3. Ai është përpiluar fillimisht në SHBA dhe është përshtatur në gjuhën shqipe nga Basic Education Program (BEP)
Leximi funksional	Leximi dhe interpretimi i saktë i materialit të nevojshëm për të funksionuar në mënyrë efektive në shkollë dhe shoqëri; ai mund të përfshijë orare, etiketa, udhëzime, receta, kuponë, reklama, vërejtje, shenja dhe dokumente të tjera
Grafema	Shkronjë e alfabetit, apo kombinim i shkronjave, që përfaqëson një tingull – për shembull b, sh, dhe nj
Libroteka	Bibliotekë online ku mësimdhënësit mund të publikojnë poezi, tregime dhe libra të shkruar nga nxënësit.
Shkrim-leximi	Aftësia për të lexuar dhe shkruar për njohuri dhe interesim, shkrimi koherent dhe mendimi kritik për fjalën e shkruar.
Nisma	Çdo bashkëtingëllore pa zanore në një rrokje. Për shembull, në fjalën "plot", / pl/ është nisma.
Rrjedhshmëria orale	Aftësia për të lexuar mirë me zë. Rrjedhshmëria zakonisht përfshin shpejtësinë, saktësinë dhe metrikën.
Tingulli	Njësi e vogël e zërit që mund të bashkohet për të krijuar një rrokje apo fjalë. Tingujt në rrokje ndahen në nisma dhe rima apo kombinim i të dyjave.

Vetëdija tingullore	Aftësia për të dëgjuar, identifikuar dhe përdorur tingujt që i përbëjnë fjalët e folura – e të cilat mund ta ndryshojnë kuptimin.
Fonetika	Lidhja në mes të grafemave (simbolet e shkronjave) dhe tingujve (njësitë e vogla të të folurit). Në mënyrë që të zotërohet fonetika, personi duhet t'i zotërojë shkronjat e alfabetit dhe t'i lidhë ato me tingujt përkatës.
Vetëdija fonologjike	Aty ku vetëdija tingullore ndërlidhet me tingujt individualë, vetëdija fonologjike përfshin edhe aftësinë për të dëgjuar dhe manipuluar me njësi më të mëdha të tingujve, siç janë rrokjet.
Metrika	Leximi me ritëm, theks dhe intonacion i cili reflekton të folurit e natyrshëm.
Leximi me zë	Teknikë e mësimdhënies ku mësimdhënësi ua lexon tekstin nxënësve me zë përmes tre hapave, duke përfshirë diskutimin dhe reflektimin.
Lexim-kuptimi	Qëllimi kryesor i leximit është të kuptohet ajo që lexohet – jo vetëm për t'i kuptuar informatat faktike në tekst, por edhe për të nxjerrë informata në lidhje me tekstin duke përdorur njohuritë dhe përvojën paraprake.
Rrjedhshmëria në lexim	Rrjedhshmëria në lexim nuk do të thotë se është domosdoshmërisht e njëjtë me rrjedhshmërinë orale. Rrjedhshmëria orale është aftësia për të lexuar mirë me zë; por ndokush mund të jetë lexues i rrjedhshëm në heshtje pa qenë i rrjedhshëm në lexim me zë.
Rima	Çdo zanore dhe bashkëtingëllore që pasojnë pas nismës. Për shembull në fjalën "plot", /ot/ është rima.
Fjalori i fjalëve fotografike	Fjalët të cilat personi mund t'i identifikojë menjëherë posa t'i shohë të shkruara, pa pasur nevojë për dekodim apo analizë të fjalës.
Rrokje	Njësi e gjuhës që përbëhet nga tinguj të pandërprerë. Një fjalë mund të ketë një apo më shumë rrokje. Për shembull, fjala "top" ka një rrokje; fjala "bota" i ka dy rrokje. Rrokja mund të përbëhet nga një apo më shumë tinguj.
Arka e Thesarit	http://sq.bep-ks.org/thesari/ Një ueb-faqe që përmban burime për mësimdhënës, duke përfshirë artikuj, video, shkarkime dhe vegëza në uebfaqe të tjera të dobishme.
Basic Education Program i USAID-it (USAID-BEP)	Programi financohet bashkërisht nga USAID-i dhe Qeveria e Kosovës (QK). Nga viti 2010 deri në vitin 2015, Basic Education Program (BEP) përkrah reformat arsimore të Kosovës dhe ndihmon për të zhvilluar shkathtësitë që u duhen të rinjve që për të pasur sukses në ekonominë globale.
Vizualizimi	Ndërtimi i imazheve mendore gjatë leximit të një teksti. Kjo ndihmon lexuesit për ta kuptuar më mirë atë që lexojnë dhe për ta mbajtur mend më mirë.
Njohja e fjalëve	Aftësia e lexuesit për të njohur saktë dhe pa shumë përpjekje fjalët e shkruara, pa pasur nevojë për t'i dekoduar.
Shprehja me shkrim	Shkrimi, organizimi dhe redaktimi i mendimeve me anë të shkrimit;
Rrjedhshmëria në shkrim	Shkrimi me gramatikë dhe dorëshkrim të saktë dhe të rrjedhshëm

TABELA E SHKURTESAVE

VpN	Vlerësimi për Nxënie
ViN	Vlerësimi i Nxënies
BEP	Basic Education Program - Programi për Arsimin Themelor
EGRA	Vlerësimi i Leximit në Klasat e Hershme
FHI 360	Family Health International
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
RPP	Raporti Pyetje-Përgjigje
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
USAID	United States Agency for International Development - Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar



SHKATHËSITË

Basic Education Program

Përmes punës në grupe, nxënësit zhvillojnë shkathësitë e komunikimit, kreativitetin dhe e pranojnë mendimin e njëri tjetrit. Gjatë punës në grupe ata kuptojnë rolet e tyre në grup. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijen dhe vetëbesimin përmes aktiviteteve konkrete.



të menduarit kritik



vetëvlerësimi



puna grupore



udhëheqësia

KOMPETENCAT KRYESORE TË KURRIKULËS SË KOSOVËS

KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT DHE TË SHPREHURIT
(Komunikues efektiv)

KOMPETENCA E TË MENDUARIT (Mendimtar kreativ)

KOMPETENCA E TË MËSUARIT (Nxënës i suksesshëm)

KOMPETENCA QË KA TË BËJË ME PUNËN, JETËN DHE MJEDISIN
(Kontribues Produktiv)

KOMPETENCA PERSONALE (Individ i shëndoshë)

KOMPETENCA QYTETARE (Qytetar i përgjegjshëm)




të lexuarit

E SHEKULLIT 21

Ata do të zhvillojnë ndërmarrësi, do të zhvillojnë dhe respektojnë oraret, dorëzimin e projekteve në kohë, do ta mësojnë procesin dhe rezultatet. Përdorimi i pajisjeve të shekullit 21 do t'u ndihmojë nxënësve të përgatiten për jetë dhe punë.

SHKATHËSITË RELEVANTE TË BASIC EDUCATION PROGRAM



LEGJENDA

- te menduarit kritik
- vetëvlerësimi
- puna grupore
- të lexuarit
- TIK-u
- të zgjidhurit e problemit
- kreativiteti
- hulumtimi
- ndërmarrësia
- udhëheqësia
- gjuha e huaj



TIK-u



të zgjidhurit e problemit



kreativiteti



ndërmarrësia



gjuha e huaj



hulumtimi



PJESA 1

HYRJE

- 1. Pse duhet ta ndryshojmë mënyrën e mësimdhënies së leximit?*
- 2. Pengesat në të lexuar: Pse disa fëmijë kanë problem në mësimin e leximit?*
- 3. Mënyra për tejkalimin e pengesave në lexim*
- 4. Shkrimi*
- 5. Pengesat e mia*
- 6. Krijimi i një mjedisi të të nxënit që nxit leximin*
- 7. Qendra e Leximit në Klasë*
- 8. TIK-u në zhvillimin e kompetencave të leximit dhe shkrimit*

1.1 Pse duhet ta ndryshojmë mënyrën e mësimdhënies së leximit?

Leximi është shkathhtësia thelbësore për mësim gjatë gjithë jetës



Gjithnjë e më shumë leximi po njihet si element thelbësor për nxënie, dhe jo vetëm në shkollë. Ndryshimet në teknologji, përfshirë

TIK-un dhe internetin, nuk e kanë zvogëluar apo larguar nevojën për lexim. Përkundrazi, e kanë shpejtuar hapin e ndryshimit dhe kanë ndryshuar mediumin përmes të cilit njerëzit mund të lexojnë; leximi gjithnjë e më shumë po ndodh online nga e-lexues, ku kërkesat për të lexuar janë shtuar dhe qasja ndaj mundësisë për të lexuar është bërë më e lehtë; rrjedhimisht, janë shtuar kërkesat dhe mundësitë për lexim me qasje më të lehtë. Çdokush ka nevojë për shkathhtësi të mira të lexim-kuptimit. Ata që nuk lexojnë mirë rrezikojnë të kenë arritje të ulëta dhe pengesa gjatë tërë jetës si dhe vështirësi në qasjen ndaj informatave të rëndësishme (p.sh. qytetari, shëndetësi, ekonomi, etj.) dhe përfitimet e tyre shoqërore.

Hulumtimet e fundit tregojnë se shumë nxënës në Kosovë kanë shkathhtësi të dobëta (probleme / pengesa / vështirësi) në rrjedhshmëri dhe kuptim



Një studim i bërë nga USAID Basic Education Program (BEP), me anë të Vlerësimit të Leximit në Klasat e Ulëta (EGRA) testoi 800 nxënës nga 40 shkolla në fund të klasës së dytë. Studimi tregoi se, ndërkohë që nxënësit mund të lexonin në

mënyrë mekanike, kishte dobësi të theksuara në shkathhtësitë e nivelit më të lartë sipas standardeve ndërkombëtare. Në veçanti rrjedhshmëria orale (aftësia për ta lexuar tekstin saktë, me shpejtësi të mirë dhe me të shprehurit e duhur) dhe lexim-kuptimi (të kuptuarit e përmbajtjes) ishin të dobëta. Kjo sugjeron se në Kosovë duhet t'i kushtohet shumë më tepër vëmendje përmirësimit të mësimdhënies së rrjedhshmërisë dhe të kuptuarit.

Ndryshimet në Kurrikulë kërkojnë metoda të reja të mësimdhënies

Kurrikula e Re e Kosovës përcakton gjashtë kompetenca thelbësore të cilat duhet t'i arrijnë të gjithë nxënësit. Leximi duhet të shihet si shkathhtësi thelbësore e komunikimit, së bashku me shkrimin dhe të folurit. Në kurrikulën e re, lexuesi i suksesshëm: lexon tekstin me zë; diskuton dhe interpreton atë që ka lexuar; identifikon porosinë, ngjarjen dhe personazhet kryesore të tregimeve; identifikon konceptet kryesore në shkrimet e vërteta; dhe zhvillon strategji të lexim-kuptimit. Kështu, mësimdhënia e leximit në kuadër të kurrikulës së re të Kosovës duket se është më kërkuese dhe më e fokusuar në shkathhtësi të veçanta.

Hulumtimi tregon mënyrat më të mira për mësimdhënien e leximit

Mbi bazën e njohurive nga studimet hulumtuese, ne mund të zhvillojmë programe mësimi që janë shumë më efektive se qasjet tradicionale.



Sot, dimë më shumë për komponentët kryesorë të leximit. Hulumtimet kanë bërë punë të mirë në identifikimin e teknikave të mësimdhënies të cilat janë me të vërtetë efektive.

1 Nxënësit e kuptojnë mirë fonetikën

Hulumtimet kanë përcaktuar renditjen në të cilën zhvillohen këto komponentë; kështu, e dimë se, për shembull, nëse fëmija nuk e kupton fonetikën deri në fund të klasës së parë, atëherë ka nevojë për ndihmë. Pjesa dërrmuese e mësimdhënësve në Kosovë e kuptojnë këtë shumë mirë.

2 Leximi duhet të jetë gjithnjë kuptimplotë

Për shembull, e dimë se aktivizimi i njohurive të mëparshme dhe vizualizimi (**shih faqen xxx**), është i efektshëm për përmirësimin e lexim-kuptimit të nxënësit. Për këtë duhet të punohet më shumë në shkollat e Kosovës.

3 Inkurajimi i nxënësve për t'u bërë nxënës të pavarur

Dhënia e përgjegjësisë nxënësve i inkurajon ata të jenë më të angazhuar në të nxënit e tyre. Gjithashtu e dimë se fëmijët janë natyrshëm aktivë gjatë mësimin. Nxënësit e vegjël de-motivohen nga detyrat dhe pyetjet e thjeshta dhe përgjigjen shumë më mirë kur u parashtrihen pyetje më interesante të cilat kërkojnë që të mendojnë më thellë për tekstin dhe ta ndërlihin atë që lexojnë me përvojën e tyre dhe njohuritë që kanë për botën. Kjo duhet të bëhet në masë më të madhe në shumicën e shkollave të Kosovës.

4 Diagnostifikimi dhe identifikimi i vështirësive individuale të nxënësve

Gjithashtu e dimë se, edhe pse elementet themelore të leximit janë të njëjta për të gjithë, të mësuarit e leximit në thelb është proces individual. Çdo fëmijë mëson të lexojë në mënyrën e vet, dhe mësimdhënësi duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë dhe të gjejë mënyra për t'i identifikuar dhe për t'iu përgjigjur nevojave mësimore individuale. Tani e kuptojmë se vlerësimet e shpeshta diagnostifikuese - jo testimi dhe notimi - janë shumë të vlefshme në mësimdhënien e leximit, sepse u mundëson mësimdhënësve të identifikojnë nevojat e të nxënit dhe të ofrojnë aktivitete të cilat i adresojnë ato. EGRA e zhvilluar nga Basic Education Program i USAID-it ofron një instrument të dobishëm për mësimdhënësit e Kosovës.

5 Leximi duhet të jetë i këndshëm, sfidues dhe interesant:

E dimë se motivimi është shumë i rëndësishëm gjatë mësimin të leximit. Zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj të lexuarit është një nga gjërat më të rëndësishme. Fëmijët duhet të kënaqen duke lexuar dhe të ndjejnë kënaqësi gjatë mësimin nga leximi dhe diskutimit të asaj që kanë lexuar. Përsëritjet e shumta janë kundër-produktive. Ky doracak përmban shumë shembuj praktikë si mund ta bëni të nxënit e leximit interesant dhe të këndshëm.

6 Përfshirja e prindërve në mësimin e leximit

E dimë se leximi është lëndë shkollore ku përkrahja e prindërve ka më së shumti ndikim në rezultate. Sa më herët që përfshihen prindërit në zhvillimin e leximit për fëmijët e tyre, aq më mirë është.

Këshilla për përfshirjen e prindërve mund të gjeni në Pjesën 6 të këtij doracak si dhe në një botim tjetër të BEP USAID. "Si ta bëj fëmijën tim lexues më të mirë? Ide dhe udhëzime për prindërit"



1.2 Pengesat në lexim: Pse disa fëmijë kanë problem gjatë të nxënit të leximit?

Gjatë ekspozimit të përditshëm ndaj gjuhës së folur, fëmijët mësojnë të flasin në mënyrë të natyrshme dhe automatike që nga mosha e hershme. Komunikimi përmes të folurit është veçori universale njerëzore, një nga karakteristikat që na dallon si qenie njerëzore. Fëmijët e mësojnë gjuhën fillimisht përmes dëgjimit, dhe kjo është baza e gjithë të nxënit tjetër të gjuhës. Fëmijët fillojnë ta mësojnë kuptimin përmes dëgjimit si edhe e zhvillojnë njohurinë për botën përmes dëgjimit. Prandaj dëgjim-kuptimi është bazë thelbësore për lexim-kuptimin.



Leximi dhe shkrimi nuk janë procese të natyrshme siç është të folurit. Leximi dhe shkrimi janë shkathtësi të cilat zhvillohen shumë më vonë se të folurit dhe marrin më shumë kohë për t'u zotëruar. Si leximi ashtu edhe shkrimi mësohen, ndërsa të folurit arrihet natyrshëm. Me këtë nënkuptojmë se njerëzit nuk mësojnë të lexojnë dhe shkruajnë pa ndonjë formë të drejtpërdrejtë të mësimdhënies.

Leximi është shkathtësi komplekse me pesë komponentë të ndërlydhur:

- 1. Vetëdija tingullore:** Nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i identifikojnë tingujt (d.m.th. fonemat), ti ndajnë fjalët në tingujt përbërës dhe t'i bashkojnë tingujt në fjalë. Kjo është shkathtësi thelbësore "para-leximi"; nxënësit të cilët nuk e zotërojnë këtë shkathtësi deri në fund të nivelit parashkollor kanë rrezik të bëhen lexues të dobët.
- 2. Fonetika:** Hapi i ardhshëm pas vetëdijes tingullore është të jenë në gjendje ta njohin raportin mes shkronjave të shkruara dhe tingujve të thënë dhe bashkimin e shkronjave/tingujve në rrokje, apo ndarjen e rrokjeve në shkronja/tinguj. Kjo është bazë thelbësore për sukses në lexim dhe shkrim në klasën e parë dhe më tej.
- 3. Rrjedhshmëria:** Zotërimi i fonetikës është i domosdoshëm por nuk është i mjaftueshëm për të garantuar lexim të suksesshëm. Lexuesve të dobët shpesh u mungon rrjedhshmëria - lexojnë

shumë ngadalë dhe fjalë për fjalë. Lexuesit e rrjedhshëm kanë aftësi ta lexojnë tekstin shpejt dhe saktë dhe t'i grupojnë fjalët përdoritur lexojnë në të njëjtën mënyrë siç flasin. Ata kanë më shumë mundësi ta kuptojnë atë që e lexojnë.

4. **Fjalori:** Njohja e kuptimit të një numri të madh fjalësh është ndihmë e madhe për të kuptuarit e asaj që lexojmë. Të nxënit e kuptimit të fjalëve dhe përdorimit të tyre në mënyrë aktive, si dhe krijimi i familjeve të fjalëve duke u bazuar në kuptimin e tyre është baza e fjalorit produktiv.
5. **Të kuptuarit:** Qëllimi i fundit i leximit është të kuptuarit e asaj që lexohet - jo vetëm të kuptohen informatat faktike në tekst, por edhe të nënkuptohen gjëra në lidhje me tekstin duke u bazuar në njohuri dhe përvoja paraprake.

Këta pesë komponentë kryesorë të leximit jo vetëm që duhet të mësohen me sukses; por duhet të funksionojnë mirë së bashku. Në pjesën 3 do ta shikojmë secilin komponent ndaras, pse është i rëndësishëm secili prej tyre, si ndërlidhen së bashku, dhe si t'ua mësojmë nxënësve secilin me radhë.

Ekzistojnë 4 arsye kryesore pse nxënësit kanë vështirësi gjatë të nxënit të leximit:

1. U mungon përkrahja dhe inkurajimi

Ata rriten në një mjedis ku leximi nuk vlerësohet sa duhet, ku nuk ka inkurajim të mjaftueshëm për të mësuar leximin apo nuk ka përkrahje aktive për përpjekjet e tyre dhe kanë qasje të kufizuar në materiale të leximit. Fëmijët që rriten në një mjedis të varfër leximi, kanë tendencë të lexojnë më pak dhe t'i zhvillojnë shkathtësitë e leximit më ngadalë se ata që rriten në një mjedis përkrahës dhe të pasur me materiale leximi.



2. Mund të kenë vështirësi individuale

Për shembull mund të kenë vështirësi me dëgjim-kuptimin, me njërin nga pesë elementët thelbësorë të leximit të cilët janë dhënë më lart (dhe që janë përshkruar më në detaje në pjesën 3 në vijim) apo me kombinim të dy apo më shumë komponentëve. Kjo situatë është shumë e zakonshme. Fëmijët mësojnë në mënyra shumë individuale dhe nuk përparojnë të gjithë në të njëjtën kohë. Pasi që leximi mësohet, e nuk fitohet, fëmijët kanë nevojë që leximi t'u mësohet; dhe mësimdhënia duhet të reflektojë nevojat e tyre individuale.

3. Kanë ndonjë pengesë të natyrës së veçantë

Arsyeja e tretë, dhe më e rralla, është se mund të kenë ndonjë paaftësi të veçantë. Disa nxënës hasin vështirësi në mësimin e leximit sepse mund të jenë disleksikë ose mund të kenë probleme me shikim apo dëgjim. Nëse një fëmijë ka vështirësi në lexim mirëpo ka zhvillim konjitiv normal dhe nuk i përgjigjet planit përkrahës të individualizuar, atëherë mund të ketë ndonjë paaftësi të veçantë. Por fëmijët e tillë zakonisht janë në numër të vogël.

4. Mësimdhënësit e tyre nuk janë të vetëdijshëm për mënyrat më efektive të mësimdhënies së leximit

Fëmijët mund të hutohen dhe demotivohen nëse mësimdhënësit përdorin metoda të papërshtatshme.

Mëso më shumë si të ballafaqohesh me lexuesit me vështirësi në Pjesën 5.

1.3 Mënyra për t'i tejkaluar pengesat në lexim

Për të krijuar një mjedis tërheqës leximi duhen pasur parasysh disa aspekte:

Motivimi:

Mënyra më efektive për mësimdhënien e leximit nuk është përsëritja dhe praktika, por gjenerimi i entuziazmit për lexim. Fëmijët që kanë më së shumti gjasa për tu bërë lexues të suksesshëm janë ata të cilët kanë qasje pozitive ndaj leximit dhe të cilët janë të motivuar të lexojnë. Fëmijët më të motivuar janë ata:

- të cilët i shohin të rriturit dhe fëmijët përreth që lexojnë për kënaqësi,
- të cilëve u lexohet shpesh,
- të cilët inkurajohen të kënaqen duke lexuar,
- të cilët inkurajohen të lexojnë libra të zhanreve të ndryshme, dhe
- të cilët inkurajohen të zgjedhin çka do të lexojnë



Mësimdhënia:

Mësimdhënia duhet të fokusohet në pesë komponentët e leximit të identifikuar në mënyrë shkencore dhe të cilat janë përcaktuar në faqet e mëparshme. Duhet të përdoren metodologjitë e përshtatshme, shembuj të cilave jepen në pjesën 3 në vijim, dhe duhet të planifikohet duke përdorur informata nga vlerësimi, duke siguruar që niveli i aktiviteteve u përshtatet nevojave të nxënësve. Mbi të gjitha, kur një nxënës është i dobët në një komponent të veçantë, mësimdhënia duhet të synojë në mënyrë individuale zhvillimin e shkathtësisë së atij nxënësi në atë komponentë.



Vlerësimi:

Vlerësimi formativ duhet të përdoret për të identifikuar fëmijët që janë mbrapa moshatarëve të tyre apo të cilët kanë dobësi apo vështirësi specifike. Këto informata duhet të përdoren për të planifikuar mësimdhënien. Vlerësimi në këtë mënyrë nuk është testim apo notim, por pasqyrim apo diagnostifikim. Ai mund të bëhet duke përdorur teste formale siç është A-EGRA (shih në vijim); por mësimdhënësit duhet të mësojnë si ta vlerësojnë të lexuarit e fëmijëve në mënyrë joformale. Ai duhet të ndërlihet pa u vërejtur në mësimdhënie, pikërisht ashtu siç është ndërlihetur në këtë doracak.



Koha:

Për lexim duhet të ndahet kohë e mjaftueshme – në shkollë, në shtëpi dhe në vende tjera. Leximi në klasat e ulëta duhet të mësohet çdo ditë dhe koha e ndarë për të duhet të jetë e mjaftueshme – klasat 0-3 së paku 90 minuta lexim të papenguar çdo ditë. Menaxhimi i kohës është gjithashtu i rëndësishëm. Nxënësit duhet të angazhohen në mënyrë të atillë që të ndodhë të nxënës. Ata kanë mundësi të angazhohen në mënyrë aktive kur janë duke lexuar, kur janë duke diskutuar atë që kanë lexuar ose dëgjuar, e jo kur janë duke dëgjuar mësimdhënësin apo ndonjë nxënës tjetër duke lexuar. Kështu që leximi në çifte dhe në grupe të vogla është zakonisht më efektiv se sa leximi para tërë klasës në aspektin kohor. Andaj mund t'u kërkohet edhe prindërve dhe vullnetarëve që t'i dëgjojnë fëmijët duke lexuar për ta shtuar kohën aktive për lexim, sidomos për lexuesit më të dobët.

**Përfshini prindërit:**

Prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre duke ndarë kohë çdo natë për të lexuar me ta; dhe kur ka mundësi të shkojnë rregullisht në bibliotekën lokale. Edukoni dhe informoni prindërit si mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të mësojnë të lexojnë. Basic Education Program i USAID-it ka hartuar një doracak të veçantë për prindërit në lidhje me këtë temë.

Lexo më shumë në Pjesën 6 dhe Pjesën 9**Materialet:**

Pasurimi me materiale të përshtatshme sipas moshës dhe interesimit në klasë, shkollë dhe vende të tjera (p.sh. shtëpi dhe bibliotekë) është thelbësor për zhvillimin e shprehisë së leximit. Materialet e nevojshme nuk janë vetëm tekstet shkollore dhe mjetet tjera të mësimdhënies, por edhe materiale të tjera leximi që janë aktuale dhe me interes për nxënësit. Ato duhet të përfshijnë tekste letrare dhe jo-letrare, me llojllojshmëri të mjaftueshme ku secili nxënës mund të gjejë diçka që i intereson. Nxënësit duhet gjithashtu të kenë qasje të lirë në këto materiale dhe të inkurajohen t'i zgjedhin materialet e veta për lexim në bazë të interesimit.

**E nëse një fëmijë në klasën time ka ndonjë paaftësi të veçantë?**

Të jkalmimi i pengesës së tretë të madhe, paaftësia e veçantë siç është disleksia, kërkon vëmendje të veçantë dhe teknika specifike. Në shumicën e rasteve, përkrahja e veçantë, të themi 30 minuta në ditë, duke u fokusuar në mënyrë specifike në atë aspekt ku individi ka vështirësi, e zgjidh problemin dhe e sjell nxënësin në nivel të njëjtë me klasën. Por nëse nxënësi nuk e arrin përparimin e pritshëm, dhe nëse problemi vazhdon për së paku dy muaj, atëherë mësimdhënësi duhet të kërkojë ndihmën e specialistit për të përcaktuar nëse ai nxënës ka ndonjë paaftësi në të nxënë dhe, nëse po, cila është ajo dhe si të trajtohet. Mësimdhënësi nuk duhet kurrësi të mundohet të bëjë ndonjë diagnozë të tillë apo të bëjë ndonjë plan trajtimi pa ndihmën e specialistit.

Lexo më shumë për identifikimin e vështirësive specifike në lexim në Pjesën 5

1.4 Shkrimi

Leximi dhe shkrimi janë dy anët e së njëjtës monedhë. Të dyja varen nga të kuptuarit e saktë dhe përdorimi i gjuhës, dhe secila e zhvillon tjetrën. Prandaj, shkrimi duhet të zhvillohet në mënyrë paralele me leximin, dhe leximi e shkrimi duhet të mësohen së bashku.

Fëmijët fillojnë ta modelojnë shkrimin pothuajse sapo të jenë të vetëdijshëm për lidhjen mes tekstit të shkruar dhe të folurit. Ata mund të fillojnë duke shkarravitur apo duke u bërë sikur po shkruajnë; por shumë shpejt fillojnë të shkruajnë shkronja dhe fjalë. Mirëpo, ata nuk janë vetëm duke u munduar ta imitojnë shkrimin të cilin e shohin përreth; ata gjithashtu mundohen të komunikojnë përmes shkrimit.



Ekzistojnë dy elemente thelbësore në shkrim:

rrjedhshmëria
në shkrim

dhe

të shprehurit
me shkrim

të shprehurit me shkrim përfshin transkriptimin, organizimin dhe redaktimin e mendimeve të personit në shkrim; ndërkohë që

rrjedhshmëria në shkrim ka të bëjë me gramatikën e saktë dhe të rrjedhshme si dhe me dorëshkrimin.



Rrjedhshmëria në shkrim është e rëndësishme sepse pa gramatikë dhe shkrim të drejtë idetë tona mund të mos kuptohen saktë. Sidoqoftë, në punë dhe shtëpi, më e rëndësishme është aftësia për t'i shprehur idetë tona me shkrim. Në shkollat e Kosovës, diktimi është një nga aktivitetet më kryesore të shkrimit. Ai e ka rëndësinë e vet në zhvillimin e rrjedhshmërisë në shkrim, por hulumtimet na tregojnë se diktimi nuk është i dobishëm në zhvillimin e aftësisë së fëmijëve për të shkruar në mënyrë kreative, në përshkrimin e ngjarjeve dhe shprehjen e mendimeve të tyre. Gjatë diktimit, mësimit është ai që ofron të shprehurit dhe gramatikën, ndërsa fëmijët vetëm i përshkruajnë mendimet e mësimit. Që nga fillimi i shkollës, fëmijët duhet të inkurajohen të formulojnë dhe të shkruajnë mendimet e tyre. Theksi duhet të jetë tek ndihma që u ofrohet nxënësve në përdorimin e procesit të shkrimit për të arritur qëllime të ndryshme, e jo vetëm për t'u bërë të rrjedhshëm në dorëshkrim dhe ndërtim të fjalive.



Kjo bëhet më së lehti nëse mësimit është i ndan të dy detyrat në a) hartimin e tekstit dhe b) shkrimin e tij. Kjo mund të bëhet duke përdorur tiketat e fjalëve që ofrohen nga mësimit dhe krijohen nga nxënësi.

Është me rëndësi t'i inkurajoni fëmijët që t'i krijojnë vetë tiketat e fjalëve që ata mendojnë t'i shtojnë në fjalorin themelor në libra. Tiketa e parë që krijojnë duhet të jetë tiketa e emrit të tyre.

Duke përdorur tiketat e fjalëve fëmijët mund të ndërtojnë fjali të thjeshta duke përdorur telin për tharje ose tabelën me xhepa.



Pasi formojnë një fjali duke përdorur tiketat e fjalëve, nxënësit mund ta përshkruajnë atë me laps në letër apo fletore.

Tiketatat e fjalëve mund të klasifikohen sipas alfabetit në fjalorin e murit.

Përdorimi i fjalorit të murit është hapi i parë ku fëmija kupton rendin alfabetik dhe përdorimin e një fjalori të vërtetë.



Shkrimi elektronik

Mos harroni se nxënësit që i mësoni sot ndoshta do ta përdorin lapsin apo stilolapsin shumë rrallë pasi ta përfundojnë shkollën. Dorëshkrimi tashmë është bërë pothuaj i pazakontë në shumë vende pune dhe shtëpi. Në vend të tij, i përdorim kompjuterët, tabletët dhe telefonat smart. Kështu që, nxënësit duhet të kalojnë më pak kohë duke praktikuar dorëshkrimin.



Shkrimi në kompjuterë u ofron nxënësve edhe më shumë mundësi për rishkrim, redaktim, e rishikim të shkrimit të tyre. Ata gjithashtu mund të punojnë së bashku me një partner apo grup për hartimin e një teksti, duke e përmirësuar kështu fjalorin e tyre dhe duke e kuptuar gramatikën.



Mëso më shumë për shkrimin në Pjesën 4

1.5 Pengesat e mia: Sfidat për mësimdhënësit e Kosovës.

Ekzistojnë disa sfida të zakonshme me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit në Kosovë. Hapi i parë në tejkalimin e tyre është t'i trajtojmë si sfida dhe të ballafaqohemi me to duke mbajtur qëndrim pozitiv ndaj tyre. E dyta është të gjejmë se çka kanë bërë kolegët e tjerë për tejkalimin e këtyre sfidave.

Sfida 1: Numri i nxënësve

Numri i madh i nxënësve në klasë është pengesë e zakonshme në shkollat e Kosovës. Edhe pse është pengesë legjitime, kjo nuk duhet të na pengojë në gjetjen e mënyrave dhe organizimin e nevojshëm për ta bërë klasën të duket sikur nuk ka numër aq të madh nxënësish. Ekzistojnë disa ide të cilat mësimdhënësit mund t'i shfrytëzojnë për t'ia arritur kësaj.

Së pari, dijeni se nuk jeni vetëm dhe se shkëmbimi i ideve me kolegët tuaj mund t'ju ndihmojë. Së dyti, mendoni si mund ta shfrytëzoni më mirë kohën tuaj përmes punës në grupe dhe çifte. Kalimi nga puna me tërë klasën në punë me grupe dhe çifte nuk është i lehtë dhe nuk keni nevojë ta bëni këtë përnjëherë. Megjithatë, mund ta kufizoni kohën që kaloni duke punuar me tërë klasën dhe ta organizoni mësimin ashtu që nxënësit të punojnë në grupe dhe çifte. Disa mësimdhënës brengosen se puna në grupe nuk u lejon t'i kenë nën kontroll të gjithë nxënësit. Në fakt, roli juaj i parë si mësimdhënës nuk është ta keni klasën nën kontroll por fillimisht t'i përkrahni nxënësit në mësim duke lëvizur nëpër klasë dhe duke kaluar kohë me grupet përderisa ata janë duke punuar.

Një mësuese me dyzet nxënës në një shkollë të Prishtinës tha: "Puna me grupe më ka ndihmuar ta menaxhoj klasën time të madhe. Do të ishte shumë vështirë për mua të arrija shumë pa punë në grupe. Kanë shumë rëndësi teknikat që përdor." Një mësuese tjetër në Vushtrri i ndau nxënësit e saj në pesë grupe. Ajo u dha nxënësve të njëjtin tregim për të lexuar dhe pyetje të ndryshme për secilin grup. Grupet duhej t'u përgjigjeshin pyetjeve të tyre dhe të përgatisnin dy pyetje të tjera për një grup tjetër. Pasi grupet iu përgjigjën pyetjeve të tyre, mësuesja iu dha mundësi grupeve të tjera të pajtoheshin me përgjigjen e dhënë, të komentonin apo të jepnin përgjigje tjetër. Në këtë mënyrë të gjithë nxënësit ishin të angazhuar dhe aktivë.

Një mësuese në Lipjan përdori tërheqjen e rastësishme të një lapsi nga grumbulli i lapsave të nxënësve për të vendosur se kush do të raportonte për grupin. Në këtë mënyrë ajo u siguroi që të gjithë nxënësit të jenë të vëmendshëm dhe të angazhuar.

Mund të lexoni më shumë për klasat me numër të madh të nxënësve në <http://www2.unescobkk.org/elib/publications/095/>



Sfida 2: Mungesa e kohës

Mungesa e kohës është një pengesë tjetër, meqenëse pothuaj të gjitha shkollat në Kosovë punojnë në dy ndërrime. Sërish, ka mësimdhënës në Kosovë të cilët na tregojnë se si puna në grupe dhe çifte ndihmon edhe në këtë rast.

Mësuesja në Vushtrri, e cila u përmend më lart, arriti të diskutonte më shumë se 20 pyetje në lidhje me tregimin vetëm duke përdorur punën në grupe. Përveç punës në grupe, ajo gjithashtu: a) është përgatitur paraprakisht, që nënkupton se kishte shkruar në tabelë çdo gjë që i duhej për orën mësimore dhe i kishte mbuluar disa pjesët e cilat i zbuloi gjatë orës, atëherë kur i nevojiteshin; b) kishte përgatitur fletë shpërndarëse për punën në grupe të cilat i kishte ndarë në pjesë për secilin grup dhe ua dha nxënësve për t'i shpërndarë; c) u dha nxënësve një detyrë shtëpie që ishte interesante dhe me kuptim për të zgjeruar të nxënësit. Disa ide tjera për t'i marrë parasysh: Lista e leximit. Bëni një listë të librave që nxënësit do të dëshironin të lexonin gjatë vitit dhe kërkonin t'i shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin. Gjithashtu, ofroni nxënësve mundësinë ta zgjedhin librin që dëshirojnë ta lexojnë gjatë muajit.



- Rutina ditore. Ndani pak kohë çdo ditë për lexim, qoftë individual apo në çifte. Në këtë mënyrë do t'i keni gjysmën e nxënësve apo tërë nxënësit duke lexuar. Lëvizni nëpër klasë për t'i përkrahur.
- Kërkon vullnetarë për t'i dëgjuar nxënësit duke lexuar.
- Rregullat e klasës. Përgatisni rregullat e klasës suaj bashkë me nxënësit dhe kërkon miratimin e secilit për secilën rregull.
- Lista e leximit. Bëni një listë të librave që nxënësit do të dëshironin të lexonin gjatë vitit dhe kërkonin t'i shkëmbejnë librat me njëri-tjetrin. Gjithashtu, ofroni nxënësve mundësinë ta zgjedhin librin që dëshirojnë ta lexojnë gjatë muajit.
- Teknikat e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të shokëve janë ndihmë e madhe për shfrytëzimin e mirë të kohës dhe dhënien e përgjegjësisë nxënësve për të nxënësit e tyre.

Sfida 3: Mungesa e Materialeve

Asnjëherë nuk do të ketë materiale të mjaftueshme. Edhe nëse e keni pakon e leximit që ofron programi për secilën shkollë partnere, ende do të ketë nevojë për më shumë materiale.

Disa mësues bënë një listë të materialeve recikluese dhe kërkojnë nga prindërit/nxënësit t'i sjellin në shkollë. Koha më e mirë për ta ndarë këtë listë me prindërit është mbledhja e parë me prindër në fillim të vitit shkollor. Kërkonin nga ata të sjellin kuti këpucësh, karton, paketime kartoni, shkopinj akulloresh, etj., dhe përdorini ato për ta bërë fjalorin e murit duke i shkruar shkronjat, fjalët më të shpeshta dhe fjalët e reja në tiketa nga kartuçi.



Gjithashtu, mund të vendosni të krijoni bibliotekën e klasës. Kërkonin nga nxënësit të sjellin libra për bibliotekën e klasës suaj. Mund t'u kërkonin që t'i dhurojnë librat ose vetëm t'i huazojnë për atë vit shkollor. Në këtë mënyrë nxënësit do të kenë më shumë libra për të zgjedhur çka dëshirojnë të lexojnë. Nxënësit mund të sjellin libra, por edhe mund të kërkonin që të krijojnë librat e tyre [për më shumë informata shih www.bep-ks.org, dhe t'i ndajnë me nxënësit tjerë përmes bibliotekës së klasës.



Sfida 4: Fëmijët që kanë vështirësi në të nxënë

Si mund të punojmë me nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë dhe përkrahje?

Në një klasë në Junik, disa nxënës kishin nevojë për përkrahje të posaçme. Mësuesja u dha nxënësve një detyrë në grupe dhe e përqendroi vëmendjen tek nxënësit që kishin më shumë nevojë.

Një mësuese në Lipjan vendosi të punonte më shumë me disa nxënës të caktuar, andaj e diskutoi këtë çështje me prindërit. Ata vendosën të caktonin një ditë në javë kur disa nxënës dhe mësuesja do të qëndronin më gjatë pas mësimit, dhe kështu ajo do të kishte mundësi të merrej me ta në mënyrë individuale.

Sfida 5: Sistemi me ndërrime

Si mund ta bëj klasën time një mjedis efektiv të të nxënit, kur duhet ta ndaj me një mësimpldhënës tjetër?

Një mësuese tjetër në Gjakovë dëshironte ta shfrytëzonte më shumë mjedisin e klasës, dhe e diskutoi këtë çështje me drejtorin e shkollës dhe kujdestarin e klasës i cili shfrytëzonte të njëjtën klasë në ndërrimin tjetër. Ata u mbledhën së bashku dhe diskutuan se cila do të ishte mënyra më e mirë për shfrytëzimin e mureve të klasës. Në fund vendosën t'i ndanin muret, ku dy mure do t'i takonin klasës së dytë dhe dy muret e tjera klasës së shtatë. Pas këtij vendimi, mësuesja ua shpjegoi këtë nxënësve të saj, dhe më pas u takua me nxënësit e klasës së shtatë për t'ua shpjeguar edhe atyre idenë. Ajo e bëri këtë duke u bazuar në përvojën e kolegëve të saj, të cilët i thanë se nxënësit e klasës së shtatë do t'i shkatërronin punimet në mur. Në fund, ata arritën të kishin një mjedis të këndshëm mësimi në funksion të mësimpldhënies dhe të nxënit, ku të gjithë ndjeheshin se klasa ishte e tyre, dhe ishin krenarë për këtë.

Pjesa 8 ofron shumë teknika të mësimpldhënies të cilat mund t'ju ndihmojnë ta bëni punën tuaj më efektive.

Lexuesit me vështirësi

Pothuaj çdo fëmijë mund të mësojë të lexojë. Disa e kanë të lehtë e disa jo. Meqenëse leximi është shkathtësi komplekse, nxënësit mund të kenë vështirësi me leximin për arsye të ndryshme. Mund të jetë e vështirë për mësuesit që t'i përkrahin të gjithë, por pjesa më e madhe e nxënësve kanë nevojë vetëm për ndihmë në drejtime të caktuara për të pasur sukses. Kështu që është shumë e rëndësishme që mësuesja së pari të diagnostifikojë e pastaj të përkrahë lexuesit me vështirësi; dhe që përkrahja të synojë nevojat individuale të nxënësve.

Shenjat paralajmëruese

Ekzistojnë shumë shenja paralajmëruese që tregojnë se nxënësit kanë vështirësi. Për shembull, ata mund të:

- paraqesin qëndrim negativ në lidhje me leximin, mund të mos shohin vlerë në aftësinë për të lexuar;
- në përgjithësi hezitojnë të marrin pjesë në aktivitetet e leximit, gjejnë arsye për të mos lexuar;
- i kapërcejnë fjalët, i lexojnë gabim apo mbrapsht kur lexojnë me zë (mbi moshën 8 vjeçare);
- shfaqin modele të çrregullta të lëvizjes së syve, duke kaluar lart e poshtë dhe nga njëra anë në tjetrën;

- mbipërdorin strategjitë e kufizuara, për shembull, varësisht nga fjalori i fjalëve fotografike dhe fjalët, mundohen t'ia qëllonë në vend që t'i dekodojnë; apo i thonë fjalët e panjohura në vend që të mundohen t'ia gjejnë kuptimin nga konteksti;
- kanë vështirësi në rikujtimin e informatave të rëndësishme nga ajo që kanë lexuar;
- shfaqin shenja irritimi në rritje derisa zhvillojnë detyrën e leximit.

Nëse vëreni më shumë se një nga këto shenja tek nxënësi juaj, atëherë duhet t'i vlerësoni për të parë nëse kanë nevojë për vëmendje të veçantë dhe të zhvilloni një plan për përkrahje. Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta (A-EGRA) është një mjet i mirë për përdorim dhe ju ofron informata për performancën e secilit komponent ndaras. Por, ndoshta preferoni të përdorni ndonjë test tuajin, apo të shkarkoni shembuj nga uebfaqja e BEP-it.

Planet individuale të të nxënësve

Nëse një nxënës ka vështirësi, ju duhet të ofroni ndihmë intensive dhe sistematike në fushat ku janë më të dobët. Ju duhet të zhvilloni nga një **plan individual për përkrahje** për secilin nxënës:

- Përkrahja duhet të jetë e shpeshtë, preferohet tre deri pesë herë në javë për 20–40 minuta.
- Përkrahja një me një është më efektive; përkrahja në grupe në përgjithësi është më pak efektive, por funksionon më së miri kur anëtarët e grupit janë në nivel të ngjashëm dhe kanë vështirësi të ngjashme.
- Mësimdhënësit janë më efikasë se vullnetarët. Por mund të bëhen kompromise, dhe një vullnetar është më mirë se pa ndihmë fare.
- Theksi në fonetikën e strukturuar në përgjithësi i përmirëson rezultatet e ndihmës.
- Monitoro përparimin së paku një herë në muaj. Nëse pas dy apo tre muajsh nxënësi nuk ka përparuar në mënyrë të dukshme, kjo mund të jetë shenjë se ndihma e specialistit është e nevojshme.

E nëse fëmija nuk mëson prapë se prapë?

Nëse nxënësi me vështirësi nuk përparon në mënyrë të dukshme pavarësisht nga ndihmë e veçantë, atëherë kjo mund të jetë shenjë për vështirësi specifike. Ekzistojnë katër lloje kryesore të vështirësive specifike – disleksia, disgrafia, probleme në dëgjim dhe shikim.

Mësimdhënësi nuk mund t'i zgjidhë këto probleme vetëm. Nëse mendoni se fëmija në klasën tuaj ka vështirësi specifike në lexim, nuk duhet të mundoheni ta diagnostifikoni vetëm, por duhet ta referoni fëmijën për testim nga një specialist.

Nëse keni ndonjë fëmijë në klasë i cili është diagnostifikuar me vështirësi specifike në lexim, duhet të merrni parasysh nevojat e tij në mësimdhënien tuaj. Këtë mund ta bëni, për shembull, duke:

- përdorur teknika për përmirësim – d.m.th. ndihmë për t'i përmirësuar shkathtësitë e leximit apo shkrimin;
- bërë përshtatje – d.m.th. gjetja e alternativave për shprehje përmes leximit apo shkrimin; dhe
- bërë modifikime – d.m.th. duke ndryshuar pritshmëritë apo detyrat për të minimizuar apo shmangur fushën ku ka vështirësi.

Prandaj, duhet t'i dini gjërat që mund ta bëjnë jetën e fëmijës më të lehtë, pasi që është diagnostifikuar.

Mund të gjeni më shumë informata në lidhje me përkrahjen e lexuesve me vështirësi, shenjave paralajmëruese ndaj vështirësive specifike për të cilat duhet të keni kujdes dhe çfarë mund të bëni për ta ndihmuar fëmijën i cili është diagnostifikuar me një vështirësi specifike në.

1.6 Krijimi i një mjedisi të nxëniet që nxit të lexuarit

Për ta përfunduar këtë hyrje, po japim gjashtë mënyra se si mund ta bëni mjedisin në klasën tuaj të tillë që t'i motivojë dhe ndihmojë nxënësit tuaj të bëhen lexues më të mirë:

Bëje leximin të veçantë

Ofroji nxënësve shumë zgjedhje



Ndaji dhe vlerësoji librat

Vlerëso rregullisht

Përkrahi nxënësit me vështirësi në të nxënë

Përfshij prindërit

1) Bëjeni leximin të veçantë

Koha që kaloni duke lexuar duhet të shihet si e veçantë. Kjo ndodh kur nxënësit lexojnë në shtëpi apo në shkollë.

- Nëse keni mundësi, krijoni një kënd leximi me shumë jastëkë apo shilte ku nxënësit mund të ulen rehat, dhe një kuti me libra shumëgjyrësh me ilustrime. Kërkoni nga nxënësit të ndihmojnë për ta dekoruar dhe për ta bërë të veçantë. Krijoni një *raft të veçantë për libra të cilin e ndërtojnë vetë nxënësit*.
- *Ndani çdo ditë një kohë të veçantë për lexim dhe shkrim. Mund ta shfrytëzoni kohën në këndin e leximit si shpërblim për punë të mirë.*
- Krijimi i librave është mënyrë shumë e mirë për të ndihmuar nxënësit ta vlerësojnë leximin si të veçantë.

Shikoni në Pjesën 9 udhëzimet për aktivitetet e krijimit të librave me nxënës.

2) Ofroni nxënësve shumë zgjedhje

Nxënësit të cilët mund të zgjedhin çka të lexojnë, edhe nëse zgjedhja e tyre është e kufizuar, tregojnë më shumë interesim, përpiqen më shumë dhe mësojnë më shumë se ata të cilët nuk kanë mundësi zgjedhjeje. Nëse nxënësit janë të lirë të zgjedhin çka do të lexojnë, dhe çka do të ri-lexojnë nëse nevojitet, ata duhet të kenë qasje në shumë materiale leximi.

Nëse keni mundësi:

- krijoni bibliotekën e klasës në këndin e leximit dhe ofrojuni nxënësve mundësi të vazhdueshme për ta shfrytëzuar;
- organizoni bibliotekën e klasës në grupe tematike – tekste shpjeguese, romane dhe poezi, të gjitha për të njëjtën temë – për t'i inkurajuar fëmijët të lexojnë libra të zhanreve të ndryshme;
- gjeni mënyra si të organizoni vizita të rregullta në biblioteka të tjera – bibliotekën e shkollës, biblioteka e qytetit, etj. – dhe ndani kohë për të lexuar lirshëm atje;
- inkurajoni nxënësit të qasen në internet, si në shkollë ashtu edhe në shtëpi, duke u dhënë detyra të thjeshta dhe të qarta për të marrë informata; dhe
- inkurajoni prindërit të mbajnë libra në shtëpi.

3) Ndajini dhe vlerësoni librat

Fëmijët thonë se kënaqen duke diskutuar dhe duke shkëmbyer librat, ato që i lexojnë të tjerët dhe ato që lexojnë vetë. Prandaj, mësuesit duhet të:

- nxisin shkëmbimin joformal me anëtarët e familjes, duke i inkurajuar prindërit dhe vullnetarët t'i dëgjojnë fëmijët duke lexuar dhe të diskutojnë me ta për atë që kanë lexuar;
- ta shfrytëzojnë sa më shumë modelin e leximit me zë, të modelojnë vetë strategji dhe sjellje të rëndësishme të leximit dhe t'i lejojnë nxënësit të marrin rol aktiv gjatë dhe pas leximit;
- zvogëlojnë aktivitetin me tërë klasën duke shtuar kohën për diskutime me grupe të vogla ku nxënësit mund të ndërveprojnë dhe të shkëmbejnë këndvështrime në lidhje me atë që kanë lexuar; dhe
- ndajnë kohë të veçantë që nxënësit të ndajnë me të tjerët atë që kanë lexuar;
- u mundësojnë nxënësve të krijojnë tregimet dhe librat e tyre dhe t'i ndajnë me të tjerët.



4) Vlerësoni rregullisht

Lexuesit fillestarë dallojnë shumë. Disa kanë fjalor të mjaftueshëm të fjalëve fotografike por nuk janë të mirë në dekodim. Disa të tjerë kanë fjalor të mirë, por shkathtësi të dobëta dekodimi, e kështu me radhë. Të gjithë kanë nevojë të ndryshme të të nxënës. prandaj:

- Mësimdhënësit i duhet vlerësimi formativ për të ditur se çka mund të bëjë secili fëmijë dhe çka ka nevojë të mësojë.
- Nxënësit gjithashtu kanë nevojë për vetëvlerësim, për të ditur se çka mund të bëjnë dhe cila është sfida e tyre e ardhshme.

Prandaj mësimdhënësit duhet t'i ndajnë qëllimin e të nxënës dhe kriteret e suksesit me nxënësit dhe ta bazojnë vlerësimin e tyre të rregullt formativ mbi këto kritere. Vlerësimi formativ nuk është testim, në kuptimin tradicional të notimit. Ai mund të përdorë teste apo vëzhgime joformale dhe pyetje, ose një kombinim të të dyjave.

Lexo më shumë për vlerësimin e leximit dhe shkrimit në Pjesën 6.

5) Përkrah lexuesit me vështirësi

Kur nxënësi vërtet ka vështirësi, është thelbësore t'i ofrohet përkrahje aktive, e fokusuar në ndihmë për t'i tejkaluar vështirësitë e tij. Prandaj, kur një mësimdhënësi kupton, përmes vlerësimit apo vëzhgimit, se një nxënës ka vështirësi, atëherë:

- vlerëson individin hollësisht (duke përdorur A-EGRA apo teste të përpiluara nga mësimdhënësi) për të kuptuar se cilat janë problemet e tij dhe për çfarë lloj përkrahjeje ka nevojë;
- zhvillon një plan individual për nxënësin;
- pas rreth një muaji, e vlerëson sërish për të përcaktuar nëse nxënësi ka përparuar, dhe rishikon planin individual të të nxënës.

6) Përfshij prindërit

Mësimdhënësi duhet të jetë gjithnjë i vetëdijshëm për rëndësinë e prindërve në arsimimin e fëmijëve të tyre:

Pjesa 6 diskuton më në detaje për përfshirjen e prindërve.

1.7 Qendra e leximit në klasë

Qendra e leximit është vendi ku nxënësit praktikojnë leximin, shkrimin dhe shkathtësitë e tjera të komunikimit. Qendra mund të përfshijë një hapësirë të qetë për leximin e librave dhe materialeve të tjera. Kjo hapësirë e qetë u mundëson fëmijëve të shfletojnë librat dhe t'i lexojnë njëri-tjetrit. Mbulimi i dyshemesë me tapet dhe shilte të buta ndihmon në zvogëlimin e zhurmës dhe në krijimin e një mjedisi më të rehatshëm për lexim.



Cilat materiale mund të jenë në dispozicion në qendrën e leximit?

Varësisht nga klasa, mendoni për gjërat në vijim:

- libra të përshtatshëm për moshën e grupit
- libra të krijuar nga fëmijët
- enciklopedi
- alfabeti
- muri i fjalëve
- fjalori i murit
- teli për tharje
- tiketa me shkronja apo fjalë
- revista
- posterë me poezi, tregime dhe këngë
- citate
- letër, lapsa, stilolapsa, ngjyra, goma ngjites
- materiale për krijimin e librave
- kompjuterë
- video kamerë
- kukulla
- kukulla dore dhe kafshë pelushi
- maska dhe kostume për dramë



Këndi i leximit duhet të zhvillojë edhe shkathtësitë e komunikimit verbal.

Fëmijët duhet të inkurajohen për t'i kombinuar librat me lojë aktrimi. Për klasat e ulëta mund të krijohet një teatër kukullash me kukulla, kukulla dore, kafshë pelushi dhe kostume të ndryshme.

Fëmijët më të rritur mund të krijojnë dhe redaktojnë filmat të cilët i bëjnë vetë.



Sigurohu që ka materiale në dispozicion në këndin e leximit në mënyrë që nxënësit të mund ta vlerësojnë dhe korrigjojnë punën e tyre.

Materialet që mund të përfshihen:

- lista fjalësh dhe fjalorë që të mund të kontrollojnë drejtshkrimin
- një fjalor apo mur fjalësh që të mund të identifikojnë fjalët alternative
- posterë me këshilla gramatikore dhe drejtshkrimore që të mund t'i korrigjojnë gabimet që bëjnë
- listat e kritereve për vlerësimin e detyrave, që ta dinë çka është me rëndësi.



Krijimi i librave

Ofroni materiale për krijimin e librave në qendrën e leximit. Qendra e leximit mund të përfshijë letra të madhësive, formave dhe ngjyrave të ndryshme, lapsa me ngjyrë, markerë, karton, kapëse letrash, letër-shpues, ngjitës dhe gjilpëra, si dhe gjëra të tjera të dobishme për libra të krijuar vetë.

Nxënësit më të rritur do të kënaqen duke krijuar libra për nxënësit më të vegjël. Ata gjithashtu mund t'u lexojnë tregime nxënësve më të vegjël dhe t'i dëgjojnë ata duke lexuar.



Karrigia e autorit

Nxënësit që shkruajnë tregimet, poezitë dhe librat e tyre mund t'i lexojnë ato nga "karrigia e autorit" para se t'i shtojnë në koleksionin e bibliotekës së klasës. Mundohuni të gjeni një karrige me formë të pazakontë apo të ndryshme. Ne e dekoruam karrigen në fotografi për ta bërë edhe më të rëndësishme për fëmijët. Kur fëmijët ulen në këtë karrige të veçantë për të lexuar punimin e tyre më të mirë para fëmijëve të tjerë, ata ndihen të rëndësishëm dhe ky aktivitet i inkurajon të shkruajnë me më shumë kujdes.



Lexo më shumë në Pjesën 4

Paraqitja e fjalëve dhe teksteve.

Muri i fjalëve: nxënësit shkruajnë fjalë relevante në tiketa dhe ato paraqiten në mur në mënyrë që të gjithë nxënësit t'i shohin.

Fjalori i murit: varet në mur dhe në të vendosen tiketat me fjalë sipas alfabetit.

Teli për tharje: nxënësit mund ta përdorin për të krijuar fjalë nga tiketat me shkronja dhe fjali nga tiketat me fjalë.



Mëso më shumë në Pjesën 8

1.8 Përdorimi i TIK-ut për të zhvilluar kompetencat e leximit dhe shkrimit

Ka mundësi që fëmijët që sot janë në klasë të parë nuk do të kenë nevojë të përdorin lapsin kur të përfundojnë shkollën pas dymbëdhjetë vitesh. Shumica e bizneseve sot përdorin kompjuterin për komunikimin e tyre dhe shumë familje përdorin postën elektronike (e-mail) dhe mediat si Facebook, Skype dhe Twitter për të mbajtur lidhjet. Telefonat mobilë nuk përdoren vetëm për të biseduar por gjithnjë e më shumë për të komunikuar përmes porosive.

Kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht se mësimi i fëmijëve për të lexuar përmes lapsit (?) është humbje kohe. Veprimi fizik i formimit të shkronjave është mënyrë e mirë për t'iu ndihmuar nxënësit të mësojnë t'iu njohin shkronjat. Megjithatë, është e qartë se mësimdhënësit nuk duhet të kalojnë aq shumë kohë në ushtrime shkrimi si më parë.

Fëmijët mund të shkruajnë duke përdorur tastierën që nga fillimi i shkollimit. Programet në Word kanë përparësi meqenëse nxënësit mund ta kontrollojnë dhe ndryshojnë shkrimin e tyre pa pasur nevojë për ri-shkrim. Kjo i inkurajon nxënësit të jenë më reflektues. Kontrollimi i drejtshkrimit dhe gramatikës nënkupton se nxënësit mund ta vetëvlerësojnë punën e tyre, duke e liruar mësimdhënësin nga ndihma që duhet t'u japë lexuesve dhe shkruarve me vështirësi.



Fëmijët mund të punojnë në çifte për të përpiluar një tekst në kompjuter, duke inkurajuar diskutimin dhe duke u përqendruar në cilësi.

Në shumë vende, gjithnjë e më shumë po blihen online e-libra në vend të librave të shtypur. Edhe pse tani për tani nuk ka shumë të tillë në gjuhën shqipe, numri gjithsesi do të rritet. Ekzistojnë aplikacione kompjuterike, qoftë përmes apo pa nevojën e internetit, të cilat nxënësit mund t'iu shfrytëzojnë për të përmirësuar shkathtësitë e tyre të shkrim-leximit. Në vijim janë disa shembuj:

LIBROTEKA

Libroteka është një bibliotekë online ku mësimdhënësit mund të publikojnë poezi, tregime apo libra të shkruar nga nxënësit. Për nxënësit është shumë motivuese t'iu shohin punimet e tyre të publikuara në internet.

Çdokush mund të qaset në Librotekë për të lexuar artikuj, të cilët mund të “pëlqehen” nga lexuesit. Mësimdhënësit të cilët shtojnë tekste duhet të regjistrohen në faqe. Vetëm mësimdhënësit mund të ngarkojnë materiale në mënyrë që përmbajtja e tyre të jetë e sigurt për nxënësit. Shih vetë në:

<http://www.libroteka.org/>



ARKA E THESARIT

Ueb faqja e Basic Education Program të USAID-it në Kosovë - www.bep-ks.org – ka një hapësirë të quajtur Arka e Thesarit. Ajo përmban shumë burime për mësimdhënësit, duke përfshirë teste vlerësimi për t’i ndihmuar t’i kuptojnë anët e forta dhe dobësitë e nxënësve të vet.



Tabletët PC shfrytëzohen nga mësimdhënësit për të regjistruar dhe analizuar vlerësimet e nxënësve duke përdorur softuerin e zhvilluar nga USAID-i të quajtur **“Tangerine”**.

Edhe ju mund të përpiloni ushtrimet dhe testet e juaja. Për shembull shkruani fillimin e tregimit dhe kërkoni nga nxënësit ta përfundojnë



LIBRAT ONLINE PËR LEXIM

Librat për lexim sipas klasave të hartuar nga Basic Education Program i USAID-it (shih pjesën x) janë në dispozicion online për fëmijët t’i lexojnë në shkollë apo në shtëpi. Librat janë të këndshëm për t’i lexuar dhe të ndarë sipas klasave në mënyrë që teksti të mos jetë shumë i vështirë për nxënësit.

www.bletapunetore.org



PJESA 2

KOMPETENCAT KRYESORE TË LEXUESVE TË SUKSESSHËM:

Kjo pjesë identifikon gjashtë kompetenca të lexuesve të suksesshëm:

- 1. Dëgjim-kuptimi*
- 2. Vetëdija tingullore*
- 3. Fonetika*
- 4. Rrjedhshmëria në lexim*
- 5. Fjalori i fjalëve fotografike*
- 6. Lexim-kuptimi*

Këtu diskutohet pse janë të rëndësishme këto kompetenca, dhe ofrohen këshilla për qasjet e mësimdhënies që përkrahin zhvillimin e këtyre kompetencave.

Në Pjesën 8 mund të gjeni teknika specifike për klasë të cilat mund t'i përdorni gjatë mësimdhënies.

Për të gjitha këto kompetenca mund të mësoni më shumë në kursin e leximit të përpiluar dhe ofruar nga Basic Education Program në www.bep-ks.org.

2.1 Dëgjim-kuptimi

Dëgjimi është mënyra se si fëmijët e mësojnë gjuhën në fillim dhe baza për të gjithë të nxënit tjetër të gjuhës. Foshnjat fillojnë të mësojnë ta kuptojnë të folurit dhe të flasin përmes dëgjimit të tingujve rreth tyre, duke dëgjuar tinguj të të folurit dhe duke ndërtuar njohurinë e tyre të gjuhës së folur.

Dëgjimi është shumë i ndryshëm nga leximi, sepse fëmijës i vjen natyrshëm. Leximi nuk vjen natyrshëm, por duhet të mësohet.

Dëgjimi është gjithashtu thelbësor në mësimin e gjuhës. Shumica e fëmijëve njihen me gjuhën e shkruar duke dëgjuar tregime të cilat u lexohen. Së pari fillojnë të kuptojnë çka është tregimi. Pastaj fillojnë të kuptojnë lidhjen mes asaj që dëgjojnë dhe asaj që shohin të shtypur në faqe, dhe përmes kësaj mësojnë konceptet themelore të shkrimit.

Mësimdhënësit duhet të sigurohen se nxënësit e tyre i kanë zhvilluar shkathtësitë e dëgjim-kuptimit para se të fillojnë të lexojnë.

Gjithashtu fëmijët mësojnë natyrshëm të dëgjojnë teksa kuptojnë, dhe këtë e bëjnë para se të fillojnë të lexojnë. Zakonisht ata i transferojnë strategjitë që zhvillojnë për të kuptuar atë që dëgjojnë në strategjitë për të kuptuar atë që lexojnë. Vështirësitë në lexim-kuptim mund të jenë për shkak të shkathtësive të dobëta në kuptim, shkathtësive të dobëta në lexim, apo kombinim i të dyjave.

Çka është dëgjimi?

Dëgjimi është shumë më shumë se vetëm të dëgjuarit e tingujve, edhe pse ne shpesh i përdorim dëgjimin dhe të dëgjuarit me të njëjtin kuptim. Dëgjimi është proces prej tre hapash – pranimi, vëmendja dhe të kuptuarit:

- 1. Pranimi:** dëgjuesi duhet ta pranojë porosinë, e cila mund të jetë tingull i thjeshtë (d.m.th. të folur) apo kombinim tingujsh dhe stimujsh vizualë (d.m.th. të folur dhe gjestikulacion apo shprehje të fytyrës).
- 2. Vëmendja:** dëgjuesi duhet ta zgjedhë porosinë, të injorojë tingujt e parëndësishëm apo shpërqendruar dhe ta identifikojë apo nxjerrë informatën më të rëndësishme në porosi.
- 3. Të kuptuarit:** dëgjuesi duhet ta kuptojë ose t'i vendosë kuptim porosisë.

Dëgjimi nuk është proces i pranimi pasiv por një veprim shoqëror që përfshin partneritet me folësin. Dëgjuesi i jep sinjale folësit në lidhje me atë që ka kuptuar duke reaguuar përmes pyetjeve, gjestikulacionit, shprehjes së fytyrës apo sjelljes. Kjo nënkupton se "dëgjimi efektiv" duhet të shihet si diçka që përfshin aftësinë e dëgjuesit për të reaguuar në atë mënyrë që ndihmon përhapjen e kuptimit, përfundimin e detyrave, zhvillimin e raporteve të ndërsjella e të kënaqshme. Prandaj është me rëndësi që mësimdhënësia e të dëgjuarit të bëhet sa më ndëraktive që të jetë e mundur.

Mos prisni që fëmijët të dëgjojnë në heshtje, por inkurajojini ata të bëhen dëgjues aktivë!

Në jetën normale, njerëzit nuk dëgjojnë në heshtje dhe pastaj t'u përgjigjen pyetjeve lidhur me atë që kanë dëgjuar. Ata ndërveprojnë në kohë reale me partnerin e tyre komunikues dhe përgjigjen në mënyrë të përshtatshme ndaj asaj që dëgjojnë. Kështu, për shembull, kur prindërit u lexojnë tregime fëmijëve të tyre, ata nuk presin që fëmijët të dëgjojnë në heshtje dhe padyshim nuk presin që ata t'u përgjigjen pyetjeve që kanë të bëjnë me kuptimin më vonë. Më shumë ka mundësi që të bisedojnë përderisa janë duke lexuar dhe fëmijët ka mundësi t'i imitojnë ngjarjet, t'u japin këshilla personazheve, të identifikohen me personazhet ose të tregojnë se çka do të bënin po të ishin në vend të tyre apo çka mendojnë se do të duhej të ndodhte.

Në përgjithësi, kjo është shumë efektive për ta nxitur të kuptuarit, për ta përkrahur lexim-kuptimin dhe gjithashtu për ta shtuar angazhimin aktiv dhe motivimin pozitiv. Është me rëndësi që leximi dhe dëgjimi në shkollë tu ofrojë fëmijëve mundësi të shumta për tu angazhuar dhe për t'u përgjigjur në mënyrë aktive ndaj asaj që dëgjojnë.



Mësimdhënësit duhet ta inkurajojnë diskutimin përderisa e lexojnë tregimin me zë

Ftoni nxënësit të përfshihen në mënyrë aktive në tregim përderisa lexoni me zë. Kohë pas kohe ndaloni së lexuari, parashtroni pyetje për ta nxitur diskutimin dhe kërkoni nga nxënësit të parashikojnë. Qasja e dytë është shumë më e afërt me dëgjimin në jetën reale.

- **Lexo më shumë për leximet me zë në Pjesën 8**

VËMENDJA

Të nxënit do të ndodhë vetëm nëse nxënësit janë të vëmendshëm. Mësimdhënësi duhet të ofrojë aktivitete interesante dhe motivuese të cilat e tërheqin vëmendjen e nxënësve.

Në përgjithësi, fëmijët e vegjël kanë vëmendje për kohë të shkurtër. Mund të përdorni moshën e fëmijës për të vlerësuar numrin e minutave që një fëmijë mund të ketë vëmendje për një detyrë të vetme – kështu 5 minuta për një 5 vjeçar, 7 minuta për një 7 vjeçar, dhe kështu me radhë. Megjithatë, në kushte normale, fëmijët mund të jenë të vëmendshëm më gjatë. Kur një detyrë është interesante apo e re, edhe fëmijët 6-7 vjeçarë mund të jenë në gjendje të jenë të vëmendshëm madje edhe për 30



minuta. Mësimdhënësi duhet gjithnjë t'i monitorojë nxënësit me kujdes dhe të jetë i gatshëm të ndërhyjë para se fëmijët ta humbin interesimin.

Rritja e përqendrimit kërkon kohë, prandaj mësimdhënësit duhet ta shtojnë gradualisht gjatësinë dhe kompleksitetin e asaj që u lexojnë nxënësve. Kur një nxënës fillon të shfaqë shenja të humbjes së vëmendjes, kërkon të mbani vëmendjen e tij edhe për një raund apo edhe për një faqe më shumë. Në këtë mënyrë, ju e zgjatni në mënyrë graduale vëmendjen e tij duke e sfiduar nga pak por jo deri në pikën e irritimit absolut.

Ekzistojnë teknika të caktuara të cilat mund të përdoren për t'i inkurajuar nxënësit të fokusohen dhe ta përqendrojnë vëmendjen e tyre:

Aktiviteti fizik: Fëmijët e vegjël punojnë më së miri kur detyrat (leximi dhe dëgjimi) të cilat kërkojnë që ata të përqendrohen dhe të qëndrojnë ulur e qetë të kombinohen me më shumë aktivitete fizike. Ushtrimet e rrisin funksionimin e trurit, përmirësojnë disponimin dhe shtojnë të nxënit. Kështu:

- Në fillim të ditës, apo pas pushimit, kërkon nga nxënësit të qëndrojnë në këmbë dhe t'ju bashkohen për dy minuta për ushtrime të lehta – çfarëdo aktiviteti që rrit ritmin e zemrës. Pasi të ulen, nxënësit tuaj do të jenë të freskuar dhe të gatshëm për mësim.
- Planifikoni mësimet për t'u dhënë nxënësve mundësi të rregullta për të lëvizur apo për t'u marrë me ndonjë aktivitet fizik. Për shembull, kur janë duke dëgjuar, nëse janë duke dëgjuar ndonjë tregim, kërkon që ta aktojnë ndonjë pjesë të tij.



Motivimi: Zakonisht në nivelin parashkollor dhe në klasën e parë, mbajtja e fëmijëve të motivuar, të interesuar dhe të angazhuar në mësim është thelbësore për ta mbajtur vëmendjen e tyre dhe për ta shtuar kohën që e kalojnë në detyrë. Lojërat në kompjuter janë shembull shumë i mirë si të mbahet vëmendja e fëmijëve. Ato vazhdimisht japin përforsim pozitiv për të vazhduar lojën, dhe vazhdojnë në cikle me intervale të shkurtra ashtu që përforsimet pozitive vijnë shpejt. Pastaj, pas përforsimeve pozitive, paraqesin sfida shtesë. Mësimdhënësit mund të punojnë në mënyrë shumë të ngjashme. Përforsimet pozitive janë shumë të rëndësishme. Po ashtu është me rëndësi edhe shfrytëzimi i momenteve të caktuara. Kur jepni përforsime pozitive paraqisni edhe një sfidë të re.

Tregimi i tregimeve: Asgjë nuk e tërheq vëmendjen e fëmijëve të vegjël siç e tërheq tregimi. Nëse e filloni mësimin e një teme të re me një tregim pesë-minutësh rreth diçkaje që ju ka ndodhur ju, diçka që është relevante për objektivat e mësimin, tregimi do ta tërheqë vëmendjen e nxënësve dhe ata do të jenë në gjendje ta ndërlihdin përmbajtjen e re me të, gjë që do t'ua bëjë shumë më të lehtë t'i kuptojnë dhe mbajnë mend idetë komplekse.

Bëni diçka të papritur: Kur vëmendja e fëmijëve fillon të lodrohet, bëni diçka të papritur. Proveni ta ndryshoni një tregim të njohur për t'i zënë në befasi. Për shembull, kur tregoni përrallën "Mama dhia dhe kecat", në vend që të vijë ujku në derë, thoni që erdhi ariu dhe u tha "Do t'ju kthej të

gjithëve në bretkosa”, dhe kur fëmija i habitur ju thotë se nuk është kështu, kërkoni nga fëmija ta tregojë versionin e saktë.

Imagjinata: Kur i jepni fëmijës detyrë të imagjinojë si duket diçka, si tingëllon, çfarë arome ka, çfarë ndjenje apo shije ka e mban atë të angazhuar në mënyrë aktive gjatë procesit të të nxënës dhe i ndihmon të jetë i vëmendshëm për periudha më të gjata kohore.

Teknika për përmirësimin e dëgjim-kuptimit

Në përgjithësi, shkathtësitë e dëgjim-kuptimit që u duhen nxënësve zhvillohen më së miri duke u parashtruar pyetje të cilat fokusohen në nxjerrjen e përgjigjeve të dëshiruara nga teksti. Ato mund të parashtrohen para, gjatë dhe pas leximit; duke e modeluar për ta të gjithë procesin e pjesëmarrjes si dëgjues aktiv dhe duke u dhënë mundësi t’i zhvillojnë shkathtësitë e tyre me kohë në një mjedis përkrahës përmes “leximeve me zë”.



Shpjegime dhe shembuj të këtyre teknikave kryesore janë dhënë në Pjesën 8. Kursi i leximit gjithashtu ofron një sërë teknikash për dëgjim-kuptimin.

2.2 Vetëdija tingullore

Çka është vetëdija tingullore?

Fëmijët, para se të mësojnë t’i lexojnë shkronjat e shkruara, duhet të vetëdijesohen se shumica e fjalëve përbëhen nga më shumë se një njësi e tingullit, apo **fonemë**, dhe se ato ndikojnë në kuptimin e një fjale. Për shembull, fjala “bora” përbëhet nga katër tinguj: /b/ /o/ /r/ /a/. Nëse ndryshon cilido prej tyre, kuptimi i fjalës do të ndryshojë. Kur /b/ zëvendësohet me /d/, kemi fjalën “dora”. Kur /r/ zëvendësohet me /t/, kemi fjalën “bota”, dhe kështu me radhë.

Vetëdija tingullore është aftësia për të dëgjuar, identifikuar dhe manipuluar me fonema – apo tinguj individualë – që i përbëjnë fjalët e thëna – e që mund ta dallojnë kuptimin.

Vetëdija tingullore është pjesë e **vetëdijes fonologjike**. Përderisa vetëdija tingullore ka të bëjë me tinguj individualë, vetëdija fonologjike përfshin gjithashtu edhe aftësinë për të dëgjuar dhe manipuluar me njësi më të mëdha të tingujve, siç janë rrokjet.

Përkufizimet kryesore:

Tingulli është pjesa më e vogël e një fjale të thënë dhe ka ndikim në kuptimin e fjalës.

Grafema është një shkronjë e alfabetit, apo kombinim shkronjash, që përfaqëson një tingull – për shembull, b, sh, dhe nj.

Hulumtimet kanë treguar se përvetësimi i vetëdijes tingullore në fillim të klasës së parë është parashikuesi më i mirë i suksesit në lexim në të ardhmen.

Vetëdija tingullore është e rëndësishme sepse:

- përmirëson leximin dhe kuptimin e fjalëve nga nxënësit
- ndihmon nxënësit të germëzojnë.

Kjo mund të ndodhë sepse vetëdija tingullore i ndihmon fëmijët të kuptojnë se fjalët, pavarësisht se në çfarë forme paraqiten (të thëna apo të shkruara), përbëhen nga disa tinguj – dhe kështu i bën të kuptojnë se si funksionon alfabeti. Përvetësimi i mirë i vetëdijes tingullore, që përdoret për t'i ndarë dhe për t'i bashkuar tingujt në fjalë, i ndihmon fëmijët për të dekoduar dhe për të kuptuar atë që lexojnë. Vetëdija tingullore u mundëson lexuesve të vegjël të zhvillojnë edhe një element të rëndësishëm të leximit: **fonetikën** (shih pjesën e ardhshme).

Fonetika (raporti mes shkronjave dhe tingujve) ndërtohet mbi vetëdijen tingullore. Vetëdija tingullore ndërton urën e parë mes gjuhës së folur dhe asaj të shkruar. Një fëmijë i cili e kupton si manipulohet me tinguj në mënyrë verbale është i gatshëm ta transferojë këtë njohuri në fjalët e shkruara. Prandaj, nëse fëmijët duhet të përfitojnë nga udhëzimet fonetike, ata së pari duhet të zotërojnë vetëdijen tingullore.

Mësimdhënia e vetëdijes tingullore

Vetëdija tingullore duhet të mësohet në kopsht, në nivelin parashkollor dhe në fillim të klasës së parë. Lexuesit në rrezik duhet të jenë të ekspozuar më shumë se të tjerët ndaj mësimdhënies intensive të vetëdijes tingullore. Por mësimi i vetëdijes tingullore nuk përbën program të plotë leximi. Ai u ofron fëmijëve bazën thelbësore të njohurive për sistemin alfabetik, dhe si i tillë është një komponent i domosdoshëm udhëzimi në kuadër të programit të plotë dhe të integruar të leximit. Duhet përvetësuar edhe disa kompetenca të tjera shtesë për t'u siguruar fëmija do të mësojë të lexojë dhe të shkruajë.

Zhvillimi i vetëdijes tingullore ka ndikim shumë të madh tek lexuesit e rinj. Hulumtimet tregojnë se mësimi i fëmijëve për të manipuluar me tinguj në fjalë është shumë efektiv në kushte të ndryshme të mësimdhënies dhe me nxënës të ndryshëm në klasë dhe moshë të ndryshme, dhe se mësimdhënia e vetëdijes tingullore e përmirëson të lexuarit e tyre shumë më mirë në krahasim me mësimdhënien e cila nuk e përfshin vetëdijen tingullore.

Ekzistojnë shumë mënyra për t'ua mësuar nxënësve vetëdijen tingullore në mënyrë efektive.

Janë identifikuar pesë nivele apo faza në zhvillimin e vetëdijes tingullore:

1. Vlerësimi i tingullit në gjuhën e folur (recitimi i këngëve dhe rimave)
2. Aftësia për të krahasuar dhe ndryshuar tingujt në fjalë duke i grupuar fjalët me tinguj të ngjashëm apo të kundërt (në fillim, në mes dhe në fund të fjalëve)
3. Aftësia për t'i bashkuar dhe ndarë rrokjet
4. Ndarja e tingujve apo aftësia për t'i izoluar tingujt individual në rrokje
5. Aftësia për të manipuluar me tinguj duke i larguar tingujt për të krijuar fjalë të reja

Në vijim janë disa udhëzime për planifikimin e aktiviteteve të vetëdijes tingullore:

- Identifikoni saktësisht detyrën për vetëdije tingullore në të cilën dëshironi të fokusoheni dhe zgjidhni aktivitete të përshtatshme zhvillimore për t'i angazhuar fëmijët në detyrë. Aktivitetet duhet të jenë të këndshme dhe interesante – “luani” me tinguj, mos i “përsërisni” ato.
- Tingujt e zgjatur (p.sh., /m/, /s/, /i/) janë më të lehtë për të manipuluar dhe dëgjuar se sa bashkëtingëlloret e prera (p.sh., /t/, /q/, /p/). Kur prezantohen tingujt e zgjatur, zgjateni pa ndërprerë: *mmmmmmami*; ndërsa për bashkëtingëlloret e prera përdorni përsëritjen e shpejtë: *k-k-k-k-koka*.
- Identifikimi i tingujve në pozita të ndryshme dallon, ku pozita fillestare është më e lehta, e pasuar nga pozita në fund, kurse pozita në mes të fjalës është më e vështira (p.sh., *topi*, *plot*, *bota*).
- Kur i identifikoni apo kombinoni sekuencat e tingujve, modeli BZ duhet të përdoret para modelit ZB, e pasuar me modelin BZB (p.sh., *pa*, *at*, *top*).

Shënim: BZ= bashkëtingëllore-zanore; ZB= zanore-bashkëtingëllore; BZB= bashkëtingëllore-zanore-bashkëtingëllore

Asonanca, përsëritja e tingujve zanorë në fjalë, shpesh herë kombinohet në rima, si në “hopa hopa luajmë topa, tap andej e tap këndej”, “are are abetare, në çdo faqe një dritare, ore ore oj fletore, ca me vija ca katrore”. Nga nxënësit mund të kërkonin edhe të garojnë në krijimin e pyetjeve të cilat rimojnë, si “A e ke parë ndonjëherë kalin duke tërhequr malin?”

Nxënësit duhet t'i mësoni të manipulojnë me tinguj duke i përdorur shkronjat e alfabetit; dhe udhëzimet duhet të fokusohen vetëm në një apo dy lloje të manipulimit të tingujve, e jo në disa.

Fëmijët të cilët nuk mund t'i dëgjojnë dhe të punojnë me tinguj të fjalëve të thëna do ta kenë të vështirë të mësojnë si t'i ndërlikojnë këta tinguj me shkronjat (një shkronjë e alfabetit përfaqëson një tingull, si *ë*, *dh*, dhe *ç*) kur t'i shohin ato në fjalë të shkruara. Lexuesit e rinj mund të tregojnë se e kanë përvetësuar vetëdijen tingullore në disa mënyra:



- duke dalluar cilat fjalë në mesin e disa fjalëve fillojnë me tingullin e njëjtë,
- duke izoluar dhe thënë tingullin e parë apo të fundit në një fjalë,
- duke kombinuar apo bashkuar tingujt e ndarë në një fjalë në mënyrë që ta thonë fjalën,
- duke i ndarë apo segmentuar fjalët në tinguj,



Teknika për mësimdhënien e vetëdijes tingullore

Aktivitetet për mësimdhënien e vetëdijes tingullore fokusohen në ofrimin e mundësive që fëmijët t'i identifikojnë dhe manipulojnë me tinguj në fjalë. Shumë shpesh teknikat varen në zëvendësim – për shembull, të tingujve fillestarë për të krijuar fjalë të ndryshme, apo të fjalëve rimuese në një rimë për të krijuar një kuptim të ri – apo përsëritje – të tingujve të njëjtë në fjalë të ndryshme. Aktivitetet e vetëdijes tingullore, sipas natyrës së tyre, mund të jenë aktivitete grupore të zhurmshme. Shembuj të teknikave për të ndihmuar në zhvillimin e vetëdijes tingullore janë dhënë në Pjesën 9.



2.3 Fonetika

Fonetika është lidhja mes **shkronjës** (simbolit të shkronjës) dhe **tingullit** (njësi të vogla të tingujve). Fonetika është themelore për leximin, sepse të kuptuarit e korrespondencës mes shkronjave dhe tingujve i ofron lexuesit mjete për të zbuluar fjalët e reja të shkruara.

Për lexuesit e rrjedhshëm kjo lidhje duket e natyrshme dhe e kuptueshme. Në realitet nuk ka asnjë lidhje të natyrshme në mes të fjalëve dhe kuptimit të tyre, apo në mes të shkronjave të shkruara dhe vetë fjalës. Fjala dhe forma e saj e shkruar janë konvencionale dhe duhet të mësohen në mënyrë që të komunikojmë. Në mënyrë që ta zotërojmë fonetikën, personi duhet t'i zotërojë shkronjat e alfabetit dhe t'i lidhë ato me tingujt e tyre korrespondues.

Në mënyrë që të kuptohet plotësisht korrespondenca mes shkronjave dhe tingujve, nxënësit duhet të kuptojnë se tingulli vjen në njësi të ndryshme: rrokje, tinguj, nisma dhe rima:

Rrokja është një njësi e gjuhës e cila përbëhet nga një tingull i vetëm i papenguar. Një fjalë mund të përbëhet nga një apo më shumë rrokje. Për shembull, “top” ka një rrokje; “bota” i ka dy rrokje. Një rrokje mund të përbëhet nga një apo më shumë tinguj.

Tingujt janë njësi të vogla të cilat janë të bashkuara për të krijuar rrokje apo fjalë. Tingujt në rrokje janë të ndara në **nisma** dhe **rima** apo kombinim i të dyjave.

Nisma është çdo bashkëtingëllore e paraqitur para një zanoreje në rrokje. Për shembull, në fjalën “plot”, /p/ është nisma.

Rima është çdo zanore dhe bashkëtingëllore e pasuar nga nisma. Për shembull, në “plot”, /ot/ është rima.

Ndikimi i fonetikës në aftësinë e leximit

Zakonisht lexuesit kanë një fjalor të fjalëve të cilat janë të njohura për ta, dhe të cilat i njohin sapo t’i shohin. Këto fjalë quhen “fjalori i fjalëve fotografike” dhe janë shumë të rëndësishme për lexim të rrjedhshëm. Por zakonisht çdo tekst, përveç atij më të thjeshtit, përfshin së paku disa fjalë të cilat nuk janë pjesë e fjalorit fotografik të lexuesit. Shumë nga këto fjalë lexuesi i kupton si fjalë të folura, por ndoshta nuk i ka hasur më parë si fjalë të shkruara.

Këtu bëhet e qartë rëndësia e fonetikës. Kur lexuesit, në një tekst, hasin fjalë të cilat nuk i njohin kur i shohin, ata përdorin elementet e fonetikës për t’i përkthyer fjalët e shkruara në tinguj. Këta tinguj konvertohen në fjalë të folura, të cilat pastaj mund të përkthehen në kuptim. Këtë proces e quajmë “dekodim”.

Fonetika është thelbësore për këtë proces. Prandaj udhëzimet e fonetikës kanë ndikim të madh në aftësitë e leximit tek fëmijët e vegjël dhe janë veçanërisht të rëndësishme përderisa mundohen të kalojnë nga tekstet themelore, të shkruara kryesisht duke përdorur fjalorin fotografik, në tekste më komplekse. Hulumtimet tregojnë se zotërimi i fonetikës ka ndikim shumë të gjerë në lexim, por edhe se ndikimi i saj zvogëlohet me kohë:

- Fëmijët të cilët marrin udhëzime të fonetikës në klasat e ulëta (0-1) shfaqin përfitime të mëdha në lexim-kuptim e germëzim dhe njëkohësisht zhvillim të moderuar në shkathtësitë e leximit me zë.
- Fëmijët të cilët mësojnë fonetikë në klasat 2-6 shfaqin zhvillim në të njëjtat fusha por më pak se ato që shihen tek nxënësit e klasave më të ulëta.
- Në klasat e larta, udhëzimet e fonetikës kanë ndikim pozitiv në aftësinë për të dekoduar dhe germëzuar fjalë të reja, por nuk kanë ndikim të madh në lexim-kuptim.

Fjalori fotografik

përbëhet nga fjalët të cilat personi mund t’i identifikojë menjëherë kur i sheh të shkruara, pa pasur nevojë t’i dekodojë apo t’i analizojë.

Dekodimi është përdorimi

i njohurive të raporteve shkronjë-tingull për t’i theksuar saktë fjalët e shkruara. Dekodimi u mundëson fëmijëve t’i theksojnë fjalët të cilat nuk i kanë hasur më parë të shkruara.

Hulumtimet tregojnë rëndësinë e zotërimit të fonetikës sa më herët që është e mundur.

Mësimdhënia e fonetikës


Udhëzimet e fonetikës ndërlidhin zhvillimin e vetëdijes tingullore përmes të folurit dhe dëgjimit me shkronjat e shkruara, ashtu që fëmija mund ta transferojë njohurinë e vet të tingujve në fjalë të shkruara. Prandaj, para se të mësohet fonetika, fëmija duhet të ketë vetëdije të mjaftueshme tingullore – ai duhet të kuptojë që fjalët janë të krijuara nga tingujt, dhe gjithashtu duhet të njohë disa tinguj.

Në gjuhën shqipe, ndërlidhja mes shkronjave dhe tingujve është racionale; prandaj lexuesit mund ta mësojnë fonetikën në moshë mjaft të hershme dhe t'i zbatojnë njohuritë e tyre në shqiptimin e çdo fjale të re. Prandaj, në gjuhën shqipe udhëzimet e fonetikës duhet të fillojnë sa më herët që të jetë e mundur; dhe fonetika duhet të zotërohet kryesisht deri në fund të klasës së parë.

Ekzistojnë disa mënyra se si mund të zbatohet fonetika në lexim.

Fonetika sintetike i ndërton fjalët nga baza. Në këtë qasje lexuesi i lidh shkronjat me tingujt e tyre përkatës (njësitë tingullore) dhe pastaj i bashkon ato për të krijuar fjalë. Për shembull, nëse një lexues has në fjalën "molla" dhe nuk e njeh atë, ai do ta shqiptojë secilin segment të fjalës (/m/ /o/ /ll/ /a/) dhe pastaj do t'i bashkojë këta tinguj për ta thënë fjalën e plotë.

Fonetika analitike, në anën tjetër, i qaset fjalëve nga lart. Fjala identifikohet si njësi e plotë dhe pastaj zbërthehet në lidhjen shkronjë-tingull. Kjo qasje është kryesisht e dobishme kur lexuesi has në fjalë që janë të vështira për t'i lexuar (siç janë "shtëpia", "shtaga" dhe "shtylla") dhe si përforsim i fjalëve fotografike. Fonetika analitike përdor pjesët e njohura të fjalës për t'i zbuluar fjalët e reja. Kur zbatohet fonetika analitike për fjalën "drapri" lexuesi e vëren se pjesa e dytë e fjalës është e njëjtë si fjalët tjera të njohura ("gjarpri"). Atëherë ai mund ta zbatojë njohurinë e tij të fonetikës për ta dekoduar me lehtësi fjalën.



Teknika për t'i ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave në fonetikë mund të gjenden në Pjesën 9 dhe në kursin e leximit të ofruar nga BEP.

2.4 Zhvillimi i Rrjedhshmërisë në Lexim

Çka është rrjedhshmëria?

Rrjedhshmëria në lexim nuk është domosdoshmërisht si rrjedhshmëria orale. Rrjedhshmëria orale është aftësia për të lexuar mirë me zë; por ka raste kur një lexues mund të jetë lexues i rrjedhshëm pa zë pa qenë i rrjedhshëm në lexim me zë.

Prandaj, një pjesë e rrjedhshmërisë është aftësia për t'i dekoduar fjalët në tekst me shpejtësi dhe saktësi. Por ka mundësi që të dekodohen fjalët pa e kuptuar në të vërtetë domethënien e tyre. Një lexues i cili kupton atë që lexon mund të lexojë me shprehjen e duhur dhe t'i njohë dhe përsërisë fjalët e autorit. Prandaj, rrjedhshmëria kryesisht përfshin jo vetëm shpejtësinë dhe saktësinë, por edhe metrikën, që nënkupton leximin me ritëm, theks dhe intonacion që reflekton të folurit e natyrshëm.


Një lexues i rrjedhshëm mund të lexojë me lehtësi, shprehje dhe kuptim. Një lexues i rrjedhshëm nuk lexon fjalë për fjalë, por mund të procesojë më shumë se një fjalë në të njëjtën kohë. Lexuesit e rrjedhshëm e kuptojnë atë që lexojnë, dhe mund ta korrigjojnë veten apo të kthehen pas për ta rishikuar tekstin kur diçka nuk ka kuptim.

Raporti mes rrjedhshmërisë dhe të kuptuarit

Ekzistojnë dëshmi të mira se rrjedhshmëria e leximit oral dhe lexim-kuptimi janë shumë të ndërlidhura. Por raporti nuk është i drejtpërdrejtë. Një lexues i cili mund t'i dekodojë fjalët me shpejtësi dhe saktësi është patjetër më i prirur ta kuptojë atë që lexon; por të kuptuarit gjithashtu varet nga disa procese mendore të cilat nuk janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me shikimin apo dekodimin e tekstit. Nuk e dimë me saktësi nëse aftësia për të lexuar me shprehje të saktë e ndihmon të kuptuarit, rrjedh nga ai, apo është thjesht nën-produkt i të njëjtit grup të proceseve.

Sidoqoftë, rrjedhshmëria e leximit pa zë, e cila ka më shumë mundësi ta ndihmojë të kuptuarit, është e pamundur të matet. Mësimdhënësit mund ta masin vetëm rrjedhshmërinë e leximit me zë.


Ekzistojnë dëshmi të forta për Kosovë, nga Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta i mbajtur në qershor 2012 (shih tabelën), se nxënësit merrjedhshmëri të ulët orale gjithashtu kanë të kuptuar të dobët, dhe anasjelltas. Por edhe pse nuk ka dizim



që shihet në grafik, kishte nxënës të cilët kishin rrjedhshmëri të lartë orale por të kuptuar të ulët. Kjo tregon se mësimdhënia e rrjedhshmërisë orale pa mësimdhënien e të kuptuarit nuk garanton sukses. Gjithashtu kishte nxënës (edhe pse më pak) me rrjedhshmëri të ulët orale por të kuptuar të mirë. Ata ishin në gjendje të kuptonin, edhe pse nuk mundën të lexojnë mirë me zë. Kjo tregon se rrjedhshmëria dhe rrjedhshmëria orale nuk janë domosdoshmëri të njëjta.



Mësimdhënia e rrjedhshmërisë orale



Mësimdhënia eksplicite e rrjedhshmërisë është e rëndësishme, sidomos në klasat e ulëta. Fëmijët që nga klasat parashkollore deri në klasën e katërt përfitojnë më së shumti nga rrjedhshmëria kur mësohet në mënyrë eksplicite, kështu që udhëzimet e rrjedhshmërisë janë shumë të rëndësishme për këto klasa. Udhëzimet e rrjedhshmërisë vazhdojnë të jenë të dobishme për nxënësit me vështirësi në lexim edhe kur janë në klasa më të larta.

Fëmijët me rrjedhshmëri të mirë lexojnë më shumë dhe mbajnë mend më shumë nga ajo që kanë lexuar sepse harxhojnë më pak energji konjitive në dekodim dhe kështu kanë më shumë energji në dispozicion për të kuptuar dhe për tu kënaqur me atë që lexojnë.

Megjithatë, mësimdhënia e rrjedhshmërisë orale nuk garanton sukses në vetvete. Ajo duhet të ndërlihet me zhvillimin e shkathtësive në të kuptuar, sidomos me të kuptuarit e informatave të nënkuptuara. Udhëzimet e rrjedhshmërisë përmirësojnë shumë aftësinë e nxënësve për t'i dekoduar fjalët e panjohura, dhe shpejtësinë me të cilën i dallojnë fjalët e njohura. Prandaj rrjedhshmëria shërben si urëlidhje mes dekodimit dhe të kuptuarit.

Teknika që ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë rrjedhshmërinë në lexim mund t'i gjeni në Pjesën 9.

2.5 Fjalori fotografik

Fjalët fotografike janë ato fjalë të cilat lexuesi mund t'i dallojë sapo t'i shohë dhe kështu nuk ka nevojë t'i dekodojë. Dekodimi është detyrë komplekse dhe kërkon kohë; prandaj, pasi që rrjedhshmëria varet nga aftësia e lexuesit për të lexuar shpejt dhe saktë, fjalori i mirë fotografik e rrit rrjedhshmërinë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme në klasat e ulëta, kur fjalët e mundshme fotografike mund të përbëjnë nga 50% deri 70% të të gjitha fjalëve në tekstet që lexojnë fëmijët. Kur një lexues i ri është në gjendje ta procesojë këtë përqindje të fjalëve në një faqe pa pasur nevojë t'i dekodojë, atëherë rritet rrjedhshmëria dhe të kuptuarit.

Fëmijët lexojnë më rrjedhshëm kur mund t'i njohin fjalët e plota. Prandaj udhëzimet e fjalëve fotografike duhet të fillojnë që në nivelin parashkollor dhe të vazhdojnë gjatë klasës së parë dhe të dytë.



Qëllimi kryesor gjatë mëimit të fjalëve fotografike është përsëritja dhe ekspozimi i shumëfishtë. Krijoheni Murin e Fjalëve. Posa të mësohet një fjalë fotografike, vendoseni në Murin e Fjalëve. Pasi të mësohen fjalët, fillimisht mbajini në "Fjalorin e Murit", në mënyrë që kur nxënësit i shkruajnë t'i tërheqin dhe t'u referohen.

Përdorni disa mënyra për t'i mësuar fjalët fotografike:

- Shqiptojeni fjalën përdërisa e tregoni në tiketë apo në tabelë.
- Përdorni tiketat apo posterët me fjalë të shkruara nën fotografi.

- Lejoni nxënësit ta praktikojnë fjalorin fotografik përmes lojërave – për shembull, lojëra me letra ku duhet t'i bashkohen dy letra me të njëjtën fjalë në to.
- Kërkoni nga nxënësit t'i gjejnë fjalët e kundërta në Murin e Fjalëve – për shembull, nxehtë- ftohtë, apo madh-vogël.
- Kërkoni nga nxënësit t'i germëzojnë fjalët fotografike duke përdorur shkronja individuale nga tiketat.

Mos ndani më shumë se dhjetë minuta gjatë një ore mësimore për zhvillimin e fjalorit fotografik; dhe si rregull, në çdo njëzet minuta që ndani për shkathtësitë e dekodimit/fonetikës, ndani dhjetë minuta për fjalorin fotografik.

Hulumtimet tregojnë se zhvillimi i leximit gjatë nivelit parashkollor dhe viteve të para të shkollës fillore varet shumë nga dy gjëra: shkathtësitë e dekodimit dhe fjalori fotografik. Hulumtimet gjithashtu tregojnë se fjalori – numri i fjalëve të cilave ua dinë kuptimin – në parashkollor dhe klasë të parë është parashikues i fortë jo vetëm i aftësisë momentale të lexim-kuptimit, por edhe i lexim-kuptimit pas dhjetë vitesh.

Shkollat në Kosovë janë kryesisht shumë të suksesshme në mësimdhënien e dekodimit. Dëshmitë nga Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta në gjuhën shqipe tregojnë se deri në fund të klasës së dytë, pothuaj se të gjithë fëmijët i njohin shkronjat dhe tingujt e tyre, dhe rreth tre të katërtat e tyre kanë nivel të pranueshëm të shkathtësive të dekodimit. Por, nëse shkollat nuk i kushtojnë vëmendje mësimin të fjalorit, nivelet e ulëta të fjalorit mund të vazhdojnë t'i pengojnë fëmijët edhe kur e zotërojnë dekodimin e fjalëve të shkruara.

Mësimi i fjalorit nënkupton më shumë se vetëm shpjegimin e fjalëve të reja nga teksti. Disa nga fjalët e zakonshme dhe themelore mësohen si fjalor fotografik (d.m.th. për t'i identifikuar pa i dekoduar). Kjo është e mirë për zhvillimin e shkathtësive themelore të leximit, por pasi që janë fjalë të zakonshme, nuk ofron shumë mundësi për zhvillimin e vërtetë të fjalorit. Për të pasur ndikim të dobishëm në zhvillimin e fjalorit nevojitet që për çdo vit të shtohen nga disa qindra rrënjë fjalësh me kuptime të reja. Kjo kërkon një regjim të rregullt, ndoshta ditor të mësimin të fjalorit në klasat e ulëta.

Shkollat duhet t'i kushtojnë vëmendje mësimin të fjalorit. Ato duhet të synojnë disa qindra rrënjë fjalësh në vit.

Cilat fjalë të mësohen?

Një problem tjetër është se nuk ka ndonjë listë përfundimtare të fjalorit të cilën nxënësit duhet ta dinë. Mësimdhënësit duhet të zgjedhin në bazë të ekspozimit dhe përvojës së nxënësve në lidhje me gjuhën.

Një listë e fjalëve kryesore për t'u mësuar në Klasën e Parë dhe të Dytë është dhënë në Pjesën 10.

Fjalori mund të ndahet në tre kategori:

Lloji i fjalëve	Shpjegimi	Shembujt
Niveli 1	Fjalë themelore, të njohura, që përdoren shpesh	ora, kërce, bebe, gëzuar
Niveli 2	Fjalë të shpeshta që përdoren nga përdoruesit e mirë të gjuhës në disa fusha përmbajtësore - përdorim i shpeshtë	shikim, rehat, rastësi, vështrim, keqardhje, rrëmujë, rastësi, absurd, nxitim, këmbëngul
Niveli 3	Fjalë të rralla, shpeshherë të kufizuara në ndonjë fushë specifike përmbajtësore	gadishull, klimë, siujdhesë, bërthamë, vendbanim, avullim

Niveli 1 i fjalëve mund të mos ketë nevojë për t'u mësuar si fjalor pasi që ka shumë mundësi që nxënësit t'i dinë, por kontrolloni nëse secili nxënës i njeh. Është me rëndësi të mos harroni t'ua mësoni nxënësve fjalët e **Nivelit 3** në mënyrë eksplicite: edhe pse ato janë të rëndësishme të mësohen vetëm kur paraqitet nevoja. Fjalët e **Nivelit 2** janë "fjalët e rëndësishme", fjalë të cilat do të jenë kryesisht të dobishme për nxënësit për ta kuptuar gjuhën e të rriturve.

Mësimdhënësit duhet të kenë strategji për identifikimin dhe zgjedhjen e "fjalëve të rëndësishme" për mësim eksplicit dhe rishikim të mëvonshëm. Një mënyrë e mirë për ta bërë këtë është të mbledhen fjalët e Nivelit 2 gjatë javës nga leximet me zë, diskutimet, tekstet e klasës, etj., dhe pastaj, për shembull të premtën, të mësohen në mënyrë eksplicite, si dhe të përsëriten fjalët nga javët e kaluara.

Identifikimi i Fjalëve të "Nivelit 2"

Cilat fjalë duhet t'i mësojë një fëmijë varet nga fjalët që paraqiten gjatë diskutimit të mësimit, në tekste shkollorë dhe ndërveprime të tjera. Nuk ka ndonjë listë përfundimtare. Është përgjegjësi e mësimdhënësit t'i identifikojë fjalët për mësim. Kriteret për identifikimin e fjalëve të mundshme të "nivelit 2" mund të përfshijnë:

- Sa është e dobishme fjala në përgjithësi? A është fjalë të cilën nxënësit ka mundësi ta hasin edhe në tekste tjera? A do të ishte e dobishme për nxënësit në përshkrimin e përvojave të tyre?
- A është fjalë të cilën nxënësit nuk e njohin plotësisht dhe saktë?
- Sa ndërlidhet ajo fjalë me fjalët tjera, me idetë që i kanë nxënësit apo me ato që janë duke mësuar?
- Çka sjell fjala në një tekst apo situatë? Çfarë roli luan fjala në komunikimin e kuptimit të një situatë në të cilën është përdorur? Çfarë roli luajnë fjalët në raport me disponimin dhe ngjarjen e tregimit?

Çfarë do të thotë ta dish një fjalë?

Para se të vendosim nëse duhet t'u mësohet ose jo një fjalë, mësimdhënësi duhet të kontrollojë se sa nxënës e njohin atë fjalë. "Ta dish" apo "të mos e dish" një fjalë nuk është situatë bardh-e-zi.

Për shembull, nxënësit mund të:

1. Të mos e dinë fjalën
2. Ta kenë parë apo dëgjuar fjalën
3. Të dinë diçka për të, ta ndërlidhin me ndonjë situatë
4. Ta dinë mirë, mund ta shpjegojnë dhe ta përdorin

Nxënësit ngjiten në këtë shkallë prej 1 deri në 4 përmes ballafaqimeve të shumëfishta me fjalën. Prandaj mësimdhënësit mund ta përdorin këtë shkallë për të mbledhur informata nga nxënësit përmes vetëvlerësimit dhe pastaj t'i përdorin informatat e mbledhura për t'iu referuar në planifikimin e mësimdhënies së fjalorit. Mësimdhënësi duhet t'u japë nxënësve shkallën, një listë të fjalëve të cilat mendon t'ua mësojë atyre dhe të kërkojë prej tyre që ta vendosin secilën fjalë në një pikë të shkallës. Në vijim mësimdhënësi do të jetë në gjendje të shohë sa nxënës të klasës tashmë e dinë secilën fjalë dhe cilat fjalë nuk i dinë mirë, apo cilin nivel të njohurive kanë arritur. Pastaj ajo do të jetë në gjendje t'i zgjedhë fjalët për t'ua mësuar dhe të planifikojë mësimdhënien në bazë të nivelit të njohurive të nxënësve.

Mësimdhënia e fjalorit

Mësimdhënia eksplicite e fjalorit është treguar shumë efektive. Vëmendja duhet të përqendrohet në fjalët e nivelit 2 ("fjalët e rëndësishme").

Konceptet themelore në mësimdhënien e fjalorit

Në përgjithësi, ekzistojnë katër mënyra përmes të cilave nxënësit e mësojnë fjalorin e ri: para-mësimdhënia; të nxënësve të rastësishëm; shkathtësitë përmbajtësore dhe ekspozimi i përsëritur.


Para-mësimdhënia: Mësimdhënia e fjalëve të panjohura në lidhje me një tekst mu para leximit të tij është një nga metodat më efektive për t'i ndihmuar fëmijët në mësimin e fjalëve të reja. Para leximit të një teksti të ri, mësimdhënësi, qoftë vetëm apo bashkë me fëmijët, duhet ta shikojë tekstin për të përcaktuar cilat fjalë ka gjasa të jenë të panjohura. Pastaj këto fjalë duhet të përcaktohen dhe të diskutohen. Diskutimi i kuptimit të fjalëve u mundëson nxënësve të zhvillojnë të kuptuarit e mënyrave se si përdoret fjala, si dhe përkufizimin e saj në fjalor. Nxënësit duhet ta lexojnë tekstin menjëherë pas para-mësimdhënies së fjalorit.

Të nxënësve të rastësishëm: Siç e kemi paraqitur më lart, fjala "njohuri" zhvillohet përmes disa fazave. Kur nxënësit e shohin fjalën në kontekst u ndihmon atyre të njihen me të dhe të fillojnë t'ia qëllojnë çka do të thotë. Ky lloj i njohurisë të rastësishme e bën mësimin e kuptimit të një fjale dhe përdorimit të saj shumë më të lehtë. Prandaj, mësimdhënësit duhet të përdorin me qëllim fjalor të pasur (fjalët e llojit 2) kur flasim me nxënësit e tyre. Edhe pse këto terma nuk mësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, ato megjithatë e pasurojnë fjalorin e nxënësve.

Shkathtësitë kontekstuale: Në disa raste (pa dyshim jo gjithmonë) ka mundësi të qëllohet kuptimi i një fjale duke u bazuar mbi "idetë" rreth saj kur përdoret në një tekst. Fjalët e tjera në fjali apo paragraf, nëntitujt, ilustrimet dhe titulli i ofrojnë lexuesit informata të cilat mund t'i shfrytëzojë për ta përcaktuar kuptimin e fjalëve të panjohura. Këtyre karakteristikave shpeshherë u referohemi si "ide kontekstuale" sepse ato gjenden në kontekst të pjesës së shkrimit e jo jashtë saj. Mësimdhënësit duhet ta modelojnë gjetjen dhe përdorimin e ideve kontekstuale për të nxënësit e fjalëve të reja të fjalorit, në mënyrë që nxënësit e rinj t'i zhvillojnë këto shkathtësi.

Ekspozimi i përsëritur: Është e lehtë të harrohet fakti se sa më shumë që i ekspozohemi një fjalë, aq më i sigurt bëhet të kuptuarit e saj. Mësimdhënësit duhet të sigurohen që fjalori i ri dëgjohet dhe përdoret disa herë, qoftë duke e përdorur vetë në klasë, duke e rishikuar atë në mësimdhënien eksplicite, apo në të dyja, në mënyrë që ai të bëhet pjesë e fjalorit të nxënësit.

Teknikat për mësimdhënien e fjalorit



Leximi i përbashkët (shih pjesën 8) është teknikë e mirë për të modeluar çka duhet të bëjmë kur hasim një fjalë që nuk e dimë (p.sh. përdorimi i ideve kontekstuale, fjalorit). Leximet me zë janë gjithashtu shumë efektive sepse ofrojnë mundësi që nxënësit të ekspozohen ndaj fjalorit më kompleks.

2.6 Lexim-kuptimi

Të kuptuarit është qëllimi kryesor i leximit

Të kuptuarit nuk është thjesht “nxjerrje e informatave eksplicite nga një tekst”, por një grup shkathtësish shumë më komplekse. Nga njëra anë, “nxjerrja” përfshin të kuptuarit jo vetëm të asaj që autori e ka thënë në mënyrë eksplicite, por edhe atë që nënkuptohet. Nga ana tjetër, lexuesit e mirë nuk ndalen te “nxjerrja” e kuptimit që është në tekst.



Autori mundohet të komunikojë me lexuesin përmes tekstit, dhe lexuesi i mirë mundohet të shohë brenda në mendjen e autorit për ta marrë porosinë.

Lexuesit e suksesshëm e “ndërtojnë” kuptimin duke i përdorur “kapacitetet, aftësitë, njohuritë dhe përvojat” e tyre për ta vizualizuar atë që po ndodh, për t’i bashkangjitur motivet personazheve, ose parashikojnë çka mund të ketë ndodhur apo çka do të ndodhë, jashtë tekstit aktual.

Kjo nënkupton se nuk ka kuptim ose interpretim të plotë apo të saktë të tekstit. Të kuptuarit varet, së paku pjesërisht, në atë që lexuesi i caktuar sjell në tekst. Kështu që, përderisa disa aspekte të të kuptuarit të tekstit nga individit mund të jenë “të sakta”, të tjerat mund të ndryshojnë ndërkohë që rriten dhe zhvillohen. Kjo nuk do të thotë se të kuptuarit “e hershëm” është “i gabuar” dhe të kuptuarit “e mëvonshëm” është “i saktë”. Kjo do të thotë se të kuptuarit nuk është gjendje; ai është proces dhe, në vlerësimin e të kuptuarit, mësuesit duhet të mendojnë jo vetëm për “saktë” dhe “gabim”, por për mënyrat se si t’i ndihmojnë nxënësit t’i testojnë dhe rafinojnë interpretimet e tyre.

MOTIVIMI

Hulumtimet tregojnë se vlera që nxënësit ia japin leximit është kritike për suksesin e tyre gjatë të nxënësve të leximit.

Vlerësimi i leximit vjen kryesisht nga të kuptuarit se leximi është i vlefshëm dhe i dobishëm. Nxënësit ndikohen shumë në këtë aspekt nga besimet dhe sjelljet e mësuesve dhe moshatarëve të tyre. Por hulumtimet gjithashtu sugjerojnë se niveli i motivimit të nxënësve për të lexuar ndërlidhet edhe me besimin që individit ka për kompetencën e tij/saj. Faktorët e tjerë të cilët janë identifikuar si të rëndësishëm për motivimin për lexim përfshijnë zgjedhjen; kohën që kalohet duke biseduar për libra; detyrat pas leximit të librit; dhe llojet e teksteve në dispozicion.

Nxënësit vetëdijesohen për vlerën e leximit kryesisht duke parë të rriturit, të cilët ata respektojnë, që në mënyra të ndryshme e praktikojnë dhe e vlerësojnë leximin.

Nëse të rriturit kanë qëndrim pozitiv ndaj leximit, lexojnë me kënaqësi dhe e konsiderojnë leximin informues e të vlefshëm, ka gjasa që fëmija të zhvillojë qëndrim pozitiv ndaj leximit.

Vetëdijesimi për kompetencë zhvillohet përderisa fëmija e vlerëson performancën e vet pas leximit. Nëse beson se ka qenë i suksesshëm, fëmija është më të gatshëm të provojë detyra të ngjashme dhe më sfiduese. Nga ana tjetër, mësuesit duhet të theksin tek garimi është kryesisht demotivuese në këtë aspekt, pasi që e fokuson vëmendjen e nxënësve tek krahasimi i kompetencës së tyre me nxënësit më të suksesshëm e jo me qëllimet e kurrikulës.

Motivimi – Çka tregojnë hulumtimet

- Gjithnjë paraqite leximin në mënyrë pozitive
- Ofroju nxënësve mundësi për vetë-vlerësim
- Jepu nxënësve informata kthyesë pozitive kur është e mundur
- Ofroju nxënësve shumëllojshmëri sa më të madhe të librave
- Lejoji nxënësit të bëjnë zgjedhje kur është e mundur
- Krijë mundësi për nxënësit që të diskutojnë çka kanë lexuar

Kur i pyesim fëmijët cilët janë faktorët që e stimulojnë interesimin e tyre për leximin e një teksti të dhënë, pa marrë parasysh nëse është narrativ apo përshkrues, përgjigjet janë se faktorët që ndikojnë më së shumti janë shumëllojshmëria e teksteve në dispozicion dhe liria për të zgjedhur, së bashku me marrëdhënien mes librit dhe interesave të tyre personale.

Kjo sugjeron se ka shumë rëndësi mjedisi ku nxënësit kanë qasje relativisht të lirë – bibliotekat dhe zgjedhja e lirë.

Zakonisht, kur diskutohet një tekst përshkrues, nxënësit fokusohen kryesisht në njohuritë që marrin prej tij, dhe në afërsinë e tekstit me interesat e tyre personale; kur flasin për një tekst narrativ, ata fokusohen tek zhanri dhe lloji i tekstit dhe tek ajo që i tërheq ata në tekst; e pastaj i tërheq kopertina interesante dhe ngjarjet plot aksion dhe humor.

Një faktor tjetër me rëndësi për ngritjen e motivimit është koha që kalohet duke diskutuar për libra. Në përgjithësi fëmijët tregojnë se kanë dëshirë t'i shkëmbejnë librat, të dinë çka lexojnë të tjerët dhe t'i ndajnë mendimet e tyre për atë që lexojnë. Kjo vlen qoftë kur shkëmbimi i mendimeve është joformal, për shembull me anëtarët e familjes, apo më formal, p.sh. përmes raportimeve në lidhje me librat në klasë.

Një mësuese në një shkollë në Prishtinë nuk ishte e kënaqur me motivimin për lexim të nxënësve të saj. Ajo vendosi ta diskutonte këtë me nxënësit e saj dhe vërejti se faktori më demotivues ishte raporti që nxënësit duhej ta shkruanin pasi e lexonin librin. Së bashku, ata vendosën që secili nxënës të sillte nga 3-4 libra në klasë dhe se ato do ta përbënin bibliotekën e klasës për atë vit. Mësuesja i kontrolloi librat për t'u siguruar se ishin të përshtatshëm për moshën e nxënësve. Nxënësit duhet të zgjidhnin nga një libër nga biblioteka e klasës, ta lexonin dhe të raportonin për të. Pjesa interesante ishte se raportimi ishte i ndryshëm secilën herë. Një herë, nxënësit duhej t'i vizatonin ngjarjet kryesore të librit në një fletë të madhe letre dhe të bisedonin për librin para tërë klasës; herën tjetër librin e njëjtë duhej ta lexonin nga dy nxënës dhe ta përgatisnin raportimin së bashku; një herë nxënësit duhej të përgatisnin një prezantim në PowerPoint në lidhje me librin; një herë tjetër nxënësit ishin të lirë ta zgjidhnin mënyrën se si do ta prezantonin librin që kishin lexuar. Në këtë mënyrë nxënësit u kënaqën duke lexuar libra dhe duke biseduar për librat që kishin lexuar.

SHKATHTËSITË E LEXIM-KUPTIMIT

Duke ditur se lexim-kuptimi është kompleks, mësuesit nuk duhet të presin që nxënësit thjesht t'i kenë shkathtësitë e nevojshme, por t'i përkrahin ata në zhvillimin e tyre. Ekzistojnë tre nivele të shkathtësive:

- **Nxjerrja e informatave të drejtpërdrejta** – kjo është kryesisht ajo që gjendet në fund të tregimit në tekste shkollë. Në fund të tregimit janë 2-3 pyetje për nxënësit ku përgjigjet e tyre janë të dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tregim dhe mund të gjenden shumë lehtë. Edhe pse është shkathtësi themelore dhe nxënësit duhet ta zotërojnë para zhvillimit të shkathtësive të tjera, të kuptuarit nuk përfundon këtu.

- **Ndërtimi i ideve nga informatat e nënkuptuara** – kjo është një shkathtësi që u ndihmon lexuesve të bëjnë lidhje logjike, të përdorin ide dhe “të lexojnë mes rreshtave” për të nxjerrë informata të nënkuptuara dhe për të kuptuar çfarë ka menduar autori. Edhe pse ka përgjigje të sakta për pyetjet e nënkuptuara, është shumë me rëndësi që nxënësit të ndihen të lirë t’i shprehin mendimet e tyre. Mësimdhënësit duhet të përdorin pyetje si: “Pse mendon ashtu?” “Cila pjesë e tregimit të ndihmoi për ta krijuar këtë ide?” Në këtë mënyrë mësimdhënësi i ndihmon nxënësit të shprehin lirshëm dhe t’i kthehen tregimit për t’u siguruar që e kanë përgjigjen e saktë. Mësimdhënësit mund ta përdorin tregimin nga tekstet shkollore për të përpiluar pyetje të cilat kërkojnë nxjerrjen e informatave të nënkuptuara, apo edhe të shkruajnë vetë tregime në lidhje me temat e përditshmërisë të cilat janë relevante dhe interesante për nxënësit.
- **Reflektimi në lidhje me informatat** – krijimi i lidhjeve me atë që personi lexon, përvojat e tyre personale dhe njohuritë e përgjithshme është proces i natyrshëm. Lexim-kuptimi ka të bëjë gjithashtu edhe me ndërtimin e mendimit, dhe ne nuk mund ta ndërpresim procesin e të menduarit edhe po të donim, andaj pse të mos e shfrytëzojmë këtë fakt? Ekzistojnë shumë aktivitete të cilat mësimdhënësit mund t’i bëjnë me tregime të ndryshme.
 - Kërkoni nga nxënësit të bëjnë një vizatim në lidhje me tregimin/pjesën e tregimit që kanë lexuar. Përderisa vizualizojnë, ata sjellin edhe njohurinë dhe përvojën e tyre në lidhje me temën në fjalë.
 - Diskutoni për atë që do të bënin po të ishin një personazh i caktuar i tregimit.
 - Kërkoni nga ata që të shpjegojnë pse mendojnë se personazhet janë sjellë në atë mënyrë (nëse nuk ka informata të nënkuptuara në lidhje me sjelljen e tyre)
 - Kërkoni nga ata ta shkruajnë një përfundim tjetër për tregimin.

Të shohim çfarë ka bërë një mësuese në Lipjan për ta përkrahur zhvillimin e këtyre shkathtësive: Mësuesja e zgjodhi një tregim që ishte i shkurtër, interesant dhe kishte mjaft informata të nënkuptuara në të. Pastaj ajo i përpiloi disa pyetje të cilat nxirrnin informata të drejtpërdrejta, informata të nënkuptuara dhe u mundësonte nxënësve të reflektonin.

Mësuesja e filloi orën mësimore duke u dhënë nxënësve tregimin për ta lexuar në mënyrë individuale. Ajo u dha kohë të mjaftueshme në mënyrë që të gjithë nxënësit të kishin mundësi ta lexonin tregimin. Përderisa nxënësit lexonin, ajo lëvizte nëpër klasë duke u fokusuar tek lexuesit e ngadaltë. Pasi nxënësit e lexuan tregimin, ajo u parashtroi rreth 15 pyetje tërë klasës. Për ta mbajtur vëmendjen e nxënësve dhe për t’i angazhuar të gjithë, ajo lëvizte nga pyetjet që kërkonin përgjigje të drejtpërdrejta tek ato të nënkuptuara dhe anasjelltas. Mësuesja u kujdes që t’u jepte nxënësve kohë të mjaftueshme për t’i formuluar përgjigjet e tyre. Duke e bërë këtë, dhe duke u kujdesur që lexuesit e ngadaltë t’u përgjigjeshin pyetjeve më të thjeshta, ajo i ndihmoi ta zhvillonin vetë-besimin e tyre. Ajo gjithashtu përdori nën-pyetje për të kuptuar arsyet pas përgjigjeve dhe për t’i përkrahur nxënësit t’i shprehnin mendimet e tyre. Duke u dhënë nxënësve mundësinë për të diskutuar përgjigjet e tyre, ajo u siguroi që të jepeshin përgjigjet e sakta pa pasur nevojë të thoshte se përgjigja ishte e gabuar. Kjo qasje i ndihmon nxënësit të mësojnë të argumentojnë

Pas aktivitetit me tërë grupin, mësuesja i dha secilin grup të vogël nga një fletë me një dorë të vizatuar në të. Në secilin gisht të dorës kishte të shkruar nga një pyetje. Nxënësit duhej të diskutonin dhe t’u përgjigjeshin pyetjeve. Pesë pyetjet në dorë ishin përzierje e informatave

të drejtpërdrejta, të nënkuptuara dhe reflektuese. Kjo punë në grupe ishte shfrytëzim efektiv i kohës gjatë orës mësimore, ku të gjithë nxënësit ishin të angazhuar dhe shprehnin idetë e tyre. Ky aktivitet mund të vazhdohet më tej duke u kërkuar nxënësve të punojnë në dyshe dhe t'i parashtronë njëri-tjetrit nga një pyetje në lidhje me tregimin.

Në fund të orës mësimore, mësuesja kërkoi nga nxënësit që për detyrë shtëpie të gjenin nga një titull tjetër për tregimin. Detyrat e shtëpisë duhet të jenë diçka që nxënësit kanë dëshirë të bëjnë. Duke u dhënë këtë detyrë, mësuesja u siguroi që nxënësit do ta lexonin tregimin edhe një herë, ta kuptonin dhe ta ndërlihnin me përvojat dhe njohuritë e tyre, si dhe ta përdornin kreativitetin për të gjetur një titull tjetër për atë tregim.

Prandaj, gjatë orës mësimore, mësuesja:

- U siguroi që të gjithë ta lexojnë tregimin duke u dhënë kohë të mjaftueshme për të lexuar.
- U siguroi që të gjithë nxënësit të jenë të vëmendshëm duke i përzier pyetjet e drejtpërdrejta dhe të nënkuptuara dhe duke mos bërë ndarje mes pyetjeve të lehta / lexuesve të ngadaltë dhe pyetjeve të vështira / lexuesve të mirë.
- U dha nxënësve më shumë mundësi të përgjigjen duke përgatitur më shumë pyetje.
- U dha kohë nxënësve të ngadaltë / të tërhequr t'i formulojnë përgjigjet duke pritur mjaftueshëm për të marrë përgjigje.
- Parashtroi nën-pyetje për të kuptuar arsyet e përgjigjeve, u dha nxënësve mundësi të argumentojnë dhe mori përgjigje të saktë edhe në rastet kur përgjigja ishte e gabuar. Me këtë, mësuesja u ndihmoi nxënësve të shprehen lirshëm pa pasur frikën e dhënies së përgjigjes së gabuar.
- E rriti kohën në detyrë dhe e zvogëloi ndjenjën e numrit të madh të nxënësve duke u dhënë nxënësve punë në grupe për të diskutuar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve.
- U siguroi që nxënësit ta lexojnë tregimin edhe një herë duke u dhënë një detyrë shtëpie interesante dhe sfiduese.

Për t'i ndihmuar mësime të mësuara në zhvillimin e orëve të tilla mësimore, BEP ka përpiluar disa tekste model dhe materiale udhëzuese për klasat 2 dhe 5, duke përfshirë shembuj se si mund të përpilohen pyetjet shpesh duke u bazuar në tregimet ekzistuese në tekstet shkollore.

STRATEGJITË E LEXIM-KUPTIMIT

Megjithatë, shumë mësime të mësuara ballafaqohen me një problem tjetër në lidhje me lexim-kuptimin – ata dinë si t'i përpilojnë pyetjet e lexim-kuptimit të cilat testojnë shkathtësi të ndryshme si ato që u përmendën më lart; por nuk dinë si t'i mësojnë nxënësit t'u përgjigjen atyre. Ata e dinë se parashtrimi i pyetjeve të të kuptuarit për të cilat nxënësit kanë vështirësi për t'u përgjigjur i ndihmon të kuptojnë nivelin e të kuptuarit të nxënësve; por kjo në fakt nuk i ndihmon nxënësit të mësojnë se si t'u përgjigjen pyetjeve.

Zgjidhja nuk është t'u mësohen këto shkathtësi drejtpërdrejt, por të fokusohen në mësimin e disa strategjive të cilat mund t'i përdorin për t'i ndihmuar të kuptojnë dhe të mos e harrojnë atë që kanë lexuar. Strategjitë e dëshmuara përfshijnë:

- a) **Parashikimi:** Lexuesit e mirë i parashtrajnë vetes pyetje para se të lexojnë duke e shikuar titullin dhe fotografitë. *Për çka mendoj se bën fjalë ky tregim? Pse mendoj ashtu? Çka mund të mësoj? A di diçka në lidhje me këtë temë?*
- b) **Vizualizimi:** Lexuesit e mirë krijojnë pamje në mendjet e tyre kur lexojnë. Kjo i ndihmon të mbajnë mend atë që lexojnë dhe ta kuptojnë më mirë atë që lexojnë.
- c) **Parashtrimi i pyetjeve:** Lexuesit e mirë i parashtrajnë vetes pyetje përdherisa lexojnë për t'u siguruar se kanë kuptuar. *A kishte kjo kuptim për mua? A pati ndonjë pjesë që më duhet ta lexoj sërish?*
- d) **Bërja e lidhjeve:** Lexuesit e mirë bëjnë lidhje me gjërat tjera që i kanë lexuar, apo atë që tashmë e dinë. Kjo mund të bëhet para, gjatë apo pas leximit. *Çka më kujtoi ky tregim? A është ky tregim i ngjashëm me të tjerët që kam lexuar? I ndryshëm?*
- e) **Nxjerrja e informatave:** Lexuesit e mirë nxjerrin informata, ose lexojnë mes rreshtave. *Çka po ndodh në tregim që nuk është thënë? Pse po ndodhin këto gjëra? Çka mund të mendojë apo ndjejë personazhi?*
- f) **Përcaktimi i rëndësisë:** Lexuesit e mirë e gjejnë cilat pjesë të tregimit janë të rëndësishme, dhe cilat nuk janë. *Çka dëshiron të thotë autori? A ka tregimi ndonjë porosi?*
- g) **Përmbledhja:** Lexuesit e mirë e pyesin veten pasi që lexojnë. *Për çka bënte fjalë ky tregim? Çka mësova? Përdor organizuesit grafik (shih faqe 131 për 'hartën e tregimit') për t'i ndihmuar nxënësit ta bëjnë këtë.*



Dallimi mes pyetjeve të të kuptuarit dhe këtyre strategjive është se strategjitë janë disi “të përgjithshme” ndërsa pyetjet janë “specifike”. Për shembull, “nxjerrja e informatave” u jep nxënësve udhëzime të përgjithshme se si të nxjerrin informata. Praktikimi i përgjigjes në këto pyetje të përgjithshme do t’i ndihmojë nxënësit të përgatiten për t’u përgjigjur pyetjeve specifike “që nxjerrin informata” kur të vijë rasti.

Në të kundërtën, të mësuarit e nxënësve që t’u përgjigjen një vargu pyetjesh “që nxjerrin informata” supozon se nxënësi do të jetë në gjendje të ndërtojë një procedurë të përgjithshme nga shembujt specifikë – e kjo është në përgjithësi shumë më e vështirë. Prandaj, “strategjitë” u ofrojnë nxënësve udhëzime si të angazhohen në përgjithësi me tekstin – e jo si t’u përgjigjen pyetjeve specifike.

Pjesa 8 shumë shembuj të teknikave që i mësojnë këto strategji.

VIZUALIZIMI

Vizualizimi është teknikë e rëndësishme për ta kuptuar tekstin dhe lexim-kuptimin.



Vizualizimi përfshin krijimin e një imazhi të qartë në mendje duke u bazuar në atë që lexon. Vizualizimi mund të përfshijë shenja, tinguj, aroma, shije dhe ndjenja – gjithçka që e bën skenën më reale.

Informatat e reja janë të vështira për trurin për t’u kuptuar dhe mbahen mend thjesht sepse janë të reja. Një pamje është më e lehtë për trurin të kuptohet dhe të mbahet mend. Kështu që vizualizimi i momenteve të rëndësishme në tekst ndihmon t’i regjistroni dhe t’i mbani ato në trurin tuaj.

Kur vizualizoni me sukses, ju:

- e kapni momentin e rëndësishëm në tekst
- përfshini sa më shumë detaje të ndjenjave që është e mundur
- angazhoni emocionet tuaja
- e sillni imagjinatën në tekst dhe e bëni pronë tuajën.

Në vend që të përdorni vetëm fjalë, ju e angazhoni imagjinatën tuaj dhe të gjitha ndjenjat. Kjo krijon lidhje personale mes lexuesit/dëgjuesit dhe tekstit, dhe ju ndihmon t'i imagjinoni personazhet për të cilat lexoni. Vizualizimi e bën më të lehtë përafrimin e ndjenjës me dikë për të cilin lexoni dhe me ndjenjat dhe mendimet e tyre. Kjo ju ndihmon ta kuptoni më thellë tekstin – i jep jetë tekstit.

Prandaj, vizualizimi e bën përvojën e leximit më kuptimplotë. Nxënësit të cilët vizualizojnë kur lexojnë gjithashtu mund ta rikujtojnë atë që kanë lexuar për periudha më të gjata kohore. Ka gjasa që të jenë gjithashtu më të motivuar për të lexuar.

Zhvillimi i shkathtësive të vizualizimit të nxënësve

Kur zgjidhni një tekst për një aktivitet vizualizimi, filloni me një pjesë që përmban gjuhë përshkuese dhe folje të forta dhe që ofron mundësi për imazhe të qarta. Nuk është e domosdoshme të fillohet me tërë librin – një fjali apo një paragraf i formuluar mirë është pikënisje më e mirë për një mësim vizualizimi.

Lexoni një pjesë të shkurtër dhe, përderisa lexoni, përshkruani imazhet të *cilat i shihni në mendjen tuaj*. Për shembull, mund ta përdorni citatin në vijim nga *Ku janë gjërat e egra*:

“Mu atë natë, në dhomën e Maksit, një pyll u rrit e u rrit e u rrit, deri sa tavani u mbush me hardhi dhe muret u bënë bota përreth.”

Pasi ta lexoni këtë citat, ndajeni me nxënësit imazhin që keni vizualizuar përderisa e lexuat: *Përderisa e lexova këtë pjesë, unë mendova për fjalët dhe imagjinova ...*

Kur përfundoni me shkëmbimin e mendimeve tuaja, lejoni nxënësit ta provojnë të njëjtën teknikë vetë. Ofroni sugjerimet në vijim.

Përderisa unë lexoj, mbyllini sytë dhe dëgjoni me kujdes. Jini të vëmendshëm dhe mendoni për atë që ndodh në tregim. Shikoni nëse mund ta imagjinoni skenën të cilën e përshkruajnë fjalët. Bëni sikur po xhironi një film; çka do të shihnit pas kamerave?

Përderisa dëgjoni, kur përmenden fjalët përshkuese (mbiemrat) – si nxehtë, kuq, i lagësht, apo qetë – përdorni ato fjalë për të ju ndihmuar ta pikturoni pamjen në kokën tuaj.

Pasi t'i dëgjojnë fjalitë që u lexohen një apo dy herë, kërkoni nga nxënësit t'i ndajnë imazhet e tyre gjatë diskutimit në klasë. Me siguri përshkrimet e nxënësve do të dallojnë. Për shembull ... (përmbajtje e përshtatshme për tekstin). Theksoni se vizualizimi mund të ndryshojë. Sigurohuni që t'i vlerësoni dhe çmoni idetë e nxënësve:

- Nëse nxënësit krijojnë imazhe që nuk i përshtaten fjalëve, ndihmojini ta ri-mendojnë imazhin e tyre dhe ta përshtasin. (Kjo është një strategji tjetër efikase e të kuptuarit)

- Nëse krijojnë imazhe që u përshtaten fjalëve, lavdëroni dhe inkurajoni diskutimet për krahasime/dallime.
- Nëse nxënësit kanë vështirësi në krijimin e imazhit, provoni ndonjë ushtrim tjetër të shkurtër të leximit me zë dhe praktikoni sërish modelimin. Parashtroni pyetje për t'i udhëhequr në krijimin e imazheve në mënyrë individuale – pyetje si *A ju kujton kjo ndonjë gjë nga jeta juaj? A mendoni se kjo është e njëjtë si e juaja? Apo është e ndryshme?*

Mos harroni se nuk ka një përgjigje të saktë.

Aktivitetet pasuese

Pasi që fillojnë nxënësit ta kuptojnë konceptin e vizualizimit, përforcojeni atë kohë pas kohe. Përfshijeni këtë ushtrim në leximet me zë apo leximet e heshtura ditore:

- Për ta inkurajuar vizualizimin, kërkoni nga nxënësit t'i mbyllin sytë përderisa dëgjojnë.
- Shpesh ndaloni që nxënësit t'i ndajnë me klasën imazhet dhe pamjet në mendjen e tyre .
- Me nxënësit e vegjël, lexoni me zë një libër me ilustrime, duke i treguar vetëm një pjesë të ilustrimeve.
- Pastaj kërkoni nga ta t'i krijojnë ilustrimet e tyre duke u bazuar në tekstin e lexuar.
- Kërkoni nga lexuesit më të avancuar të krijojnë një pamje apo përshkrim me shkrim të një personazhi apo ngjarje duke u bazuar në një pjesë të romanit që e ka lexuar tërë klasa.
- Kërkoni nga nxënësit e vegjël të cilët mbajnë shënime që të tregojnë për ato që kanë lexuar në regjistra apo ditarë dhe të vizatojnë imazhe në ditarët e tyre, duke i regjistruar pamjet mendore që u përgjigjen leximeve të tyre.
- Parashtroni pyetje si: "Nëse do të bënit një film të bazuar mbi librin tuaj, kush do të dëshironit të luante rolin e personazheve kryesore?" "Si do të dukej skena?" dhe "Ku do të dëshironit ta xhironit filmin?"
- Kombinoni imazhet fizike dhe idetë në lidhje me ndjenjat që do t'i përjetonin personazhet.
- Inkurajoni nxënësit me vështirësi t'i pyesin nxënësit tjerë si kanë ardhur deri te idetë e tyre dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.

Gjatë procesit, mund të kaloni nga tekstet përshkruese në tekste shpjeguese.

Shënime:



PJESA 3: LEXIMI FUNKSIONAL

Ekzistojnë dy lloje kryesore të përmbajtjeve të leximit.

Në **përmbajtjet funksionale** ne lexojmë për të na ndihmuar të arrijmë një qëllim të caktuar.

Në **përmbajtjet e lira** ne zgjedhim të lexojmë për interesin, kënaqësinë apo zbavitjen tonë personale.

Edhe leximi funksional mund të jetë i këndshëm, sidomos kur përfshin zgjidhjen e problemeve, por gjithmonë ka të paktën një shtytës që na nxit të mendojmë se çfarë po përpiqemi të arrijmë.

Teksti i njëjtë mund të lexohet qoftë si përmbajtje e lirë apo si përmbajtje funksionale, varësisht nga qëllimi i leximit. Për shembull, leximi i një tregimi të shkurtër për kënaqësi është lexim i lirë; leximi i një tregimi të shkurtër si detyrë në shkollë është lexim funksional.

Leximi funksional është ajo që nxënësit duhet të bëjnë tërë kohën për t'i përfunduar detyrat në shkollë, në punë dhe në jetën e tyre të përditshme. Pothuaj se të gjitha vendet e punës kërkojnë një sasi leximi, qoftë ajo shenja dhe udhëzime të thjeshta apo memorandume, e-maila ose dokumente tjera më komplekse.

Leximi funksional është i rëndësishëm edhe për aktivitetet e përditshme në shtëpi dhe në komunitet, si drejtimi i veturës, blerja, gatimi dhe pagesat e faturave të ndryshme.

Përdorimi i leximit në situata të jetës së përditshme

Leximi është shkathtësi thelbësore në shkollë dhe shoqërinë e gjerë. Librat nuk janë mediumi i vetëm të cilin do ta hasin nxënësit. Leximi na duhet për t'i përdorur kompjuterët, për t'i përcjellë shenjat, lexuar udhëzimet, plotësuar formularët.

Kur nxënësit e kuptojnë se leximi është shkathtësi e dobishme jetësore, janë më të motivuar të mësojnë gjatë orëve të gjuhës.

Në shumë klasa, materiali i vetëm i shkruar të cilin e mësojnë nxënësit janë librat. Mësimi i nxënësve për kontekste të ndryshme të leximit i ndihmon të kenë më shumë vetëbesim dhe të jenë më strategjikë në të lexuarit e tyre. Hulumtuesit na tregojnë se leximi gjithnjë dallon në bazë të kontekstit. Lexuesit e mirë dinë si ta kuptojnë vendndodhjen, tekstin dhe qëllimin, po ashtu si të zgjedhin strategjinë më të mirë për atë kontekst. Për shembull, një situatë që përfshin të kuptuarit dhe rikujtimin e detajeve kërkon strategji të ndryshme nga një situatë ku lexuesi kërkon informata specifike, por memorizimi nuk është i domosdoshëm.



Në klasë, mësimdhënësit duhet të sigurojnë shumëllojshmëri materialesh të shkruara për nxënësit që t'i përfundojnë, diskutojnë dhe përfundojnë.

Këtu janë disa shembuj të dokumenteve funksionale me të cilat duhet të njihen nxënësit:

- revista,
- e-maila
- letra
- blogje
- letra informative
- orare
- broshura
- shpallje
- katalogje
- ueb faqe
- formularë aplikimi
- procedura
- udhëzime
- meny



Kategoria		Vendi		Data		Orari	
Emri	Adresa	Qyteti	Posta	Fillimi	Përfundimi	Orari	Orari
1	1	1	1	1	1	1	1
2	2	2	2	2	2	2	2
3	3	3	3	3	3	3	3
4	4	4	4	4	4	4	4
5	5	5	5	5	5	5	5
6	6	6	6	6	6	6	6
7	7	7	7	7	7	7	7
8	8	8	8	8	8	8	8
9	9	9	9	9	9	9	9
10	10	10	10	10	10	10	10

Tabela xx, në vijim rendit lloje të ndryshme të dokumenteve me të cilat duhet të njihen nxënësit gjatë shkollimit të tyre. Në të janë identifikuar katër përdorime funksionale të leximit:

- Leximi për t'i përcjellë udhëzimet
- Leximi për të marrë informata
- Leximi për të shfrytëzuar referenca, dhe
- Leximi për të plotësuar formularë

Tabela XX: Llojet e leximit funksional

Leximi për të përcjellë udhëzime	
<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimet për gatim • Udhëzimet për qepje • Manualet për riparime • Hartat rrugore • Udhëzimet për lojëra 	<ul style="list-style-type: none"> • Udhëzimet për punëdore dhe hobi • Udhëzimet për ndihmën e parë • Udhëzimet për larje/etiketat • Oraret e autobusit • Shenjat në ndërtesa/rrugë
Leximi për të marrë informata	
<ul style="list-style-type: none"> • Orari i TV-së • Reklammat në filma • Informatat e sportit • Reklammat për kërkesa • Reklammat për ushqim/veshmbathje 	<ul style="list-style-type: none"> • Menytë • Parashikimi i motit • Tabelat e temperaturës • Reklammat për biçikleta • Reklammat për skejtbord
Leximi për të përdorur referenca	
<ul style="list-style-type: none"> • Regjistri i telefonit • Përmbajtje të revistave • Indeksi i gazetës • Faqet e verdha • Indeksi i manualit për rregullim 	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistri i shërbimeve • Manuali për punë • Regjistri i reklamave • Fjalori • Fjalorthi i termave
Leximi për të plotësuar formularë	
<ul style="list-style-type: none"> • Anëtarësimi në klub • Regjistrime • Garime/sajuese • Klube të xhirimeve • Formularë në bankë 	<ul style="list-style-type: none"> • Formularë të shkollës • Aplikacione për punë • Klube të librave • Formularë të postës • Formularë për reklama

Detyra autentike të shkrimit

Detyrat autentike kërkojnë nga nxënësit t'i aplikojnë njohuritë e tyre ekzistuese për të zgjidhur probleme të jetës reale. Natyra autentike apo e jetës reale, e një detyre e bën që puna e nxënësit të jetë relevante dhe interesante. Bota e punës ofron shumë kontekste për detyra autentike, por ndërlidhjet me botën reale mund të jenë edhe aktivitetet e përditshmërisë, si blerja e një shtëpie, përcaktimi i ushqimeve të shëndetshme për një familje dhe organizimi i një feste familjare. Duke kërkuar nga nxënësit ta zgjidhin një problem të jetës reale, një detyrë autentike, krijojmë një urëlidhje mes përmbajtjes që mësohet në klasë dhe arsyes pse kjo njohuri është e rëndësishme në jetën jashtë saj. Shumica e gjërave që kërkojmë nga nxënësit t'i bëjnë në klasë janë të sajura. Jeta në botën reale nuk kërkon nga ju të zgjidhni nga mundësitë A, B, C, apo D. Një detyrë autentike mund t'ju ndihmojë ta bëni punën në klasë relevante për nxënësit duke kërkuar nga ata t'i marrin këto vendime të jetës reale.

Të kuptuarit e pyetjeve të shkruara

Edhe pse në jetën reale rrallëherë hasim në pyetje të shkruara, ato janë veçori e arsimimit në shkollë të cilin do ta hasin nxënësit në tekste shkollore, vlerësime dhe teste.



Raporti Pyetje-Përgjigje (RPP)

Strategjia Raporti Pyetje-Përgjigje (RPP) i ndihmon nxënësve të kuptojnë si janë hartuar pyetjet dhe çka u duhet për t'iu përgjigjur atyre. Ajo prezanton një raport të tre-anshëm në mes të pyetjeve, përmbajtjes së tekstit dhe njohurive të lexuesit.

Së pari, strategjia RPP i ndan pyetjet në dy kategori të mëdha: pyetjet “Në Libër” (të drejtpërdrejta në tekst) dhe pyetjet “Në Kokën Time” (të nënkuptuara nga teksti). Pyetjet “Në Libër” nxirren drejtpërdrejt nga teksti. Ato ndahen në dy nën-grupe: pyetjet “Mu Aty”, ku fjalët e pyetjes e udhëheqin lexuesin ku të kërkojë dhe përgjigja është e dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst; dhe pyetjet “Mendo dhe Kërko”, ku lexuesi duhet ta përpilojë përgjigjen nga disa informata dhe t'i gjejë ato në vende të ndryshme në tekst. Përgjigjet “Në Kokën Time” paraqiten përderisa lexuesi angazhohet me tekstin. Sërish, ato ndahen në dy nën-grupe: pyetjet “Autori dhe Ju” bazohen në informatat që gjenden në tekst por nxënësi duhet t'i ndërlidhë ato me përvojën e vet. Edhe pse përgjigja nuk gjendet drejtpërdrejt në tekst, nxënësi duhet ta lexojë atë që t'i përgjigjet pyetjes. Pyetjet “Sipas Meje” nuk kërkojnë nga nxënësi ta lexojë tekstin, por të përdorë njohuritë dhe përvojën paraprake për t'u përgjigjur.

Në Libër	Në Kokën Time
<p>Mu Aty</p> <p>Përgjigja gjendet lehtë. Shpeshherë fjalët në pyetje gjenden në tekst. Pyetja dhe përgjigja mund të jenë në të njëjtën fjali.</p>	<p>Autori dhe Ju</p> <p>Përgjigja nuk është në tekst. Lexuesi e kombinon njohurinë paraprake me informatat nga teksti për ta përpiluar përgjigjen.</p>
<p>Mendo dhe Kërko</p> <p>Përgjigja gjendet në tekst, por kërkon mbledhjen e informatave nga disa vende dhe përmbledhjen e tyre për ta formuluar përgjigjen.</p>	<p>Sipas Meje</p> <p>Përgjigja nuk është në tekst. Lexuesi përdor përvojën paraprake për t'u përgjigjur.</p>

Strategjia RPP i ndihmon nxënësit t'iu kuptojnë dy llojet kryesore të pyetjeve dhe faktin që, përderisa përgjigjet ndaj disa pyetjeve nxirren lehtë nga teksti, të tjerat kërkojnë përgjigje më komplekse, ndërsa disa të tjerave mund t'iu jepet përgjigje vetëm duke përdorur njohuritë apo përvojën e përgjithshme. Prandaj, RPP i ndihmon nxënësit të kuptojnë se së pari duhet të marrin parasysh pyetjen para se ta përpilojnë përgjigjen. Ajo u ofron disa ide për proceset e ndryshme me anë të të cilave mund t'iu përgjigjen pyetjeve. Ajo i mëson nxënësit si të parashatrojnë pyetje në lidhje me leximin e tyre dhe të mendojnë për tekstin, si dhe i sfidon të përdorin shkathtësi të nivelit më të lartë të të menduarit.

Përdorimi i Strategjisë Raporti Pyetje-Përgjigje (RPP)

- 1) Shpjegojuni nxënësve kategoritë kryesore dhe nën-grupet e pyetjeve. Përcaktoni secilin lloj të pyetjeve dhe jepni nga një shembull.
- 2) Ofroni një pjesë të shkurtër për lexim dhe disa pyetje në lidhje me të. Lexoni pjesën me zë.
- 3) Modeloni vendndodhjen e pyetjeve në kornizën e modelit RPP. Kur të përfundoni me leximin, lexoni pyetjet me zë për nxënësit dhe modeloni se si keni vendosur cilin lloj të pyetjes ju është kërkuar t'iu përgjigjeni.
- 4) Tregojuni nxënësve si t'iu gjejnë informatat për t'iu përgjigjur pyetjeve (d.m.th. në tekst, nga përvoja personale, etj.).
- 5) Pastaj, ndajeni klasën në grupe të vogla dhe ofrojini secilit grup nga një pjesë për lexim dhe disa pyetje. Kërkoni nga grupet t'iu vendosin pyetjet në kornizën RPP.
- 6) Në fund, ofrojuni grupeve nga një pjesë leximi dhe kërkoni të përpilojnë pyetje nga përmbajtja e tyre. Kërkoni nga nxënësit t'iu vlerësojnë pyetjet e tyre sipas kornizës RPP.

Shënime:





PJESA 4: TË SHKRUARIT

Fëmijët duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë fjalët para se t'i prodhojnë dhe përdorin; dhe plani i mësimdhënies duhet ta ketë parasysh këtë fakt. Por fëmijët fillojnë të shkarravisin posa ta kuptojnë se shkrimi bart kuptim.

Diku rreth moshës 6 dhe 8 vjeç shumica e nxënësve duhet ta kenë zhvilluar stilin e tyre personal të të shkruarit dhe duhet të jenë në gjendje të manipulojnë me format e shkrimit që t'iu përshtaten qëllimeve të tyre.

Ata mund të kuptojnë si t'i zhvillojnë pjesët e tregimit, sidomos përmes shkrimit të paragrafëve dhe si strukturohen paragrafët.

Ata gjithashtu bëhen shkrimtarë gjithnjë e më të rrjedhshëm – mund t'i formojnë shkronjat saktë, të kenë kontroll mbi gramatikën, drejtshkrimin dhe pikësimin, mund të zgjedhin fjalorin e përshtatshëm, dhe shkrimi i tyre është koheziv dhe koherent.

Përdorimi i Word procesorëve në kompjuterë nënkupton se nxënësit mund të bëjnë siç bëjnë shkrimtarët dhe autorët në jetën e tyre reale. Ata mund ta rishikojnë, redaktojnë dhe rishkruajnë punimin e tyre, edhe për saktësi edhe për cilësi shprehëse.

Ata mund të shkruajnë lloje të ndryshme të teksteve, nga shkrimi artistik e deri te shkrimi funksional si raporte, përshkrime, etj.

Fazat zhvillimore në shkrim

Shkrimi zhvillohet përmes pesë fazave kryesore:

- a) Vetëdija fillestare:** Fëmijët e vegjël shkarravisin, gjë që mund të duket e pakuptimtë, por këto janë përpjekjet e tyre për ta imituar të shkruarit. Që në këtë fazë të hershme, fëmijët kuptojnë se shkrimi dhe vizatimi janë të ndryshëm, se shkronjat përmbajnë një porosi dhe se shkrimi ka një drejtim. Që në fillim, ata i japin kuptim shenjave të tyre, u drejtohen dhe “thonë” çka nënkuptojnë ato. Rreth moshës katër-vjeçare, ata fillojnë të përdorin lëvizje të ndryshme kur vizatojnë dhe “shkruajnë”. Shenjat e “shkrimit” janë të lidhura njëra pas tjetrës, ndërsa shenjat e “vizatimit” nuk janë. Por kjo nuk do të thotë se i kuptojnë shkronjat plotësisht.
- b) Shkrimi emergjent apo eksperimental:** Në nivelin parashkollor, fëmijët fillojnë të merren me shkronja. Në fillim, ata prodhojnë forma që u ngjasojnë shkronjave por në fakt nuk janë shkronja. Pastaj fillojnë të shkruajnë shkronja të vërteta, shkronja të ndryshme pa ndonjë radhë të caktuar. Në vijim fillojnë të shkruajnë shkronja dhe vargje shkronjash. Zakonisht, ky proces fillon me emrin e fëmijës. Në fillim ata nisin ta identifikojnë atë si fjalë të tërë. Pastaj mundohen ta theksojnë shkronjën e parë dhe e përdorin në fjalë të ndryshme, shpesh herë së bashku me “shenja si shkronja” apo shkronja të ndryshme. Kur fillojnë të kuptojnë për shkronjat e tjera në emrin e tyre dhe si t’i shqiptojnë, ata fillojnë t’i përdorin për t’i germëzuar fjalët tjera. Në këtë fazë ata duhet gjithashtu t’i kuptojnë “konceptet themelore” të shkrimit, që organizohet nga e majta në të djathtë dhe nga lart poshtë, si dhe se ekziston korrespondencë një me një mes fjalëve të shkruara dhe të thëna. Në këtë fazë fëmija fillon të provojë “shprehjen” me shkrim – forma të njohura të shkrimit, p.sh. lista, shkronja, tregime, porosi, duke përdorur struktura të thjeshta të gjuhës së folur. Ata mund ta “lexojnë” shkrimin e tyre.
- c) Përktimi i shkrimit të hershëm:** Rreth moshës 5-6 vjeçare, fëmijët ende mundohen ta përfaqësojnë një rrokje apo fjalë me një shkronjë të vetme, zakonisht me bashkëtingëlloren e parë; por fillojnë të shtojnë bashkëtingëllore dhe zanore të fundit. Në këtë fazë ata do të duhej të fillojnë të kuptojnë për hapësirën në mes të fjalëve, pikësimin dhe shkronjat e mëdha. Sa i përket të shprehurit, ata e kuptojnë shkrimin si komunikim dhe mund të shpjegojnë disa përdorime të shkrimit si lista për blerje apo porosi telefoni si ndihmë për të mbajtur mend. Ata mund t’i zgjedhin temat e tyre për shkrim, të shkruajnë për temat që janë të rëndësishme për ta duke përdorur disa forma të njohura të tekstit, dhe shpesh herë e plotësojnë shkrimin e tyre me vizatime. Ata mund ta “lexojnë” shkrimin tyre, edhe pse nuk është sipas normave.
- d) Shkrimi sipas normave:** Rreth moshës 6-7 vjeçare, fëmijët i njohin shumicën e aspekteve të procesit të shkrimit. Kontrolli i tyre mbi strukturën mund të dallojë varësisht nga detyra. Ata mund të përdorin shkronja të mëdha dhe pika, por ende nuk e kuptojnë plotësisht pikësimin. Ata kanë njohuri për fjalët më të shpeshta. Mund të zgjedhin forma të cilat u përshtaten qëllimeve të ndryshme, të krijojnë një titull për tregimin e tyre dhe ta shkruajnë një tregim me fillim, mes dhe fund. Ata mund të fillojnë ta përdorin dialogun dhe ta redaktojnë punën e tyre, qoftë në mënyrë individuale apo përmes dialogut me të tjerët.
- e) Shkrimi me mjeshtëri:** Diku rreth moshës 6-8 vjeçare, shkrimtarët e zhvillojnë stilin e tyre personal të shkrimit dhe janë në gjendje të manipulojnë me forma të shkrimit për t’iu përshtatur qëllimeve të tyre. Ata kanë kontroll mbi pikësimin, mund ta zgjedhin fjalorin e përshtatshëm dhe shkrimi i tyre është koheziv dhe koherent. Shkrimtarët në këtë fazë i kuptojnë temat dhe mund të shkruajnë për një temë në tërë tregimin e tyre. Ata kuptojnë si zhvillohen pjesë të tregimit, sidomos gjatë shkrimit të paragrafëve dhe si strukturohen paragrafët. Ata gjithashtu e redaktojnë punën e tyre, sidomos nëse përdorin kompjuter.

Komponentët e shkrimit

Si të kuptuarit që është më shumë se vetëm përsëritja fjalë për fjalë e informatave në tekst, ashtu edhe të shkruarit është më shumë sesa përshkrimi nga tabela. Shkathtësia e të shkruarit mund të ndahet në shkrim shprehës dhe shkrim të rrjedhshëm.

Shkrimi shprehës

Shkrimi shprehës është qëllimi kryesor i të nxënësve për të shkruar – aftësia për të planifikuar, organizuar, shkruar, rishikuar dhe redaktuar tekstin për të përcjellë mendime, ide dhe informata. Shkrimi i mirë shprehës kërkon që shkrimtari ta zgjedhë përmbajtjen dhe ta organizojë atë, t'i zgjedhë fjalët e përshtatshme dhe ta komunikojë qëndrimin dhe këndvështrimin. Prandaj, shkrimi i mirë shprehës kërkon të kuptuarit e qëllimit, zhanrit dhe audiencës:

- i) **Qëllimi:** Nxënësit duhet t'i kuptojnë qëllimet e ndryshme të shkrimit (p.sh. përshkrimi, tregimi, informimi dhe të bindurit/analiza), për çka përdoret secili zhanër dhe kur përdoret, si dhe teknikat që janë specifike për secilin zhanër.
- ii) **Zhanri:** Nxënësit duhet të mësojnë se ekzistojnë lloje të ndryshme të teksteve (zhanre) që përdoren për qëllime të ndryshme dhe karakteristikat e secilit prej tyre. Ata gjithashtu duhet të dinë si ta zgjedhin zhanrin që i përshtatet më së miri qëllimit të tyre.
- iii) **Audienca:** Nxënësit duhet të mësojnë si ta përshtasin stilin e tyre dhe zgjedhjen e fjalorit për t'iu përshtatur më së miri audiencës së tyre të synuar.

Tabela në vijim paraqet qëllimet kryesore të shkrimit, si dhe zhanret që më së shumti përdoren për secilin prej tyre

Qëllimet e Shkrimit dhe Zhanret Përkatëse

Qëllimi	Shpjegimi	Shembuj të Zhanrit
Përshkrim	Të përshkruash diçka, si një person, vend, proces apo përvojë në detaje të qarta	<ul style="list-style-type: none"> • përshkrime (p.sh. njerëz, vende apo ngjarje) • skica të personazheve • shkrimi i natyrës • broshura (personale, udhëtime, etj.)
Tregim	Të tregosh një tregim për një përvojë, ngjarje apo radhë të ngjarjeve duke ruajtur interesimin e lexuesit	<ul style="list-style-type: none"> • ditarë (të vërtetë apo të imagjinuar) • legjenda, përralla, fabula • tregime të shkurtra • poezi • dëshmi okulare

Qëllimi	Shpjegimi	Shembuj të Zhanrit
Informim	Të kontrollosh informatat e mësuara më parë apo të sigurosh informata të reja	<ul style="list-style-type: none"> • përmbledhje e informatave të reja apo të mësuara më parë • udhëzime apo drejtim • letra • artikuj gazetash • raporte shkencore
Të bindurit/ analiza	Të japësh mendim gjatë përpjekjes për ta bindur lexuesin apo për ta bindur të ndërmarrë një veprim të caktuar; të analizosh ide, p.sh. duke marrë parasysh vërtetësinë e tyre apo duke i krahasuar	<ul style="list-style-type: none"> • ese bindëse • editoriale • ese krahasues dhe kundërshtues • rishikime (p.sh. të librave dhe filmave) • analiza letrare

Shkrimi i rrjedhshëm

Shkrimi i rrjedhshëm është zotërimi i rregullave të shkrimit - shkathtësia fizike e dorëshkrimit, plus gramatika dhe pikësimi:

- i) **Drejtskrimi** është njohja se si formohen shkronjat saktë.
- ii) **Drejtskrimi** është njohuria e formimit të saktë të shkronjave.
- iii) **Gramatika dhe Pikësimi** janë njohuritë e strukturës dhe renditjes së fjalëve për të krijuar fjali kuptimplote.

Fëmijët kanë nevojë për kohë dhe kujdes të mjaftueshëm në zhvillimin e këtyre shkathtësive deri sa ato të bëhen në mënyrë automatike.

Nëse nxënësit mund të shkruajnë rrjedhshëm, ata mund të përqendrohen në atë që janë duke shkruar, në vend të mënyrës se si janë duke shkruar. Por fëmijëve nuk duhet t'u mësohet rrjedhshmëria para se të fillojnë të provojnë të shprehin.

Gjatë mësimit të shkrimit, shprehja duhet të jetë gjithnjë prioriteti i parë dhe praktikimi i rrjedhshmërisë duhet të bëhet në këtë kontekst.



Teknologjia po e ndryshon mënyrën si shkruajmë

Teknologjia po e ndryshon në mënyrë radikale procesin e të shkruarit dhe mënyrën se si duhet të mësohet shkrimi. Edhe në rastet kur u shkruajmë anëtarëve të afërt të familjes, shumica e njerëzve dërgojnë SMS apo email në vend që të dërgojnë letra. Edhe shkrimtarët po përdorin gjithnjë e më shumë kontrollues automatikë të drejtshkrimit dhe gramatikës. Kjo nënkupton se rëndësia e disa komponentëve të rrjedhshmërisë – sidomos dorëshkrimi i mirë – kanë në mënyrë të dukshme, përderisa nxënësit duket të dinë gjithnjë e më shumë si të shtypin, si të përdorin procesorë të tekstit, internetin për të kërkuar informata, si të përpilojnë informata dhe t'i kuptojnë rregullat e shkrimit të mediave elektronike.



Mësimdhënia e të shkruarit

Duhet kohë për tu bërë shkrimtar efektiv. Koha që rekomandohet të kalohet duke shkruar që nga klasa e parë është një orë në ditë, e ndarë barabar në mes të mësimdhënies dhe të nxënies. Megjithatë, nuk duhet të kalohet e gjithë kjo kohë në mësimdhënie të drejtpërdrejtë të shkrimit. Një pjesë mund të jetë përmes mësimdhënies së përmbylljes e cila përfshin shkrim – për shembull, shkrimi i fakteve interesante apo përmbledhja e një hulumtimi mbi një temë.

Dy yje dhe një dëshirë

Kur mësimdhënësit dhe nxënësit japin informata kthyesë, duhet të kenë parasysh të japin dy "yje" - dy gjëra pozitive - që pasohen nga një "dëshirë" - një sugjerim për zhvillim të mëtejshëm.

Që nga klasat e ulëta, shkathhtësitë themelore të shkrimit duhet të mësohen në kontekst i cili i inkurajon nxënësit t'i shprehin mendimet e tyre përmes shkrimit dhe të shkruajnë për kënaqësi. Kjo nënkupton se nxitja e motivimit të nxënësve është jashtëzakonisht e rëndësishme. Sapo nxënësit të mësojnë disa mekanizma themelore të shkrimit dhe të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet e tyre përmes shkrimit, atyre duhet tu prezantohet ideja se shkrimi i mirë përfshin një proces të planifikimit, rishikimit dhe përpilimit të disa versioneve të pjesëve të rëndësishme të punës. Vëmendje duhet t'i jepet edhe mësimdhënies së aspekteve të përshtatshme të rrjedhshmërisë.

Zhvillimi i Motivimit

Mësimdhënësit mund të marrin pjesë si shkrimtarë së bashku me nxënësit e tyre. Ata mund t'i inkurajojnë nxënësit të bashkëpunojnë në aktivitete shkrimi dhe të japin e të pranojnë informata kthyesë; si dhe të gjejnë mënyra ta publikojnë punën e nxënësve.

Merrni pjesë në komunitet. Mësimdhënësit mund të bashkëpunojnë me nxënësit në një projekt të përbashkët shkrimi, si shkrimi i revistave të klasës; ata mund të ofrojnë edhe shembullin e tyre për detyrat e shkrimit.

Jepuni nxënësve zgjedhje shkrimi. Ofrimi i mundësisë për t'i zgjedhur temat për shkrim, apo për t'i modifikuar idetë e zgjedhura nga mësimdhënësi, do ta rrisë ndjenjën e pronësisë të nxënësit. Inkurajoni të mbajnë shënime për temat e mundshme të shkrimit.

Inkurajoni nxënësit të bashkëpunojnë si shkrimtarë. Nxënësit mund të bashkëpunojnë përmes dhënies së ideve, përgjigjes ndaj versioneve në grup, apo redaktimit ose rishikimit të punës së tyre së bashku. Ata gjithashtu mund ta hartojnë një tekst së bashku. Për shembull, nxënësit e vegjël mund të shkruajnë me radhë duke përdorur një laps për ta përpiluar një porosi. Nxënësit më të mëdhenj mund të bashkëpunojnë për revistën e klasës apo në shkëmbimin e tregimeve me shokët dhe shoqet e klasës. Një shembull i një aktiviteti bashkëpunues që ndihmon në ndërtimin e komunitetit të shkrimtarëve është "Ylli i ditës".

Sigurooni mundësi për të dhënë dhe pranuar informata kthyesë. Nxënësit përfitojnë nga pranimi i informatave kthyesë. Ata gjithashtu mund të jenë në gjendje t'i vërejnë më mirë problemet në shkrimet e të tjerëve se sa në të vetat, kështu që komentimi i punës së moshatarëve mund tu ndihmojë t'i vlerësojnë edhe shkrimet e veta. Mësimdhënësit duhet ta modelojnë dhënien e informatave kthyesë, kujdes – nëse fokusoheni vetëm në gabimet drejtshkrimore, nxënësit do ta bëjnë të njëjtën në vlerësimin e moshatarëve. Ata mund ta bëjnë këtë duke përpiluar rubrika të bazuara në kriteret e suksesit (shih pjesën për vlerësimin ku është dhënë një shembull). Mësimdhënësit duhet ta modelojnë mënyrën e përshtatshme të dhënies së informatave kthyesë verbale, si "dy yje dhe një dëshirë". Për shembull "Karrigia e autorit" mund të përdoret si model për dhënien e "komenteve të mira" dhe deklaratave pozitive.

Publikoni shkrimet e nxënësve. Publikimi i punës së nxënësve e vlerëson shkrimin dhe ndihmon motivimin e shkrimtarëve. Mënyra më e thjeshtë e publikimit është "Muri i Famës" në klasë për shkrimet më të mira të nxënësve. Shkrimet mund të ekspozohen edhe në korridore, dhe

Aktiviteti "Ylli i ditës"

Në aktivitetin "Ylli i ditës", secili nxënës feston në ditën e vet. Ylli i ditës, i ulur në krye të klasës, u përgjigjet pyetjeve intervistuese të shokëve/shoqeve të vet/a. Pas intervistës, secili nxënës përpilon një fjali në lidhje me Yllin e ditës. Këto fjali kombinohen në paragrafin e klasës, i cili pastaj vendoset në tabelën e njoftimeve të klasës, siç është demonstruar nga ky shembull i klasës së parë:

Jehona është Ylli i ditës. Asaj i pëlqen ngjyra e kaltër. Ajo ka dëshirë të hajë akullore. Kafsha e saj e dashur është tigr. Jehona jeton në Lagjen e Spitalit. Sot është ditëlindja e saj!

Karrigia e autorit

Gjatë aktivitetit "Karrigia e autorit", një nxënës, i ulur në një karrige të veçantë, lexon punimin e vet para moshatarëve përderisa ata janë të ulur në dysheme. Pastaj, mësimdhënësi modelon dhe lehtëson dhënien e komenteve të mira, si këto në vijim:

- Më pëlqeu shumë ...
- Për mua, fjalia e dalluar në tekstin tënd është ... sepse ...
- Me të vërtetë mund ta paramendoja ... sepse...

nxënësit mund të marrin pjesë në “Shëtitjen Galeri.” Nxënësit mund të krijojnë edhe librat e tyre, duke përfshirë një faqe “Për autorin”; këto mund të jenë në dispozicion në bibliotekën e shkollës apo të klasës. Mësimdhënësit, duke marrë masa të përshtatshme mbrojtëse dhe leje të veçanta, mund të krijojnë blogje të klasës që nxënësit t’i postojnë punimet e tyre online apo t’i inkurajojnë t’i dorëzojnë punimet e tyre në faqe online të cilat publikojnë shkrime të nxënësve, siç është www.libroteka.org. Mësimdhënësit duhet t’i shfrytëzojnë këto mundësi për t’i motivuar të gjithë nxënësit, dhe të kujdesen që të mos i përdorin për vlerësimin e vetëm disa nxënësve.

Mësimdhënia e procesit të shkrimit

Qasjet për mësimdhënien e procesit të shkrimit dallojnë, por shumica përshkruajnë:

- fazën fillestare të para-shkrimit, gjatë të cilës shkrimtari i zhvillon idetë dhe e planifikon përmbajtjen;
- fazën e kompozimit, në të cilën shkruhet një version dhe ndahet me të tjerët;
- fazën e rishikimit, në të cilën versioni vlerësohet dhe bëhen përmirësime në përmbajtje, si qartësimi i ideve apo shtjellimi i detajeve të rëndësishme; dhe
- faza redaktuese, e cila përfshin përmirësimin e gabimeve si drejtshkrimi dhe pikësimi.

Nxënësve duhet t’u mësohen secila prej këtyre qasjeve dhe strategjitë e përshtatshme për to. Strategjitë e të shkruarit duhet të mësohen në mënyrë eksplicite dhe të drejtpërdrejtë përmes procesit të ndarë në faza, ku përgjegjësia transferohet gradualisht nga mësimdhënësi te nxënësi:

Familjarizimi	Mësimdhënësi ofron shembuj të një zhanri
↓	
Zgjidhja e problemit	Mësimdhënësi parashtron pyetjet dhe e diskuton tekstin
↓	
Shkrimi i modeluar	Mësimdhënësi shkruan shembuj për nxënësit
↓	
Shkrimi i përbashkët	Mësimdhënësi shkruan shembuj së bashku me nxënësit
↓	
Shkrimi i udhëzuar	Mësimdhënësi i udhëzon nxënësit për të përpiluar shkrime të tyre
↓	
Shkrimi i pavarur	Nxënësit shkruajnë vetë dhe e vetëvlerësojnë apo vlerësojnë punën e moshatarëve të tyre

Mësimdhënia e kompozimit

Nëse nga nxënësit pritet të kompozojnë në një zhanër të caktuar, ata kanë nevojë për udhëzime si ta bëjnë këtë. Udhëzimet në vijim mund të përdoren për përpilimin e orëve mësimore:

Përshkrim - Detajet e ndjenjave

Përdor pesë ndjenjat e tyre, sipas rastit:

- Çka patë? Si *dukej*?
- Çfarë tingulli *dëgjuat*?
- Çka *prekët*? Çfarë *ndjetë*?
- Çfarë *arome* ndjetë?
- Çfarë *shije* ndjetë?

Të bindurit / analiza

Para se të shkruani:

- Ndaloje gjykimin.
- Ano në një rën anë.
- Identifiko dhe organizo idetë tua.

Përderisa shkruani:

- Trego çka beson. (Fjalë e temës.)
- Ofro tri ose më shumë arsye.
- Përfundo me një konkluzion të fortë.

Pasi të përfundoni: kontrolloni për t'u siguruar se keni:

- Zhvilluar argumentin tuaj.
- Shtuar ide për ta përkrahur argumentin tuaj.
- Kundërshtuar argumentet e anës tjetër.
- Përfunduar me një konkluzion të fortë.

Mësimdhënia e rrjedhshmërisë

Dorëshkrimi dhe ndërtimi i fjalisë janë **shkathtësitë themelore të shkrimit** të cilat nxënësit duhet t'i kenë. Nxënësit gjithashtu kanë nevojë për shkathtësi të daktilografisë dhe procesimit në Word kur kompozojnë në mënyrë elektronike.

Udhëzimet e shkrimit të hershëm duhet të fillojnë me faktin se si duhet të mbahet lapsi në mënyrë të rehatshme në mes të gishtit të madh dhe gishtit tregues, duke u mbështetur në gishtin e mesëm. Edhe pse shumë nxënës do ta përvetësojnë me kohë, mbajtja e rehatshme e lapsit është e domosdoshme për t'iu shmangur lodhjes. Mësimdhënësit duhet gjithashtu t'u tregojnë shkrimtarëve të vegjël mënyrën më efektive dhe më të qartë për të formuar shkronjat, pa marrë parasysh nëse janë të shtypit apo të dorës. Nxënësit duhet ta praktikojnë shkrimin e shkronjave nga kujtesa.


Pasi që dorëshkrimi është shkathtësi motorike, më së miri është të praktikohet në aktivitete të shpeshta e të shkurtra. Nxënësit duhet ta ushtrojnë shkrimin e një shkronjë të caktuar vetëm pesë deri tetë herë para se të kalojnë në një aktivitet tjetër.

Shkrimi i izoluar i shkronjave nuk është i mjaftueshëm; nxënësit duhet t'i zbatojnë shkathtësitë e dorëshkrimit në fjali dhe në aktivitete të mirëfillta të shkrimit.

Duke filluar në nivelin parashkollor / klasë të parë, nxënësit duhet ta zhvillojnë të kuptuarit se çka janë fjalitë dhe duhet të mësojnë parimet themelore të shkronjave të mëdha dhe pikësimit. Mësimdhënësit mund t'i shfrytëzojnë shkathtësitë e gjuhës së folur të nxënësve për t'i përkrahur shkathtësitë e gjuhës së shkruar. Përderisa nxënësit i japin idetë me gojë, mësimdhënësi mund t'i shkruajë këto ide duke i shpjeguar fjalitë dhe duke demonstruar si shkruhen.


Në klasën I dhe II, mësimdhënësi modelon si të identifikohen idetë që vinë dhe si të ndahen në fjali më të shkurtra. Pastaj nxënësit mund ta praktikojnë shkrimin e pavarur të ideve të tyre në fjali të plota.

Përdor tiketat e fjalëve dhe një tabelë me xhepa për t'iu mundësuar nxënësve të fokusohen në përpilimin e fjalive pa pasur nevojë të brengosen për shkathtësitë tjera si drejtshkrimi dhe dorëshkrimi.



Teli për tharje është gjithashtu ideal për krijimin e fjalive.

Krijoni një fjali të përzier dhe kërkoni nga nxënësit t'i vendosin fjalët në radhën e duhur.



Pasi ta kuptojnë nxënësit konceptin e fjalisë, ata kanë nevojë të mësojnë si t'i zbatojnë rregullat për shkrimin e fjalive, duke përfshirë pikësimin dhe shkronjat e mëdha. Mësimdhënësit duhet t'ua mësojnë këto rregulla në mënyrë eksplicite, duke i përfshirë udhëzimet sa më shumë që është e mundur në kompozimet e nxënësve të tyre. Udhëzimet e gramatikës të bazuara në fletë pune apo në përshkrim mund të mos lidhen me të shkruarit e vërtetë. Nxënësit mund të jenë në gjendje t'i qarkojnë pjesët e fjalisë apo t'i identifikojnë dhe korrigjojnë gabimet në pikësim, por mund të mos i përdorin këto shkathtësi në punimet e tyre. Mësimdhënësit duhet të kërkojnë nga nxënësit t'i praktikojnë këto shkathtësi përderisa shkruajnë versione, rishikojnë dhe redaktojnë punën e tyre.

Aktiviteti në vijim është aktivitet verbal që u ndihmon nxënësve të shprehën me anë të fjalive. Tregojuni nxënësve se do ta krijoni një tregim së bashku. Filloni duke thënë një fjali, p.sh. "Arta ka një këlysh që quhet Kiki". Kërkoni nga nxënësit të vazhdojnë duke shtuar secili nga një fjali, deri sa të gjithë nxënësit të kenë kontribuar me nga një fjali apo deri sa të përfundojë tregimi. Kjo mund të bëhet edhe si aktivitet shkrimi ku nxënësit në grupe prej 5-6 vetash krijojnë një tregim duke shkruar në të njëjtën fletë njëri pas tjetrit.



Junior
Chefin
•tom tailor•

VESA

100
100
100

PJESA 5: VLERËSIMI I LEXIMIT

Në shkollat e Kosovës, vlerësimi zakonisht nënkupton “notim të punës së nxënësve”. Shumica e mësimitdhënësve mendojnë se notat janë thelbësore, pasi që kërcënimi se do të marrin notë të dobët i motivon nxënësit të punojnë. Ky quhet test sipas **normave**. Testi i arritshmërisë në klasën e 9 i MASHT-it është test tipik sipas normave. Secili nxënës merr një notë; disa kalojnë e disa ngelin. Në fakt, atyre u tregohet sa kanë arritur në krahasim me klasën; por fakti se nxënësi ka marrë notë kaluese nuk garanton se i ka arritur qëllimet e kurrikulës; dhe rezultati i testit nuk u ofron udhëzime në lidhje me mënyrat se si ta përmirësojnë performancën e tyre.

Në fakt, notimi nuk është domosdoshmërisht as motivues i mirë. Nxënësit të cilët nuk presin të marrin nota të mira mund të japin minimumin që mendojnë se është i nevojshëm për të kaluar – apo nëse mendojnë se nuk kanë gjasa për të kaluar, mund të heqin dorë plotësisht. Kështu që notat në fakt mund të jenë demotivuese për nxënësit. Po ashtu nxënësit të cilët kanë nota të mira mund të mendojnë se nuk kanë nevojë të përpiqen më shumë.

Prandaj vlerësimi sipas normave nuk e përkrah mësimitdhënien. Ka vend edhe për të – për shembull në testet përfundimtare – por nëse përdoret gjatë mësimitdhënies, mund të jetë dëmtes.

Prandaj, kjo pjesë fokusohet në llojet e ndryshme të vlerësimit, të cilat përkrahin mësimitdhënien dhe të nxënit.

Vlerësimi formativ dhe diagnostifikues i leximit

Vlerësimi që përkrah të nxëniet duhet të jetë i ndryshëm nga vlerësimi sipas normave në dy mënyra:

- E para dhe më e rëndësishmja, ai duhet të raportojë nëse nxënësit i kanë arritur qëllimet e kurrikulës. Ky lloj vlerësimi quhet i **bazuar në kritere**. Informata se kush është mbi standard është e dobishme vetëm për shkak se i mundëson mësimdhënësit t'i përgatisë detyrat në bazë të nivelit të nxënësit dhe e di se kush mund të lihet sigurt të punojë në mënyrë të pavarur ndërkohë që mësimdhënësi përqendrohet tek ata që kanë nevojë për ndihmën e tij. Kështu që vlerësimi i bazuar në kritere nuk përqendrohet në notim, por në **atë** që di apo që mund të bëjë nxënësi, e shprehur në qëllime apo rezultate specifike të kurrikulës.
- E dyta, ai duhet të ofrojë informata në atë formë që të mund të përdoren për të planifikuar apo modifikuar mësimdhënien dhe aktivitetet mësimore. Ky lloj vlerësimi quhet **vlerësim formativ**. Ai e bën këtë duke raportuar çka duhet të përmirësohet, apo cilët janë hapat e ardhshëm logjikë, duke marrë parasysh çka është arritur deri tani. Kështu që vlerësimi formativ përqendrohet në komente konstruktive dhe i shmanget notimit.

Vlerësimi për nxënie (VpN)

Ky lloj vlerësimi shpesh herë quhet vlerësimi **për** nxënie, për ta dalluar nga testet tradicionale, apo nga vlerësimi **i** nxënies.

Basic Education Program i USAID-it ka hartuar një *Udhëzues për vlerësimin formativ*, i cili mund të shkarkohet nga www.bep-ks.org. Ai gjithashtu u është shpërndarë mësimdhënësve përmes një programi trajnimit.

Hapi i parë dhe më i rëndësishëm në vlerësimin e leximit është të kuptohet se leximi duhet të mësohet, e nuk merret thjesht në mënyrë spontane. Kjo nënkupton se mësimdhënësit duhet ta monitorojnë përparimin e nxënësve, të identifikojnë nevojat specifike të të nxëniet dhe të planifikojnë në bazë të tyre. "Vlerësimi" i përdorur në këtë mënyrë nuk është "testim" apo "notim", por "skanim" apo "diagnostifikim".



Planifikimi i vlerësimit

Planifikimi i vlerësimit është proces prej katër fazash:

- Zgjidh një qëllim të të nxëniet për ta vlerësuar;
- Gjej dhe rishiko modele të shembujve të punës: nëse nuk ke të tilla, përpilo modelet tua;
- Përpilo kriteret e suksesit: cilët janë faktorët që i bëjnë pjesët e detyrave që i keni zgjedhur të jenë shembull?
- Mendo si të vlerësosh: si do ta njoh punën shembullore kur ta shoh?

Mbani mend:

Nuk keni nevojë të vlerësoni çdo gjë që u keni mësuar, vetëm atë që po ua mësoni tani.

Përfshirja e nxënësve në vlerësim

Në VpN, planifikimi i të nxënësve individual është thelbësor. Ky planifikim duhet të bazohet gjithnjë në kriteret e suksesit. Kjo nënkupton se është shumë me rëndësi jo vetëm t'i ndani kriteret e suksesit me nxënësit para se të fillojnë të punojnë, por edhe të kenë vazhdimisht qasje në to, t'i përdorin kur janë duke punuar në mënyrë të pavarur. Në fakt, kur nxënësit ndihen rehat me kriteret e suksesit, është mirë të përfshihen edhe ata në përpilimin e tyre. Kjo do t'i ndihmojë ata jo vetëm ta vlerësojnë rëndësinë e kriterëve të suksesit, por edhe t'i përvetësojnë si pjesë e vetëvlerësimit të tyre.

Vetëvlerësimi i nxënësve është pjesë thelbësore e VpN-së. Në vend që të presin testin përfundimtar, nxënësit duhet ta vlerësojnë përparimin e tyre kurdo që mendojnë se është e dobishme dhe t'i përdorin rezultatet për të vendosur çfarë të bëjnë në vijim.

Inkurajo vetë-vlerësimin dhe vlerësimin e moshatarëve kurdo që të paraqitet rasti. Duhet ta inkurajoni vlerësimin e moshatarëve gjatë punës në grup dhe të siguroni mundësi për nxënësit t'iu tregojnë të tjerëve për vlerësimin që e kanë marrë, si dhe çka planifikojnë të bëjnë në lidhje me të. Kur ju e kontrolloni punën e nxënësve, mund ta inkurajoni vetë-reflektimin duke kërkuar të ju tregojnë çka mendojnë se është e mirë në punën e tyre dhe çka ka nevojë për përmirësim. Kjo demonstron të kuptuarit e nxënësve për objektivat dhe ju mundëson juve të kaloni nëpër punën e tyre më lehtë.

Kriteret e suksesit - përmbledhja e tregimit

Rezultati i të nxënësve mund të jetë hartimi i një përmbledhjeje të mirë të tregimit.

Kriteret e suksesit mund të jenë:

- I kam përfshirë gjërat e rëndësishme nga fillimi, mesi dhe fundi i tregimit.
- I kam vënë në radhën e duhur
- Kam dhënë një përshkrim të shkurtër për personazhet kryesore
- Kam përshkruar se ku ndodh ngjarja
- E kam përfshirë idenë kryesore apo mësimin/porosinë e tregimit

Listat kontrolluese të vetëvlerësimit

Vetëvlerësimi i nxënësve mund të jetë jashtëzakonisht i dobishëm në planifikimin e mësimdhënies. Për shembull, nëse jeni duke planifikuar t'u mësoni disa fjalë nga fjalori, mund të merrni informata shumë të dobishme në lidhje me fjalët të cilat nxënësit tashmë i dinë dhe sa i dinë, duke kërkuar që t'i klasifikojnë fjalët e synuara në listën kontrolluese të vetëvlerësimit ("Sa e njoh këtë fjalë?") si në shembullin në vijim. Lexoni disa fjalë dhe kërkonin nga nxënësit ta vendosin secilën fjalë në kolonat e tabelës.

Sa e njoh këtë fjalë?			
E di çka do të thotë kjo fjalë dhe mund ta përdor në fjali.	Deri diku e di çka do të thotë kjo fjalë.	E kam dëgjuar këtë fjalë.	Nuk e kam dëgjuar këtë fjalë.
<i>Mace</i>	<i>Qeveri</i>	<i>Përkim</i>	<i>Antropolog</i>

Një mjet i tillë u ndihmon mësimeve të kuptojnë cilat fjalë nxënësit mendojnë se i njohin dhe sa mendojnë se i njohin ato. Kjo informatë mund të përdoret pastaj për të planifikuar mësimin e fjalorit.

Mjetet e vlerësimit formativ

Rubrikat e vlerësimit

Një mjet i dobishëm për VpN-në është rubrika e vlerësimit. Rubrika është udhëzues për renditjen e performancës së nxënësve. Ajo përmban disa kritere apo standarde të lidhura drejtpërdrejt me rezultatet e të nxënësve. Rubrika specifikon se si duket performanca në secilën nga këto kritere të ndryshme në nivele të ndryshme (p.sh. klasat I deri V). Rubrikat mund të përfshijnë shembuj të detyrave apo performancës që janë tipike për secilin nivel. Një shembull i rubrikës për vlerësim është dhënë në vijim:

Shembull: Rubrikat për vlerësimin e dëgjimit

Detyra	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Vëmendja	Ka filluar të dëgjojë me vëmendje më të qëndrueshme (p.sh. një tregim të shkurtër apo temë të interesit personal)	Është në gjendje të dëgjojë për periudha më të gjata kohore temat e interesit personal	Është në gjendje të dëgjojë për periudha më të gjata kohore temat e interesit personal, dhe ka filluar të dëgjojë temat tjera
Dëgjimi i të tjerëve	Ka filluar t'i dëgjojë të tjerët (p.sh. nxënës tjetër si dhe mësuesen)	Është në gjendje t'i dëgjojë të tjerët (por ende i përqendruar në mendimet dhe idetë e veta, andaj mund të ndërpresë apo të mos jetë në gjendje të përgjigjet)	Është në gjendje t'i dëgjojë të tjerët, dhe zakonisht përgjigjet në mënyrë të duhur (ende mund të ndërpresë)
Identifikimi i pikave kryesore	Ka filluar t'i identifikojë pikat e interesit pas dëgjimit të temës së interesit personal	Është në gjendje të identifikojë pikat e interesit pas dëgjimit të temës së interesit personal	Është në gjendje të identifikojë pikat e interesit pas dëgjimit të temës së interesit personal, dhe ka filluar t'i përmbledhë pikat kryesore nga temat tjera
Përcjellja e udhëzimeve	Është në gjendje të dëgjojë dhe të përcjellë udhëzime të thjeshta	Është në gjendje të dëgjojë dhe të përcjellë udhëzime të thjeshta, ka filluar të kërkojë ndihmë apo qartësim nëse paraqitet nevoja	Është në gjendje të përcjellë seri të shkurtra të udhëzimeve të thjeshta

Vëzhgimet e strukturuar

Shumica e vlerësimit formativ bëhet në mënyrë joformale, duke i vëzhguar dhe duke i dëgjuar nxënësit. Për shembull, gjatë seancave të **dëgjimeve me zë**, mësimitdhënësit mund të mbledhin dhe të përdorin informata të vlerësimit formativ. Nxënësit apo mësimitdhënësit lexojnë me zë, duke u ndalur kohë pas kohe për të shpjeguar çka po mendojnë. Mësimitdhënësit mund të zgjedhin cilët nxënës do të përgjigjen dhe çka do të kërkojnë prej tyre, varësisht nga informatat që u duhen. Pastaj, kur mësimitdhënësit lexojnë me zë, ata mund të modelojnë strategji të caktuara të leximit për të cilat mendojnë se nxënësit kanë nevojë për ndihmë.

Ky lloj ndërveprimi është bazë ideale për **vëzhgime të strukturuar** - duke mbajtur një listë kontrolluese, duke vëzhguar secilin nxënës për një periudhë kohore, duke monitoruar përparimin e tyre dhe duke identifikuar nevojat për përkrahje.

Kur vlerësoni në mënyrë formative, nuk do të thotë domosdoshmërisht që dëshironi ta vlerësoni produktin final, sepse fëmijët kanë nevojë t'i zhvillojnë shkathtësitë që do t'i ndihmojnë të japin produktin final. Kështu, nëse produktet finale në dëgjim janë:

- Dëgjimi i të tjerëve në klasë, parashtrimi i pyetjeve relevante dhe përcjellja e udhëzimeve,
- Dëgjimi kur flet një i rritur, mbajtja në mend e pikave specifike dhe identifikimi i asaj që kanë mësuar,
- Përgjigje për tregimin duke përshkruar personazhet, duke përsëritur disa pika kryesore dhe duke komentuar në mënyrë konstruktive,

Atëherë lista kontrolluese për vëzhgimet në klasë mund të përfshijë pika si:

- mban vëmendjen për kohë të mjaftueshme
- mban mend pikat specifike që i interesojnë
- i dallon pikat me rëndësi dhe ato me më pak rëndësi
- përshkruan çka kupton në lidhje me personazhin
- bën komente relevante
- dëgjon reagimet e të tjerëve
- parashtron pyetje për ta qartësuar atë që ka kuptuar
- identifikon dhe u përgjigjet modeleve të tingujve në gjuhë [për shembull, aliteracioni, rima, loja me fjalë].

Mësimitdhënësit shpesh herë mendojnë se VpN nënkupton që të kontrollojnë dhe notojnë shpesh punën e nxënësve. Por shkrimi i komenteve formative individuale merr shumë kohë. VpN nuk ka të bëjë me punën "perfekte" por synon të nxjerrë në pah nëse nxënësit i kanë përvetësuar pikat mësimore nga mësimet paraprake. Sekret i vlerësimit formativ efikas është të mendohet për klasën si një tërësi.

Ide për menaxhimin e vëzhgimeve të klasës

- **Dijeni saktësisht çka po shihni dhe çka po kërkonti.** Mos u mundoni të vlerësoni çdo gjë çdo ditë.
- **Mos jepni nota.** Bëhuni shumë specifik në lidhje me atë që vlerësoni: për shembull, ndajeni rrjedhshmërinë dhe të shprehurit në vlerësimin e shkrimit dhe shikojini aspektet specifike të rrjedhshmërisë si gramatika dhe pikësimi.
- **Jepni komente specifike** në lidhje me pikat e forta dhe të dobëta. Mundohuni të jepni dy lëvdata para se të thoni se ku ka nevojë për më shumë punë (“dy yje dhe një dëshirë”).
- **Skroni.** Mos e lexoni punën e nxënësve gjerësisht. Përqendrohuni në pikat e mësimin. Kur përfundon një pjesë, mbase dëshironi ta lexoni me kujdes për vlerësim sumativ. Por tash për tash, jeni duke u kujdesur për përvetësimin e objektivave specifike.
- **Mos shkruani komente në letra individuale.** Kjo merr shumë kohë. Merrni një letër ngjithëse. Shkruani qëllimin kryesor të mësimin në të. Përderisa skroni, shënoni emrat e disa nxënësve të cilët e kanë përvetësuar qëllimin kryesor të mësimin. Gjithashtu, shënoni emrat e nxënësve të cilët kanë nevojë për më shumë punë. Më vonë, mbliidhni ata që kanë nevojë për më shumë punë në një grup të vogël, ose bashkujini me “mentorë” të përkohshëm nga lista juaj e nxënësve të cilët i kanë përvetësuar qëllimet e mësimin.
- **Kërkonti shembuj të mirë** përderisa kaloni nëpër klasë, për t’ia treguar tërë klasës – shembulli mund të jetë vetëm një apo dy fjali.
- **Kërkonti modele në punën e nxënësve.** Ato mund të bëhen bazë për mini-mësime të ardhshme.

Raportimi përshkrues

Mësimdhënësit duhet të gjejnë hapësirë në punën e tyre për t’u dhënë nxënësve informata kthyese në formë të komenteve të bazuara në performancën e tyre krahasuar me rezultatet e të nxënësve dhe kriteret e suksesit. Informatat kthyese i ndihmojnë nxënësve t’i dinë pikat e tyre të forta dhe të përcaktojnë cilët janë hapat e tyre të ardhshëm.

Kështu, përderisa mësueset dhe nxënësve duhet të japin lëvdata, në parimin “dy yje dhe një dëshirë”, informata kthyese nuk duhet të jetë, për shembull, se kjo është një punë e mirë. Ajo duhet të jetë mjaft eksplicite në lidhje me lëvdatën dhe lëvdata duhet të jetë për diçka që është e lidhur drejtpërdrejtë me pikën e fortë të punës. Ajo duhet të ndërlihdë gjithashtu edhe kriteret e suksesit. Kështu, nëse për shembull, ylli i referohet faktit që nxënësve kanë përdorur gjuhë të gjallë, atëherë komenti duhet të gjejë dëshmi në shkrim se çka është gjuha e gjallë, në mënyrë që nxënësve të jetë i vetëdijshëm për atë pikë të fortë.

Ngjashëm, kur i jepet nxënësve një dëshirë, diçka që ai mund ta përmirësojë me kohë, informata kthyese duhet të jetë specifike dhe e lidhur me kriteret e suksesit për detyrën e dhënë. Kështu, për shembull, nëse dëshira është që nxënësve të përdorë më shumë gjuhë përshkruese, informata kthyese duhet ta specifikojë këtë duke i dhënë një apo më shumë shembuj specifikë se si mund të përmirësohet teksti duke përdorur më shumë gjuhë përshkruese.

Mbajtja e regjistrave të nxënësve

Monitoroni përparimin e secilit nxënës përmes vëzhgimeve të rregullta gjatë bisedave dhe udhëzimeve. Pyeteni veten, a mund t'i ritregojnë ngjarjet kryesore të tregimit? A janë të përshatshme parashikimet e tyre? A janë në gjendje t'i identifikojnë dhe të përshkruajnë saktë ngjarjet nga teksti? Mbani një regjistër të vazhdueshëm të përfundimeve tuaja.

Përdorimi i vlerësimit formativ për ta kontrolluar shkrimin e nxënësve

Mos u mendo ta shikosh tërë punën e nxënësve çdo ditë. Kontrolllo vetëm katër apo pesë detyra në ditë, pastaj mbaj biseda grupore apo individuale me ata nxënës gjatë kohës individuale për shkrim.

Planifikoji orët duke pasur parasysh pikat në vijim:

- Kurdo që është e mundur, nëvizoji disa fjali të mira të nxënësve me vështirësi. Bëj çka të mundesh për t'i bërë të ndihen krenarë për arritjet e tyre.
- Jepu nxënësve detyra specifike gjatë kohës për shkrim individual – për shembull, të punojnë me partnerët e tyre për ta përshkruar vendngjarjen në mes dhe në fund të pjesës së tyre.
- Gjatë kohës për shkrim individual, puno me nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë individuale apo detyra specifike si pikësimi, paragrafët apo shkronjat e mëdha.

Testimi diagnostifikues

Shumica e vlerësimit të leximit të fëmijëve në klasë është joformal. Për shembull, një mësues mund të kërkojë nga nxënësi ta përmbledhë apo ri-tregojë atë që ka lexuar, apo të vëzhgojë kontributet e nxënësve të ndryshëm gjatë diskutimit të një teksti. Ai do ta gjykojë atë që kanë mësuar nxënësit dhe ku kanë nevojë për përmirësim. Por, përveç këtij vlerësimi joformal, mësuesit mund të përdorin edhe teste me nxënës individualë apo grupe të vogla, për të vlerësuar komponentët e ndryshëm të leximit, aty ku ka dyshime nëse kanë nivel të pranueshëm për atë komponent. Për shembull, një mësuese mund të ketë dëshirë të vlerësojë shkathtësitë fonetike të një nxënësi, rrjedhshmërinë e tij orale, apo fjalorin e fjalëve fotografike. Shembuj të testeve të cilat mund të përdoren për diagnostifikim në këtë mënyrë mund të gjenden në ueb faqen e BEP-it www.bep-ks.org

Në VpN, qëllimi i testimit nuk është të renditen nxënësit por të identifikohet çka dinë apo mund të bëjnë nxënësit dhe të përcaktohet ku të nisë mësuesit. Nëse e përdorni këtë test, ai duhet të lidhet me kriteret e suksesit dhe të sugjerojë veprime të mundshme. Kjo nënkupton se nuk duhet vetëm të japë një rezultat, por të jetë tregues nëse rezultati është i mirë për nivelin e nxënësit, apo ka nevojë për përmirësim. Gjithashtu ai duhet të ketë lidhje të mira me llojet e aktiviteteve të cilat mund të ndihmojnë për përmirësimin e rezultateve të dobëta në test.

Për shembull, kur filloni mësimin në klasë, mund të dëshironi të dini në çfarë niveli janë nxënësit në dimensionet kryesore të leximit. Ky mund të jetë moment i mirë për përdorimin e testit

diagnostifikues siç është Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta (EGRA), apo ndonjë mjet tjetër të ngjashëm. EGRA (shih në vijim) është një shembull i testit të bazuar në kritere të caktuara, i cili mund të përdoret për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta individuale. Testi realizohet me tërë klasën në fillim të vitit shkollor dhe rezultatet mund të shfrytëzohen si bazë për ta planifikuar mësimdhënien. EGRA ka norma – nivele për nën-testet relevante të cilat duhet të arrihen gjatë fazave kryesore të caktuara (p.sh. fundi i klasës I, mesi i klasës II dhe fundi i klasës II); si dhe ka edhe udhëzime të cilat japin shembuj të aktiviteteve për përmirësim.

Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta (EGRA)

Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta (EGRA) është test i leximit për klasat I-III. Ai është përpiluar fillimisht në SHBA dhe është përshtatur në gjuhën shqipe nga Basic Education Program (BEP) si A-EGRA. Ai mund të përdoret nga Ministritë për mbajtjen e hulumtimeve për leximin në klasat e ulëta. Ai mund të përdoret gjithashtu nga shkolla dhe mësimdhënës individualë për vlerësimin e të gjitha paraleleve (skanim) apo nxënësve individualë (diagnostifikim) si bazë për planifikimin e mësimdhënies.



A-EGRA ka shtatë nën-teste, si në vijim:

- a) **Vetëdija tingullore:** Ky nën-test përmban 10 elemente (fjalë). Nxënësi duhet ta ndajë secilën fjalë në tinguj. Ky nën-test nuk matet me kohë; rezultati i nxënësit do të jetë numri i elementeve që marrin përgjigje të saktë (d.m.th. numri i përpjekjeve, minus numri i gabimeve).
- b) **Emri i shkronjës / njohja e tingujve:** Ky nën-test përmban njëqind shkronja të zgjedhura rastësisht (edhe shkronja të mëdha, edhe të vogla). Nxënësi duhet t'i lexojë këto shkronja me zë. Ky nën-test matet me kohë; rezultati është numri i shkronjave të lexuara saktë për një minutë.

- c) Leximi i fjalëve të njohura:** Ky nën-test përmban 50 fjalë të zakonshme, të marra nga lista e fjalorit të fjalëve fotografike të BEP për klasën II. Nxënësi duhet t'i lexojë me zë. Ky nën-test matet me kohë; rezultati është numri i fjalëve të lexuara saktë për një minutë.
- d) Leximi i fjalëve pa kuptim:** Ky nën-test përbëhet nga pesëdhjetë "jo-fjalë" (të ndërtuara sipas rregullave të ortografisë së gjuhës shqipe) të cilat nxënësi duhet t'i lexojë. Ky nën-test matet me kohë; rezultati është numri i fjalëve të lexuara saktë për një minutë.
- e) Rrjedhshmëria në lexim (5a) dhe Lexim-kuptimi (5b):** Testi i rrjedhshmërisë përfshin leximin e 50-60 fjalëve nga nxënësi. Ky nën-test matet me kohë dhe rezultati do të jetë numri i fjalëve të lexuara saktë për një minutë. Pastaj nxënësi duhet t'u përgjigjet pyetjeve të kuptimit në lidhje me atë që sapo ka lexuar, duke mbuluar disa nivele, nga nxjerrja e informatave të drejtpërdrejta përmes formimit të interpretimit e deri te gjykimi në lidhje me tekstin duke përdorur njohuritë mbi botën. Rezultati i nxënësit do të jetë numri i përgjigjeve të sakta.
- f) Dëgjim-kuptimi:** Nxënësi dëgjon mbikëqyrësin duke e lexuar një tekst të shkurtër me zë; pastaj i përgjigjet pesë pyetjeve në lidhje me të duke mbuluar nivele të ngjashme me pyetjet e lexim-kuptimit, por më pak sfiduese. Rezultati i nxënësit do të jetë numri i përgjigjeve të sakta.
- g) Diktimi:** Mbikëqyrësi lexon një fjali të shkurtër, të cilën nxënësi e shkruan. Rezultati i shkrimit është saktësia e pesë fjalëve kryesore, hapësira në mes të fjalëve, radha e fjalëve, pikësimi dhe shkronja e madhe. Rezultatet e elementeve janë "saktë" (2 pikë), "pjesërisht saktë" (1 pikë – përveç shkronjës së madhe dhe pikësimit) dhe "pasaktë" (0 pikë).

Një shembull i A-EGRA mund të gjendet online në faqen e BEP [www.bep-ks.org]. A-EGRA mund të administrohet në formë të printuar apo në format elektronik. Forma elektronike e testit është shumë më e lehtë për përdorim dhe merr më pak kohë për rezultate, por kërkon qasje në tabletë që punojnë në sistemin Android.

Shënime:



PJESA 6: PËRFSHIRJA E FAMILJES

Ka dëshmi të forta të hulumtimeve që tregojnë se fëmijët prindërit e të cilëve i përkrahin në mënyrë aktive gjatë mësimit për të lexuar kanë arritje më të mira akademike, kompetencë njohëse dhe shkathtësi të zgjidhjes së problemeve. Ata kënaqen më shumë në shkollë dhe kanë vijueshmëri më të mirë dhe më pak probleme me sjellje. Kjo është e vërtetë për shkollim fillor por edhe për shkollim të mesëm.

Suksesi në lexim është derë për sukses në fushat tjera akademike.

Çka mund të bëjnë prindërit?

Kënaqësia gjatë leximit është faktor më i rëndësishëm për sukses në arsimim sesa statusi socio-ekonomik i familjes.

Leximi është lëndë shkollore ku përkrahja e prindërve ka më së shumti ndikim dhe rezultat. Interesimi i prindërve për arsimimin e fëmijëve të tyre është parashikuesi i vetëm dhe më i mirë për arritjet në lexim dhe suksesin arsimor deri në moshën 16-vjeçare, më i rëndësishëm se klasa shoqërore, madhësia e familjes dhe niveli arsimor i prindërve. Gjithashtu, sa më herët që prindërit përfshihen në zhvillimin e shkrim-leximit të fëmijëve aq më i madh dhe më afat-gjatë është ndikimi.

Disa prindër mendojnë se roli i tyre është t'i shtojnë fëmijët të punojnë më shumë, të ërsërisin dhe të praktikojnë. Por kur kemi të bëjmë me shkrim-leximin, kjo mund të mos jetë gjëja më e mirë. Zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj leximit është më i rëndësishmi – qëndrimi pozitiv ndaj leximit është i lidhur jo vetëm me kënaqësinë gjatë leximit, por edhe me sukses në leximin e materialeve sfiduese të leximit.

Shkollat dhe mësimdhënësit duhet të sigurohen që prindërit e kanë këtë informatë.

Prindërit DUHET TË:

- Kenë shumë libra përreth dhe t'i lejojnë fëmijët t'i shohin duke lexuar dhe duke u kënaqur gjatë leximit.
- I lejojnë fëmijët ta shohin vlerën informative të recetave, udhëzimeve, hartave, etiketave, internetit, etj.
- I dërgojnë fëmijët shpesh në bibliotekë/librari, i lejojnë të hulumtojnë dhe t'i zgjedhin librat për vete.
- U lexojnë fëmijëve të vet me zë – dhe ta lejojnë fëmijën ta zgjedhë librin.
- I diskutojnë librat dhe tregimet që i lexojnë, qoftë së bashku apo vetë.
- I mësojnë fëmijës së vet këngë dhe rima, dhe të këndojnë apo recitojnë së bashku.

... dhe prindërit NUK DUHET TË:

Kalojnë kohë duke përsëritur dhe praktikuar në formë formale por më parë të kalojnë kohë në lexime që japin kënaqësi sepse mund të ushtrojnë presion në fëmijët që çon drejt qëndrimeve negative ndaj leximit.

Shkarko kopjen e “Si ta bëj fëmijën tim lexues më të mirë? Ide dhe udhëzime për prindërit”, botuar nga Basic Education Program i USAID-it, në:

<http://sq.bep-ks.org/thesari/>

Prindërit dhe shkollat punojnë së bashku

Prindërit të cilët sigurojnë një mjedis të tillë në shtëpi japin kontribut të madh për të nxënëit e fëmijëve të tyre. Por prindërit kanë ndikim edhe më të madh për arritjet e fëmijëve të tyre duke përkrahur planin e shkrim-leximit të shkollës, sidomos gjatë viteve të para të shkollimit fillor. Prindërit mund ta përforcojnë atë që shkolla u mëson duke:

- siguruar mundësi për t'i zbatuar dhe praktikuar njohuritë dhe shkathtësitë e mësuara në shkollë;

- inkurajuar fëmijët të ndajnë dhe diskutojnë atë që kanë mësuar në shkollë;
- monitoruar përparimin e fëmijëve; dhe
- duke sjellë dëshmi të gjërave që fëmija mund të bëjë në bisedat prind-mësimdhënës.

Për shembull, prindërit mund të modelojnë përdorimin e fonetikës duke i dekoduar fjalët e panjohura në librat që i lexojnë së bashku dhe t'i udhëzojnë fëmijët kur ata përpigjen të zbatojnë strategjitë e fonetikës. Prindërit gjithashtu mund ta përkrahin zhvillimin e rrjedhshmërisë duke inkurajuar lexime të përsëritura të teksteve të njohura dhe të kuptuarit duke parashtruar pyetje dhe duke i diskutuar përgjigjet.

Edhe për shkollën ka përfitime të mëdha në përfshirjen e prindërve. Përfshirja e prindërve mund t'i lirojë mësimdhënësit duke i lejuar të fokusohen më shumë në mësimdhënien e tyre. Gjithashtu, duke pasur më shumë kontakt me prindërit, mësimdhënësit mësojnë më shumë për mjedisin shtëpiak dhe nevojat e nxënësve e rrjedhimisht mund t'i plotësojnë më mirë këto nevoja. Prindërit të cilët janë të përfshirë në të nxënit e fëmijëve të tyre zakonisht kanë qëndrim më pozitiv ndaj mësimdhënësve, që rezulton me moral më të ngritur të mësimdhënësve.

Tre hapa drejt partneritetit shtëpi/shkollë

Ekzistojnë tri mënyra kryesore si mund ta inkurajojë shkolla përfshirjen e prindërve:

- **t'i ndihmojë të kuptojnë se çfarë duhet të bëjnë**
- **t'i mbajë të informuar; dhe**
- **t'i përfshijë si vullnetarë.**

1: Ndhimjoji prindërit të kuptojnë se çfarë të bëjnë

Prindërit duhet ta kuptojnë rëndësinë e përfshirjes në arsimimin e fëmijëve të tyre dhe gjithashtu kanë nevojë për informata specifike se si t'i ndihmojnë dhe përkrahin fëmijët e tyre.

Shkollat/mësimdhënësit duhet të sigurohen se që nga fillimi, të gjithë prindërit dinë çka të bëjnë për të ndihmuar fëmijët e tyre të zhvillojnë shkathtësitë e leximit – dhe gjithashtu çka nuk duhet të bëjnë.

Basic Education Program (BEP) i USAID-it ka përpiluar një udhëzues për prindër: *Si ta bëj fëmijën tim lexues më të mirë? Ide dhe udhëzime për prindërit*, të cilin shkollat mund ta shfrytëzojnë për ta përkrahur takimin me prindërit e rinj për rolin e tyre. Është me rëndësi që prindërit në shkollën tuaj të jenë të vetëdijshëm për këtë dokument.

2: Mbaj prindërit të informuar

Mësimdhënësit mund t'i ndihmojnë prindërit duke siguruar informata të shpeshta dhe të rregullta rreth përparimit të fëmijës së vet dhe mënyrave se si mund të përkrahin në aktivitete specifike.

Komunikimi efektiv me prindërit duhet të ketë tri gjëra: t'i informojë ata çka bën fëmija i tyre në klasë; çka ka arritur fëmija i tyre; dhe çka mund të bëjnë për ta ndihmuar të nxënit e fëmijës së tyre. Një mënyrë e mirë për ta bërë këtë është **Ide për prindërit**. Ide për prindërit shpjegon: fushën tematike dhe shkathtësitë që zhvillohen; çka është duke bërë fëmija në shkollë; dhe aktivitetet të cilat prindërit dhe fëmijët mund t'i bëjnë në shtëpi e që lidhen dhe e zgjerojnë të nxënit në klasë. Fëmijët e marrin fletën në shtëpi kur është koha e përshtatshme. Prindërit dhe fëmijët bëjnë aktivitete dhe diskutojnë për atë që mësojnë dhe si lidhet me atë që mëson fëmija në shkollë.

Shembull i Ide për prindërit

Tema	Të nxënit në klasë	Të nxënit në shtëpi
Si rriten dhe zhvillohen gjërat	Mbjellja e farave dhe vëzhgimi i tyre duke u rritur – matja javore e tyre	Shikoni fotografi të vjetra për të parë si është rritur fëmija juaj çdo vit. A ekziston ndonjë mur në shtëpi ku e matni rritjen e fëmijës tuaj? Cilin vit është rritur ai/ajo më së shumti?

Pastaj prindërit dhe fëmijët mund t'i japin mesimdhënësit informata kthyesë për aktivitetin "ide për prindërit", për shembull duke përdorur sistemin e semaforit për të theksuar nëse detyra ishte: e lehtë (gjelbër); mesatare/në rregull (portokall); apo e vështirë (kuqe).

Edhe prindërit kanë nevojë për informata kthyesë për përparimin e fëmijës së tyre. Por është me rëndësi t'iu japim informata kthyesë në formën e cila i inkurajon ata t'i ofrojnë fëmijës së tyre përkrahjen e duhur.

Vetëm notat nuk i japin prindërve apo nxënësve udhëzime të dobishme në lidhje me atë që duhet të bëjnë në vijim, apo si t'i përmirësojnë rezultatet e tyre.

Në vend të kësaj, mesimdhënësit duhet të fokusohen t'i ndihmojnë prindërit që ata të ndihmojnë fëmijët e tyre. Informatat e tyre kthyesë për prindërit duhet të jenë kryesisht në ton pozitiv, në mënyrë që të mos rrezikohet dekurajimi i prindërve dhe të mos ndjehen se nuk mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në mënyrë efektive. Por ato duhet edhe të specifikojnë çka ka arritur fëmija dhe çka duhet të bëjnë për ta përmirësuar. Kështu, gjatë komunikimit me prindër, mesimdhënësit duhet ta mbajnë mend parimin kryesor "dy yje dhe një dëshirë" – gjithnjë thoni së paku dy gjëra pozitive në lidhje me të nxënit e fëmijës para se të thoni se ku kanë nevojë për përmirësim – dhe përshkruani arritjet e fëmijës, si dhe synimet, në aspekt të rezultateve të të nxënit dhe kriteret e suksesit.

Gjithashtu mendoni edhe për teknologjinë. Shumica e prindërve kanë kompjuterë. Pothuaj të gjithë kanë telefona mobilë. Keni parasysh edhe komunikimin me SMS apo email me prindërit.

3: Prindërit vullnetarë

Shumica e shkollave kanë prindër vullnetarë të cilët vijnë në shkollë për të ndihmuar në mënyra të ndryshme. Një nga aktivitetet për të cilat prindërit paraqiten vullnetarë më së shpeshti është t'i dëgjojnë fëmijët e klasave të ulëta duke lexuar.

Në nivelin më bazik, është e dobishme nëse prindërit të cilët rregullisht i dëgjojnë fëmijët e tyre duke lexuar të vijnë në shkollë dhe ta bëjnë të njëjtën për fëmijët tjerë – sidomos fëmijët të cilët nuk kanë përkrahje të tillë të mjaftueshme nga prindërit e tyre.

Shkolla duhet të sigurojë kohë të rregullt për vullnetarët që t'i dëgjojnë fëmijët duke lexuar dhe hapësirë relativisht të qetë dhe të rehatshme, si dhe pa shpërqendrim.

Materiali i leximit që përdoret duhet të zgjidhet nga fëmija në konsultim me mësime dhënësin.

Të gjithë vullnetarëve duhet t'u jepen udhëzime apo trajnim në lidhje me mënyrën si zhvillohet shkrim-leximi, në lidhje me rolin e vullnetarëve dhe si të dëgjohen fëmijët duke lexuar. Vullnetarët gjithashtu duhet të jenë të vetëdijshëm se konfidencialiteti është shumë i rëndësishëm – ata nuk duhet të flasin kurrë për asnjë fëmijë jashtë klasës. Mësime dhënësin duhet gjithashtu t'i monitorojnë me kujdes vullnetarët në fillim, për t'u siguruar që sillen në mënyrë të përshtatshme ndaj fëmijëve dhe që ata e kuptojnë rolin e tyre.

Ndihmësit në klasë

- Ndihmësit në klasë paraqiten vullnetarë për të ndihmuar mësime dhënësin rregullisht, zakonisht për t'i dëgjuar nxënësit duke lexuar.
- Praktika e leximit është intensive dhe e lodhshme; ndihmësit mund të jenë shumë të dobishëm.
- Ndihmësit janë shpeshherë, por jo gjithmonë, prindër.
- Ndihmësit përkushtohen për të kaluar kohë të rregullt në shkollë çdo javë, nga gjysmë ore e më shumë.
- Hulumtimet tregojnë se prindi i cili paraqitet vullnetar e përmirëson përvojën e fëmijës në shkollë edhe nëse nuk ndihmon në klasën e fëmijës së vet.

Prindërit krijuan bibliotekën e shkollës

Një bibliotekë e udhëhequr nga prindërit u themelua në partneritet në mes të një shkolle fillore dhe këshillit të prindërve. Në fillim u vendos që ajo do të financohej dhe menaxhohej nga prindërit vullnetarë.

Disa prindër vullnetarë dekoruan sallën përderisa të tjerët morën pjesë në punëtori në një bibliotekë publike lokale për të mësuar si ta përdorin sistemin e klasifikimit të bibliotekës.

Tani biblioteka menaxhohet plotësisht nga prindërit vullnetarë të cilët përkushtohen në baza javore për të punuar me nxënësit.

Në mënyrë ideale, prindi i cili është vullnetar i suksesshëm e viziton shkollën rregullisht. Në këtë rast, është ide e mirë nëse atyre u jepet një strukturë dhe përgjegjësi. Për shembull, shkolla mund ta prezantojë leximin e përbashkët (shih Pjesën 8) si teknikë e cila mund të përdoret nga vullnetarët, e përcjellë me një trajnim të shkurtër për ta për mënyrën si të përdoret.

Një shkollë fillore që filloi me një program të ri të leximit i ftoi prindërit në një mbledhje joformale. Drejtori dhe mësime dhënësi i klasës biseduan me prindërit dhe u treguan për këtë program. Prindërit u pajtuan të vijnë në shkollë nga një orë në javë për 6 javë radhazi për të luajtur lojëra gjuhësore me fëmijën e tyre. Pasi që u ndihmonin fëmijëve ta zgjedhin lojën, prindërit e merrnin lojën në shtëpi dhe luanin me fëmijën e tyre çdo ditë nga 10-15 minuta.

Përfitimet për prindërit ishin:

- Morën ide në përkrahjen e të nxënës të fëmijëve të tyre
- Identifikuan mundësi të reja për të nxënë
- U kënaqën duke ndihmuar arsimimin e fëmijës së vet

Përfitimet për shkollën ishin:

- Mësuan vlerën e përfshirjes së prindërve
- Mësuan si t'i përfshijnë prindërit në mënyrë efektive

Përfitimet për fëmijët ishin:

- U kënaqën gjatë kohës cilësore me prindërit e tyre
- Përjetuan lojëra të reja
- Fituan shkathtësi themelore të leximit

PJESA 7: LEXIMI DHE BARAZIA GJINORE



Vajzat performojnë më mirë se djemtë në lexim në çdo vend apo shtet për të cilët ka të dhëna në dispozicion, edhe pse dallimi ndryshon nga vendi në vend; dhe kjo vazhdon së paku deri në arsimin e mesëm të lartë. Dallimi në arritje në mes të djemve dhe vajzave është veçanërisht i lartë mes nxënësve më të dobët, ndërsa për sa i përket shkathtësive të "larta", vajzat kanë tendencë të jenë shumë më të mira se djemtë në teste të cilat përcaktojnë vlerën e reflektimit dhe vlerësimit.

Sipas PISA-s (një studim i bërë në nivel ndërkombëtar në klasën e 9), angazhimi në lexim është shumë më i lartë tek vajzat. Më shumë ka mundësi që vajzat të thonë se janë të lumtura që kanë marrë një libër për të lexuar, apo që kënaqen kur shkojnë në bibliotekë apo librari, ndërsa djemtë më shumë ka mundësi të thonë se leximi është humbje kohe, se lexojnë vetëm nëse duhet apo vetëm për të marrë informata. Faktorët tjerë të rëndësishëm duket se janë që vajzat kanë tendencë të lexojnë më shumë letërsi artistike sesa djemtë dhe tregojnë më shumë përpjekje dhe përkushtim në lexim.

Dallimi në arritje mes vajzave dhe djemve ndërlihet me dallime sistematike në qëndrime dhe sjellje - por këto nuk janë gjetur tek fëmijët e vegjël. Në klasat e ulëta (1-2), dallimet gjinore në qëndrimet ndaj leximit janë të vogla dhe qëndrimet janë jashtëzakonisht pozitive. Qëndrimet kanë tendencë të bëhen më pak pozitive për të dy gjinitë gjatë klasave 3-6, e më tej edhe më shumë gjatë klasave 7-10; por ky ndryshim është shumë më i madh në mesin e djemve se të vajzave.

Shumica e dallimeve në arritje mes djemve dhe vajzave mund të shpjegohet me dallimet sistematike në motivim, interesim dhe shprehje të mësim. Analizat statistikore sugjerojnë se nëse djemtë kanë të njëjtin nivel të angazhimit në lexim sa vajzat, dallimi në arritje do të zvogëlohej

me më shumë se gjysma; dhe nëse djemtë kanë të njëjtat nota mesatare në të tri matjet si vajzat, dallimi mesatar në arritje do të zvogëlohej me më shumë se dy të tretat.

Kjo sugjeron se dallimet në arritje mes vajzave dhe djemve në fakt janë më pak për shkak të “fakteve” biologjike sesa të modeleve të ndryshme të socializimit. Kështu, në vend që të pyesim “çka mund të bëjmë për t’i ngritur arritjet e djemve?”, ka kuptim të pyesim “si mund të krijojmë një mjedis në klasë ku eliminohen këto pengesa të ndërtuara nga shoqëria dhe ku të gjithë kanë të njëjtën qasje ndaj leximit?”

Si mund ta promovojmë barazinë gjinore?

Përforcimi i sjelljes së dëshiruar

Meqenëse qëndrimi pozitiv ndaj leximit është aq thelbësor, qëndrimi i të gjithë nxënësve ndaj leximit duhet të jetë sa më pozitiv që është e mundur. Disa djem, që në klasë II e shohin leximin si diçka që e bëjnë vajzat. Një studim kanadez i kohëve të fundit arriti në përfundimin se një në katër djem të klasës së II e shohin leximin në këtë mënyrë. Një qëndrim i tillë mund t’i bëjë ata të mos lexojnë aq shpesh sa vajzat, e kjo do të kishte ndikim negativ në të nxëniet e tyre.

Djemtë që e shohin leximin si aktivitet femëror ka mundësi ta formojnë këtë perceptim para se të fillojnë shkollën. Ekspozimi në veçanti i djemve karshi librave dhe leximit në moshë sa më të hershme që është e mundur është një mënyrë e rëndësishme për të krijuar entuziazëm për librat para se të ndikohen nga moshatarët për ta parë leximin si “vajzëror”.

Mësimdhënësi duhet të mundohet t’i inkurajojë të gjithë nxënësit ta shohin leximin si pozitiv, për shembull duke i angazhuar në diskutime në lidhje me atë që kanë dëshirë të lexojnë dhe duke u dhënë përforcime pozitive atyre që tregojnë entuziazëm për diçka që kanë lexuar, madje edhe nëse është diçka jashtë materialeve “tradicionale” të miratuara.

Kujdesi ndaj interesimeve individuale

Perceptimi individual ndaj leximit ndikohet shumë nga fakti që ka libra që cilët i tërheqin. Kështu që shfrytëzimi i teksteve në klasë, dhe për lexim të zgjeruar, reflektimi sa më shumë ndaj interesimeve të të gjithë anëtarëve të klasës, ndihmon në zhvillimin e qëndrimit më pozitiv ndaj leximit dhe rrjedhimisht motivimit më të madh për të lexuar.

Në mënyrë stereotipike, vajzat kanë tendencë të lexojmë me empati (pra janë më të ndjeshme ndaj asaj që lexojnë) dhe të përfshihen më shumë emocionalisht. Kjo nënkupton se ato preferojnë tregime me “veprim të brendshëm” – tregime për raporte, psikologji, apo tregime ku fati njerëzor është në qendër të vëmendjes. Ato kanë tendencë të preferojnë tregime reale, apo tregime që kanë të bëjnë me jetën, situatën apo mjedisin shoqëror të tyre.

A paragjykoni në lidhje me gjininë?

Identifiko gjininë e këtyre nxënësve

- Këta nxënës ndihmojnë kur duhet të lëvizin orenditë në klasë.
- Këta nxënës janë më të mirët për ta mbajtur tabelën e pastër.
- Kur vijnë vizitorë në klasë, unë ua jap fjalën këtyre nxënësve për të recituar poezi.
- Kur nevojitet ndonjë riparim i vogël, gjithnjë mund të llogaris në këta nxënës.

A mendoni se paragjykoni?

Djemtë, nga ana tjetër, preferojnë të mbajnë njëfarë distance emocionale në mes të vetes dhe materialit të tyre të leximit. Kështu, ata kanë tendencë të pëlqejnë informata faktike dhe humor, shaka dhe parodi. Në letërsinë artistike, ata kanë tendencë të preferojnë narracione të ankthit apo aksion (tejkalimi i vështirësive apo kundërshtarëve, heronj të cilët duhet ta dëshmojnë veten në aventura apo beteja dhe të cilët duhet t'i tejkalojnë sfida) dhe tregime për udhëtime, vende ekzotike, kohëra të largëta me skenarë të pamundur, apo me prapavijë historike apo fantastiko-shkencore. Një hulumtim i kohëve të fundit në SHBA arriti në përfundimin që zhanret të cilat mendohet se pëlqehen nga djemtë janë më pak në dispozicion në klasa, ndoshta sepse mësimdhënësit dhe bibliotekistët mendojnë se janë të papërshtatshme për lexime në shkollë, apo sepse mësimdhënësit janë kryesisht femra dhe librat që zgjedhin për nxënësit e vet pasqyrojnë këtë fakt.

Kujdesi ndaj preferencave për leximin e nxënësve duke u siguruar shumëllojshmëri të teksteve përveç se inkurajon qëndrim pozitiv ndaj leximit, njëkohësisht nxit rrjedhshmërinë dhe vetëbesimin në lexim. Edukatorët duhet të sigurojnë që lista për lexim në klasën e tyre dhe koleksioni i bibliotekës kanë lloje të mjaftueshme që i tërheqin të gjithë nxënësit. Kjo nënkupton përfshirjen e librave në lidhje me sportet, tregime për kafshët, përralla aventura me protagonistë meshkuj apo ngjarje të përditshmërisë si edhe tregime tradicionale. Por nxënësit duhet gjithashtu të inkurajohen të gjejnë materiale leximi të cilat u interesojnë, për shembull në internet.

Plotësoi zbrazëtirat ...

"Oh, të lutem më ndihmo ____!" thirri _____. "Jemi aq lart! Kam frikë se do të rrëzohemi!"

Cili emër shkon në zbrazëtira?

Suzi Gjoni

Minimizo animin apo stereotipin gjinor

Literatura për fëmijë dhe tekstet shkollore luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e shkathtësive të leximit të fëmijët. Ato (sidomos literatura për fëmijë) kontribuojnë shumë në transmetimin e kulturës shoqërore të fëmijët. Një pjesë e rëndësishme e kulturës janë edhe rolet gjinore; kështu që mënyra se si prezantohen ndikon në mënyrën se si e zhvillojnë fëmijët rolin e tyre dhe si e kuptojnë gjininë në shoqëri.

Një kontroll i librave për fëmijë tregon se ka anim të ndjeshëm ndaj personazheve mashkullore dhe stereotipizim të roleve femërore dhe mashkullore. Kështu që mund të thuhet se "animi gjinor ekziston në përmbajtje, gjuhë dhe ilustrime në një numër të madh të librave për fëmijë"¹. Në të njëjtën kohë, prezantimi i roleve tradicionale i kufizon si djemtë ashtu edhe vajzat. Rrallë herë djemtë lejohen të shfaqin emocione të frikës dhe pikëllimit, ndërsa vajzat shpeshherë janë personazhe dytësore dhe u jepen cilësi pasive.

Udhëzues për zgjedhjen e librave për fëmijë

Do të preferohej që shkollat të zgjidhnin libra që prezantojnë personazhe femërore dhe mashkullore të të gjitha llojeve, madhësive dhe llojllojshmërisë. Lista kontrolluese në vijim mund të përdoret për të zgjedhur libra neutralë ndaj gjinisë:

- Mbizotërojnë personalitetet e dalluara, qofshin meshkuj apo femra
- Djemtë dhe vajzat mund të arrijnë në mënyrë të barabartë edhe në fusha të njëjta
- Rolet dhe profesionet janë të përfaqësuara pa dallim gjinie

¹ www.kidsource.com/education/gender.issues.L.A.html, Çështjet gjinore në Literaturën për Fëmijë. Shkarkuar më 6 qershor, 2012.

- Femrat nuk janë gjithnjë më të dobëta dhe më të ndjeshme se meshkujt
- Meshkujt nuk janë gjithnjë duke garuar dhe duke arritur pritshmëri të larta
- Individët janë logjikë apo emocionalë, varësisht nga situata
- Gjuha e përdorur në tekst është e balancuar dhe pa dallim gjinor
- Kujdes ndaj faktit se shumica e kafshëve të prezantuara në literaturën për fëmijë janë meshkuj.

Sidoqoftë, ekzistojnë pak libra të ndjeshëm ndaj gjinisë. Përveç kësaj, ka mungesë të vetëdijes që libra të tillë ekzistojnë si dhe rezistencë për t'i përdorur burimet për blerjen e tyre. Kështu që, tekstet shkollore ekzistuese dhe literatura për fëmijë mund të përdoren si të tilla për ta zhvilluar vetëdijen e fëmijëve për barazinë gjinore.

“Testi Bechdel”

(Sipas shkrimtarit që e ka përpiluar)

Një tregim, për ta kaluar testin, duhet:

- të ketë së paku dy emra të personazheve femra;
- personazhet të flasin mes vete në lidhje me diçka; dhe
- të mos flasin për ndonjë mashkull.

Libri apo tregimi i cili nuk i ka këto tria nuk e kalon testin.

Përdorimi i librave ekzistues për promovimin e barazisë gjinore

Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë librat ekzistues për të hulumtuar çështjet gjinore me nxënësit e tyre. Për shembull, nëse ilustrimet paraqesin djemtë duke luajtur futboll, mund të pyeten nxënësit nëse vetëm djemtë luajnë futboll. Një fushë tjetër kryesore që mund të hulumtohet janë rolet gjinore në shtëpi dhe punë.

Lista kontrolluese në vijim ofron një pikë nismëtare për mësimdhënësit që të krijojnë vetëdije gjinore dhe kështu ta promovojnë barazinë gjinore duke i përdorur tekstet shkollore ekzistuese dhe literaturën për fëmijë.

Analiza e librit në lidhje me çështjet gjinore

- Analizo me nxënësit supozimet gjinore në tekst.
- Parashtro pyetje në lidhje me personazhin kryesor dhe si është paraqitur personazhi.
- Kërko nga nxënësit ta ndryshojnë gjininë e individëve, p.sh. Çka nëse pirati është femër; çka nëse princi është princeshë, çka nëse ujku është ulkonjë?
- Lexo pjesë të shkurtra dhe kërko nga nxënësit t'ia qëllojnë gjinisë së personazhit duke dhënë arsye për mendimet e tyre. Vazhdo me diskutim në lidhje me çështjet që dalin nga arsyetimet.
- Kërko nga nxënësit të ndërmarrin këndvështrimin e gjinisë së kundërt në lidhje me çështjet që diskutohen (p.sh. duhet të qëndrosh në shtëpi dhe të lash enët në vend që të dalësh me shokë; të të thonë se nuk bën që qash kur lëndohesh).
- Kërko nga nxënësit të planifikojnë një rol të bazuar në tregim ku nxënësit luajnë rolin e gjinisë së kundërt.
- Përdor ilustrimet në tekst për të shikuar rolet gjinore.
- Shfrytëzo “momentet e mësimi” për të diskutuar çështjet gjinore.



PJESA 8: AKTIVITETE MËSIMORE PËR KLASËN TUAJ

8.1 Leximi me zë për nxënësit (parashtrimi i pyetjeve të mira)

8.2 Leximi i përbashkët

8.3 Librat për lexim sipas klasave

8.4 Mini-Librat

8.5 Leximi me Zë i Udhëzuar

8.6 Leximi me Jehonë

8.7 Leximi në Dyshe

8.8 Teatri i Lexuesve

8.9 Leximi i Pandërprerë në Heshtje

8.10 Gjëgjëzat me Zë

8.11 Ecim me Fjali

8.12 Rimë dhe Këngë

8.13 Pllakat dhe Tiketat e Alfabetit

8.14 Shkronjat dhe Fjalët që Mungojnë

8.15 Klasifikimet e Koncepteve dhe Fjalëve

8.16 Tiketatat me Fjalë

8.17 Aktivitete me Harta

8.18 Shkrimi i Emrit

8.19 Shiritat e Fjalive

8.20 Imitimi i Tregimit

8.21 Shkrimet e Përbashkëta

8.22 Shkrimi me Zë

8.23 Hamburgeri i Paragrafëve

8.1 Leximi me zë për nxënësit

... parashtrimi i pyetjeve të mira

Leximi me zë: teknikë me tre hapa

Ndihmon zhvillimin e:

- Dëgjim-kuptimit
- Vetëdijes tingullore
- Rrjedhshmërisë
- Lexim-kuptimit



Leximi me zë konsiderohet si gjëja më e rëndësishme që mund të bëjnë prindërit për t'i ndihmuar fëmijëte tyre të mësojnë të lexojnë. Leximi me zë për fëmijët e moshës 3 deri 6 vjeç zhvillon të kuptuarit e sintaksës dhe fjalorit, si dhe ndjeshmërinë ndaj strukturave gjuhësore dhe organizative të tekstit. Këto përfitime janë të dukshme edhe nëse leximi me zë është i shkurtër. Vetëm leximi i librave me zë nuk është i mjaftueshëm për nxitjen e zhvillimit të fjalorit të nxënësve dhe dëgjim-kuptimit. Mënyra se si u lexohen librat fëmijëve ka rëndësi të madhe. Edhe pse nxënësit kanë dëshirë t'iu lexohet, ata nuk do t'i zhvillojnë shkathtësitë e veta të leximit nëse janë vetëm pranues pasivë. Nxënësit duhet të jenë dëgjues aktivë, të reflektojnë mbi përmbajtjen, të parashtrojnë pyetje dhe të bëjnë lidhje për t'i zhvilluar ato.

Kur mësimdhënësi lexon, nxënësit duhet të jenë dëgjues aktivë e jo pasivë.

Në klasë, leximet më efektive me zë janë ato ku:

- Mësimdhënësit parashtrojnë pyetje me kuptim duke kërkuar nga nxënësit të parashtrojnë dhe t'u përgjigjen pyetjeve, si dhe të bëjnë parashikime;
- Fëmijët e rikujtojnë tregimin plotësishtose pjesërisht brenda një afati të arsyeshëm kohor;
- Një libër lexohet më shumë se një herë;
- Lexohen libra të tjerë në lidhje me temën; dhe
- Përdoret një qasje sistematike për zhvillimin e fjalorit, si përfshirja e definicioneve të shkurtra të fjalëve dhe frazave gjatë leximit.

Gjatë leximeve me zë në mënyrë ndëraktive dhe të përsëritur, një libër lexohet tre herë në mënyra paksa të ndryshme, që të rritet sasia dhe cilësia e bisedës analitike të fëmijëve përderisa përgjigjen me kujdes në pyetjet e parashtruara.

Secilën herë që libri prezantohet:

- Herëne parë, mësimdhënësit e prezantojnë ngjarjen e tregimit, shtojnë komente, parashtrojnë disa pyetje thelbësore, dhe përfundimisht parashtrojnë pyetjen "pse" duke kërkuar shpjegime të zgjeruara. Kjo shoqërohet me elaborimin e disa fjalëve thelbësore të fjalorit.

- Leximet e dyta e çojnë më tej të kuptuarit në rritje të fëmijëve për tregimin, duke siguruar shpjegime të pasura të fjalorit dhe duke parashtruar pyetje shitesë të nënkuptuara dhe shpjeguese.
- Leximet e treta përbëhen nga rikrijimi i tregimit i udhëhequr nga mësuesja, ku fëmijët i rikujtojnë informatat duke ofruar shpjegime dhe komente.

Këto teknika janë treguar efektive në rritjen e angazhimit, të kuptuarit, dhe vlerësimit të letërsisë në nivel parashkollor dhe kopshte.

Leximi i parë me zë

Leximi i parë me zë përfshin katër komponentë: prezantimi i librit, teknikat për përkrahje të fjalorit, komentet dhe pyetjet analitike, dhe pyetja “pse” pas leximit. Këto teknika janë zgjedhur me kujdes për t’i ndihmuar fëmijët të ndërtojnë të kuptuarit fillestar më të mirë të tregimit, duke përfshirë edhe një pjesë të fjalorit të tij.

Prezantimi i librit: prezantoje librin me tre apo katër fjali, duke e bërë ngjarjen e tregimit më të qartë. Tregoju nxënësve ballinën, e ndoshta edhe faqen e fundit dhe faqen e titullit (në vend të të gjitha ilustrimeve siç bëhet në ecjen në fotografi/pamje). Përfundoni me një “nxitje” – si “Le të shohim çka ndodh me të ...”

Përfshirja e përkrahjes së fjalorit

Para leximit të librit me zë, zgjedhim 5 deri 10 fjalë apo fraza të fjalorit nga libri të cilat i theksojmë apo i definojmë gjatë leximit. Këto fjalë janë kritike për të kuptuarit e tregimit dhe ka mundësi të hasen edhe në të ardhmen. Ndonjëherë libri nuk përfshin fjalor specifik të cilin lexuesit do ta shfrytëzonin për të menduarit e tyre analitik në lidhje me librin në fjalë, kështu që ne i shtojmë këto fjalë të fjalorit në prezantimin e librit dhe komentet tona përderisa e lexojmë me zë. Për shembull, ne shtojmë fjalët gabim, katastrofë, gjëmë, dhe marrëzi, kur lexojmë “Heni Peni”, sepse këto fjalë janë kritike për analizën e problemit në raport me motivimin dhe veçoritë e personazhit kryesor. Pasi i zgjedhim fjalët dhe frazat e fjalorit, i theksojmë fjalët apo rrisim të kuptuarit e fjalës apo frazës në njërin nga pesë mënyrat:

1. Shtojmë një frazë apo fjali të shkurtër e cila e përcakton apo shpjegon një fjalë, si kur themi “Gostia është një darkë shumë e madhe.»
2. Pikasim në pjesë të caktuara të ilustrimit që ndihmojnë në qartësimin e të kuptuarit të një fjale apo fraze, si kur pikasim ilustrimin gjatë kohës që e lexojmë fjalën në tekst.
3. Përdorim gjeste dramatike, si demonstrimin e kuptimit të shprehjes ‘mbledh supet’ duke i mbledhur vetë supet tona gjatë kohës që lexojmë.
4. Përdorim zërin, si kur i bëjmë të qarta pretendimet dinake të dhelpres duke e lexuar tekstin me zë të hollë.
5. Ndryshojmë shpejtësinë me të cilën lexojmë fjalët apo frazat, si kur lexojmë më shpejt atë që thotë Heni Peni për ta demonstruar nxitimin e saj të marrë.

Nevojiten vetëm disa momente për të planifikuar se si do ta përkrahim të nxënësit e secilës fjalë nga fëmijët, por leximet më efektive me zë janë ato në të cilat ne vendosim se cilën teknikë për zhvillimin e fjalorit do ta përdorim për secilën fjalë. Për fjalët të cilat do të qartësohen në mënyrë verbale, planifikojmë shpjegime të shkurtra të cilat “shtohen” në leximin e tregimit ashtu që definicionet bëhen pjesë e tregimit aktual pa e ndërprerë rrjedhën e leximit.

Komentet dhe pyetjet që përkrahin dhe zgjerojnë të kuptuarit

Gjatë leximit ne bëjmë komente të cilat demonstrojnë të menduar analitik në tri apo katër udhëkryqe në të cilat lexuesit idealë nxjerrin informata në lidhje me mendimet, ndjenjat apo motivimet e personazhit, apo i parashikojmë ngjarjet në vijim. Kur komentojmë në lidhje me një tregim, shpesh herë përdorim gjuhën për të sinjalizuar ndonjë aktivitet mendorduke përdorur frazën “Po mendoj.” Për shembull, në skenën ku HeniPeni thotë, “Qielli po bie. Duhet të shkoj dhe t’i tregoj mbretit”, ne mund të komentojmë “Po mendoj se kjo është kur pula është duke bërë diçka me të vërtetë të marrë. Ajo as nuk po shikon poshtë për të marrë vesh çka e ka goditur në fakt. Unë mendoj se ajo po shikon lart në vend që të shikojë poshtë.” Pastaj mund të vazhdojmë të pyesim, “Pse mendon pula se një pjesë e qiellit ka rënë në kokën e saj?” Ne kemi zbuluar qëpërgjigjet e nxënësve në pyetjet që pasojnë pas komenteve tona analitike kanë më shumë mundësi të jenë të ndërlidhura me tregimin. Kjo sekuencë e mësimdhënies siguron një qasje të qëllimshme dhe sistematike drejt zgjerimit të të kuptuarit të fëmijëve. Kemi vënë re se shumica e fëmijëve të vegjël ende nuk janë të aftë të angazhohen në të menduar dhe bisedë analitike pa modelimin apo pyetjet e mësimdhënësit

Leximi i dytë me zë

Leximi i dytë me zë bëhet një apo dy ditë pas leximit të parë. Qëllimi është të pasurohet të kuptuarit e fëmijëve për tregimin dhe të sigurohen mundësi të mëtejshme për fëmijët që të angazhohen në biseda analitike. Gjatë udhëzimeve të dyta për librin, ne ua rikujtojmë fëmijëve se e kanë lexuar këtë libër më parë dhe se i kanë mbajtur mend disa gjëra në lidhje me librin; për shembull ne mund të themi

“Ne e lexuam këtë libër dje dhe me siguri e mbani mend se”

Ne vazhdojmë t’i theksojmë fjalët e njëjta të fjalorit; megjithatë, gjatë leximit të dytë ne definojmë verbalisht më shumë fjalë.

Gjatë leximit të dytë, ne vazhdojmë t’i modelojmë komentet analitike, por parashikojmë pyetje më shpesh të cilat i ndihmojnë fëmijët të nxjerrin informata shtesë. Gjatë leximit të parë, komentet tona fokusohen në nxitjen e fëmijëve të nënkuptojnë atë që mendon apo ndjen personazhi kryesor apo t’i ndërlidhin ngjarjet kryesore me shkaqet e tyre. Kështu që, komentet dhe pyetjet tona gjatë leximit të dytë mund të përqendrohen në motivet dhe mendimet e personazheve tjera. Ashtusi në leximin e parë, ne i përgatisim fëmijët t’upërgjigjen pyetjeve analitike së pari duke i modeluar komentet analitike të cilat i bëjnë disa, por jo të gjitha, informata të drejtpërdrejta e që është e nevojshme për t’iu përgjigjur pyetjeve në mënyrën e përshtatshme. Sikur gjatë leximeve të para, edhe leximet e dyta i përfundojmë duke parashtruar ndonjë pyetje tjetër shpjeguese. Ndonjëherë i pyesim fëmijët në lidhje me diçka që do të mund të ndodhte përtej tregimit.

Leximi i tretë me zë

Leximet e treta ndodhin disa ditë pas leximit të dytë, kur tregimi është ende i freskët në mendjet e fëmijëve por edhe kur ata duhet t’i mbajnë mend informatat edhe pse ka kaluar një kohë. Kjo përsëritje përmbyllëse është e rëndësishme edhe për shkak se përforcon fjalorin e zhvilluar me kujdes gjatë leximit të parë dhe të dytë. Leximet e treta me zë dhe ndëraktive dallojnë nga leximet e para dhe të dyta me zë për shkak se përfshijnë rindërtim të udhëhequr të tregimit ku mësimdhënësi lexon disa pjesë të tekstit të tregimit. Rindërtimet janë ritregime

të ngjarjeve të tregimit së bashku me shpjegime në lidhje me shkaktarët e atyre ngjarjeve dhe mendimet e personazheve në lidhje me ngjarjet. Prandaj, rindërtimet e udhëhequra janë më efektive se thjesht ritregimet sepse fëmijët përdorin bisedë analitike për të shpjeguar pse kanë ndodhur ngjarjet.

Gjatë prezantimit të librit në leximet e treta me zë, ne e theksojmë sërish që fëmijët e kanë të njohur librin dhe përmbajtjen e tij dhe parashtrijmë pyetje në lidhje me titullin dhe personazhet, si “Ne e kemi lexuar këtë libër dy herë më parë, dhe unë e di se ju e dini titullin e tij. Cili është?” Ne zakonisht i lejojmë fëmijët të përgjigjen së bashku në këtë pyetje të lehtë. Ne mund të vazhdojmë t’i ndihmojmë fëmijët të rindërtojnë informata duke pyetur, “Cilat detaje të tjera shohim në ballinë, të cilat e dimë se janë të rëndësishme për tregimin?” (p.sh. udhëzimi i fëmijëve t’i vërejnë duajt e kashtës në ballinë të Heni Peni). Vazhdojmë të përqendrohemi në ngjarjen e tregimit duke pyetur, “Të gjithë e mbajmë mend problemin e Heni Peni, a po? Kush dëshiron të na tregojë për të?” Ne jemi shumë të kujdesshëm me numrin e pyetjeve që parashtrijmë gjatë prezantimit të librit dhe gjatë rindërtimit të udhëhequr. E kemi kuptuar se leximet e treta me zë bëhen shumë të mërzitshme kur mësimitdhënësit i ngarkojnë nxënësit me shumë pyetje.

Ne përdorim dy ide të përgjithshme gjatë udhëzimit të rindërtimit të tekstit. Para leximit të disa faqeve të tregimit, theksojmë ilustrimet dhe pyesim, “Çfarëpo ndodh këtu?” Këtë ide e përdorim përdërisa tregojmë ilustrimin dyfaqësh. Ndonjëherë përdorim pyetjen e dytë “A e mbani mend çka do të ndodhë në vijim?” para se ta kthejmë ilustrimin e ardhshëm. Këtë pyetje e përdorim vetëm kur ngjarja e ardhshme ndërlihet si shkak i ngjarjes të cilën fëmijët sapo e kanë rikujtuar. Pasi që fëmijët i rindërtojnë ngjarjet në një dyfaqësh, ne lexojmë tekstin. Në librat më të gjatë, ne rilexojmë më shumë faqe të tekstit dhe kërkojmë nga fëmijët t’i rindërtojnë vetëm disa faqe; në librat më të shkurtër u lejojmë fëmijëve të rindërtojnë më shumë pjesë të tregimit dhe lexojmë vetëm disa faqe të tekstit. Gjatësia e librit dhe përgjigjet e fëmijëve udhëheqin vendimet tona nëse do të lexojmë më shumë apo do t’i angazhojmë fëmijët të rindërtojnë më shumë.

Gjatë leximeve të treta, mësimitdhënësit vazhdojnë të shtojnë shpjegime verbale të fjalëve, theksojnë ilustrimet dhe bëjnë gjeste dramatike. Për ta theksuar fjalorin më tej në leximin e tretë, mësimitdhënësit zgjerojnë kuptimet e disa fjalëve në një kontekst të njohur por jo në atë të përfshirë në tregim. Kështu që, secila ditë e leximeve me zë në mënyrë ndëraktive dhe të përsëritur ndërton dhe zgjeron në mënyrë sistematike vetëdijen dhe të kuptuarit e fëmijëve për fjalorin. Tabela 1 prezanton një pasqyrë të komponentëve për tre ditët e leximit me zë ndëraktiv dhe të përsëritur.

Shënime:

Tabela 1. Komponentët e leximeve ndëraktive dhe të përsëritura me zë

	Leximi i parë me zë	Leximi i dytë me zë	Leximi i tretë me zë: Rindërtimi i udhëzuar
Prezantimi i librit	Me anë të disa fjalive prezantoni personazhin kryesor dhe problemin qendror. Përdorni ilustrimet në ballinën e librit, faqen e fundit dhe faqen e titullit nëse ka nevojë.	Ua rikujtoni fëmijëve se ata i njohin personazhet dhe disa gjëra që bën secili personazh. Parashtroni pyetje në lidhje me personazhet dhe problemin.	Ftoni fëmijët ta identifikojnë problemin dhe ta shpjegojnë zgjidhjen. Kërkoni nga fëmijët ta rikujtojnë titullin e librit.
Leximi i librit	Shtoni sqarime për 5-10 fjalë të fjalorit duke theksuar ilustrimet, bëni gjeste dramatike, apo shtoni disa definicione. Bëni komente të cilat zbulojnë atë që mendon apo ndjen personazhi kryesor. Parashtroni disa pyetje pasuese analitike duke u bazuar në komentet e juaja.	Shtoni sqarime për fjalorin e njëjtë, duke përfshirë më shumë definicione verbale. Bëni komente të cilat zbulojnë atë që mendojnë apo ndjejnë personazhet tjera. Parashtroni më shumë pyetje pasuese analitike.	Para leximit të një dyfaqëshi, tregojeni ilustrimin dhe pyetni, "Çka po ndodh këtu?" Përcillni komentet e fëmijëve duke i zgjeruar komentet apo duke kërkuar sqarime. Lexoni disa faqe të tekstit. Kur e shihni të përshtatshme, para se ta ktheni faqen tjetër, pyetni, "Kush e mban mend çka do të ndodhë në vijim?" Tërhiqeni vëmendjen te disa fjalë të fjalorit në kontekste të ndryshme.
Diskutimi pas leximit	Parashtroni pyetjet "pse" të cilat kërkojnë shpjegim. Përdorni pyetjet pasuese për t'i ndihmuar të përgjigjen. Demonstroni si të përgjigjen në pyetje duke thënë, "Unë mendoj ..."	Parashtroni një pyetje tjetër "pse" dhe pyetni, "Çka do të ndodhte sikur...?" Përdorni pyetjet pasuese për ta orientuar të menduarit e fëmijëve.	Parashtroni një pyetje tjetër "pse" dhe pyesni, "Çka do të ndodhte nëse ...?"

Gjatë tre ditëve të leximit të librit të njëjtë, strategjitë e përdorura në leximet me zë në mënyrë ndëraktive dhe të përsëritur u ofrojnë fëmijëve mundësi të angazhohen në mënyrë më aktive në përvojën e leximit. Gjatë leximit të parë, mësimitdhënësit marrin rol më aktiv duke e lexuar tekstin dhe duke bërë komente; fëmijët dëgjojnë në mënyrë aktive dhe ndonjëherë komentojnë apo u përgjigjen pyetjeve. Gjatë leximit të dytë, fëmijët marrin pjesë më shpesh në mënyrë më verbale duke iu përgjigjur pyetjeve dhe komenteve. Gjatë leximit të tretë, fëmijët marrin rol më aktiv pasi që e rindërtojnë tregimin me udhëzimet e mësimitdhënësit.

Parashtrimi i pyetjeve të mira

Një nga mënyrat më të mira për ta nxitur dëgjim-kuptimin është parashtrimi i pyetjeve gjatë leximit para fëmijëve.

Fëmijët duhet të jenë në gjendje, që në kopsht dhe klasë të parë, që t'u përgjigjen pyetjeve të thjeshta duke u bazuar në nxjerrjen e informatave, si p.sh. "Si quhej vajza?" por edhe pyetjeve të nivelit më të lartë, si p.sh. "Pse mendon se ajo shkoi në pyll?" dhe "A mendon se kjo ishte ide e mirë?" Pyetjet e nivelit më të lartë mund të ndihmojnë në zhvillimin e shkathtësive të tëmenduuarit të nivelit më të lartë dhe janë gjithashtu motivues i fuqishëm. Fakti që mund të kenë përgjigje në më shumë se një nivel, apo të mos e japin përgjigjen e saktë gjithashtu nënkupton se pyetje të tilla janë shumë të dobishme për nxitjen e diskutimit.

Pyetjet e mira kërkojnë më shumë se sa thjesht rikujtimin e një fakti apo riprodhimine një shkathtësie. Nxënësi duhet të mësojë duke iu përgjigjur pyetjeve tuaja dhe ju duhet të mësoni për nivelin e të kuptuarit të nxënësve tuaj duke u bazuar në përgjigjet e tyre. Përderisa nxënësit u përgjigjen këtyre pyetjeve, shënoni përgjigjet e tyre në fletore. Më vonë, rishikoni shënimet tuaja për të parë se cilët fëmijë kanë demonstruar shkathtësi të forta të dëgjim-kuptimit duke iu përgjigjur saktë pyetjeve.

Por duhet të jeni të durueshëm. Shumica e nxënësve kur u përgjigjen pyetjeve sfiduese kanë nevojë për kohë që t'i përpunojnë mendimet e tyre dhe të fitojnë guxim për ta ngritur dorën. Nëse gjithnjë i ftoni ata që ngrenë dorën të parët, jo vetëm që do të demotivoni shumicën e nxënësve, të cilët kanë nevojë për më shumë kohë të mendojnë, por edhe do t'i mohoni vetes marrjen e informatave të dobishme për të nxënët e shumicës. Nëse u tregoni nxënësve që jeni të gatshëm të prisni dhe t'u jepnikohë të mendojnë në lidhje me pyetjen para se të përgjigjen, do të shpërbleheni me përgjigje më të mira, madje edhe nga nxënësit prej të cilëve nuk keni pritur përgjigje.

Një shembull i tekstit me pyetje të disa niveleve është dhënë në fund të manualit. Shikojeni tekstin dhe pyetjet, dhe mendoni se si mund t'i përdorni në mësimdhënien tuaj.

Një strategji e mirë është të fillohet duke e lexuar tekstin dhe duke parashtruar disa pyetje faktike, qëllimi kryesor i të cilave është të përforcohet të dëgjuarit dhe të kuptuarit e fëmijëve. Shfrytëzoni përgjigjet e nxënësve për t'u siguruar që të gjithë nxënësit i kanë kuptuar informatat themelore të cilat janë të thëna në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst. Pastaj mund të kaloni në pyetjet e nivelit më të lartë. Në këtë fazë, do t'ju duhet ta keni parasysh se këto lloj pyetjesh mund të mos kenë përgjigje të saktë apo të gabuar. Kështu që mund t'i përdorni për të parashtruar pyetje pasuese. Për shembull, nëse merrni një përgjigje në lidhje me një pyetje për zgjidhjen e problemit e cila nuk është e plotë, në vend që t'ia thoni nxënësit përgjigjen e plotë, ju mund të kërkonte nga një apo më shumë nxënës të tjerë të tregojnë nëse pajtohen me përgjigjen dhe të kërkonte prej tyre që ta zgjerojnë përgjigjen origjinale. Gjithashtu, mund të kërkonte që ata t'ju tregojnë pse mendojnë se përgjigjja duhet të plotësohet. Kur parashtroni pyetje të cilat përfshijnë të menduar kreativ, mos harroni se në këtë rast nuk ka përgjigje të saktë; kërkonte nga disa nxënës të japin këndvështrime të ndryshme dhe nxitni diskutimin.

Në vijim janë disa shembuj të niveleve të ndryshme të pyetjeve të cilat mund t'i parashtroni për t'i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë shkathtësi të mira të dëgjim-kuptimit. Ato janë të bazuara në përrallën "Kësulëkuqja".

Pyetjet faktike

- Ku ishte duke shkuar Kësulëkuqja?
- Kë do ta vizitonte Kësulëkuqja?
- Çka mori me vete Kësulëkuqja?

- Kush e kishte veshur këmishën e natës së gjyshes?
- Kush e shpëtoi Kësulëkuqen dhe gjyshen?

Pyetjet për zgjidhjen e problemave

- Çka bëri Kësulëkuqja që nuk duhet ta bënte?
- Pse e veshi ujku këmishën e natës së gjyshes?

Pyetjet e të menduarit kritik

- Çka do të bënit ju po të ishit Kësulëkuqja?
- Çka do t'i dërgonit ju gjyshes? Pse?
- Po të ishit ju autori, atëherë si do ta përfundonit përrallën Kësulëkuqja?

Parashtrimi i pyetjeve para, gjatë dhe pas leximit

Shumica e mësimdhënësve u parashtrojnë nxënësve pyetje pasi e kanë lexuar tekstin; por hulumtimet tregojnë se lexuesit e shkathëti parashtrojnë vetes pyetje para, gjatë dhe pas leximit.

Leximi i suksesshëm nuk është vetëm proces mekanik i “deshifrimit” të tekstit. Lexuesit e rritur dhe të shkathët e zgjedhin atë që lexojnë. Para se të fillojnë, ata e dinë pse janë duke e lexuar atë tekst; kështu që kanë një plan për atë që dëshirojnë nga teksti dhe si ta marrin atë. Nëse është tregim, mund të kenë pritshmëri, apo të parashikojnë në lidhje me ngjarjen apo personazhet.

Përderisa janë duke lexuar, lexuesit e aftë do të zhvillojnë pyetje të reja, për shembull:

“Për çka bëhet fjalë në këtë tregim?”

“Çka dëshiron personazhi kryesor?”

“A do ta marrë ajo?” “Nëse po, si?”

Ata gjithashtu do të mundohen ta mësojnë kuptimin e fjalëve të panjohura nga konteksti, dhe në përgjithësi t'i saktësojnë parashikimet dhe pritshmëritë e tyre.

Dhe në fund, pas leximit, ata do t'i rishikojnë pikat e rëndësishme në tekst, për t'u siguruar se i kanë kuptuar, do t'i analizojnë dhe vlerësojnë idetë dhe supozimet, do të formojnë një interpretim, vlerësim dhe cilësi për tekstin, dhe do ta mendojnë se si mund ta përdorin në të ardhmen informatën që është në tekst. Ata mund të parashtrojnë pyetje si në vijim:

- “Cili është kuptimi i asaj që lexova?”
- “Pse e përfundoi autori paragrafin (apo kapitullin, apo librin) në këtë mënyrë?”
- “Cila ishte arsyeja e autorit për shkrimin e kësaj?”

Ndihmoni nxënësit të parashtrojnë pyetje dhe të bëhen lexues reflektues

Në mënyrë që t'indihmoni nxënësit të bëhen më të aftë në këtë proces, mund të filloni t'i modeloni këto lloj pyetjesh gjatë leximeve me zë, duke e thënë me zë atë që jeni duke menduar dhe duke pyetur veten. Lexoni para klasës një libër apo tekst, dhe modeloni të menduarit dhe të pyeturit tuaj. Theksoni se edhe pse ju jeni lexues i rritur, pyetjet para, gjatë dhe pas leximit vazhdojnë të ju ndihmojnë ta kuptoni tekstin që jeni duke lexuar.

Lexuesit e mirë i parashtrojnë vetes pyetje në lidhje me atë që lexojnë. Ata janë 'lexues reflektues'.

Tregojuni nxënësve se si titulli dhe ilustrimi në ballinë nxisin pyetje në mendjen tuaj. Parashtroni pyetjet si në vijim:

- «Çfarë ideje më jep titulli në lidhje me tregimin?»
- «A është ky tregim real apo imagjinar?»
- «Pse po e lexoj këtë?»
- «Çka di tashmë për ___?»
- «Çfarë parashikimesh mund të bëj?»

Kërkoni nga nxënësit t'i ndajnë pyetjet për të cilat po mendojnë para se të filloni të lexoni.

Zgjedh paraprakisht disa pika ndalese në kuadër të tekstit për të parashtruar pyetje dhe për t'iu përgjigjur atyre. Ndalesat nuk duhet të jenë aq të shpeshta sa ta pengojnë kuptimin apo leximin e rrjedhshëm të tekstit. Kjo është gjithashtu kohë e përkryer për të modeluar strategjitë për saktësimin e keqkuptimeve. Filloni ta lexoni tekstin dhe parashtroni vetes pyetje përderisa lexoni:

- "Çka kuptova nga ajo që sapo lexova?"
- "Cila është ideja kryesore?"
- "Çfarë pamjesh është duke krijuar autori në mendjen time?"
- "A kam nevojë ta ri-lexoj që ta kuptoj?"

Inkurajoni nxënësit t'i parashtrorjnë pyetjet e tyre përderisa është duke u lexuar teksti.

Pastaj ri-lexoni tekstin, duke parashtruar pyetjet në vijim pasi të përfundoni:

- «Cilat nga parashikimet mia ishin të sakta? Cila informatë nga teksti më tregon se e kam pasur saktë?»
- «Cilat ishin idetë kryesore?»
- «Çfarë lidhje mund të bëj me tekstin? Si ndihem në lidhje me to?»

Rishikoni se disa nga përgjigjet pyetjeve mund të gjenden në tekst apo të nënkuptohen nga teksti dhe disa përgjigje nevojitet të vijnë nga burime të jashtme apo madje edhe nuk mund të gjenden përgjigje për to.

Inkurajoni nxënësit t'i parashtrorjnë pyetjet e tyre pasi që e keni modeluar këtë strategji, për të parashtruar pyetje dhe për tu përgjigjur në pyetjet e tjetrit në grup, si dhe të gjenerorjnë pyetje të reja duke u bazuar në diskutimet në grup. Sigurohuni të fokusoheni jo vetëm në gjetjen e përgjigjeve të sakta, por edhe në kërkimin, hamendësimin dhe parashtrimin të pyetjeve të menduara mirë.

Përderisa nxënësit e lexojnë tekstin në mënyrë të pavarur, ju duhet të vazhdoni ta modeloni procesin e të pyeturit dhe t'i inkurajoni nxënësit ta përdorin shpesh atë.

Pyetje për t'i parashtruar para leximit

Qëllimi: Aktivizimi i njohurive të përgjithshme dhe specifike për temën, hulumtimi i organizimit apo strukturës së tekstit, përcaktimi i qëllimit për lexim, parashikimi i përmbajtjes së tekstit

- Cili është titulli i librit?
- Çka të tregon titulli/nëntitulli?
- Çfarë lloj shkrimi është ky? Trillim? Real? Poezi?
- Pse po e lexon këtë libër?

- Çka të tregon ballina për librin?
- Për çka mendon se flitet në libër?
- Çka di tashmë në lidhje me temën e librit?
- Çka dëshiron të zbulosh?
- Çfarë informatash shpreson të gjesh?
- A ke lexuar pjesë të tjera të shkruara nga ky autor? Çfarë di në lidhje me punën e këtij autori?
- Pse mendon se autori e shkroi këtë pjesë?

Pyetjet për t'i parashtruar gjatë leximit

Qëllimi: monitorimi i nivelit të të kuptuarit; vizualizimi; përmbledhja; konfirmimi/refuzimi i parashikimeve; identifikimi dhe qartësimi i ideve thelbësore

- Çka mendon se do të ndodh në vijim?
- Cili është problemi në këtë libër?
- Pse mendon se personazhi veprimi ashtu?
- Kur e lexove këtë pjesë, çfarë pamjesh krijoje në mendjen tënde?
- A mund t'i përmbledhësh idetë kryesore nga paragrafi që sapo lexove?
- A ke nevojë ta ri-lexosh këtë paragraf për të kuptuar çka është duke thënë autori?
- Çfarë pamjeje mund të vizualizosh duke shfrytëzuar detajet e tekstit për të zhvilluar të kuptuarit?
- A ka fjalë të panjohura? A do të ndihmojnë idetë nga teksti për t'i kuptuar fjalët e panjohura? A ke nevojë të ndalesh dhe ta konsultosh fjalorin? A është e domosdoshme ta dish atë fjalë për t'i kuptuar idetë kryesore të tekstit? Apo mund të vazhdosh të lexosh?

Pyetjet për t'i parashtruar pas leximit

Qëllimi: identifikimi i ideve dhe detajeve kryesore; përgjigja; bërja e lidhjeve; zgjerimi i të kuptuarit, analizimi dhe vlerësimi i ideve, vlerësimi nëse qëllimi i leximit është arritur

- Përshkruaj skenarin e tregimit.
- Përshkruaj si ndryshoi personazhi gjatë librit.
- Cilat personazhe të pëlqyen më së shumti? Pse?
- Cilat ishin disa nga problemet apo situatat me të cilat u ballafaquan personazhet?
- Trego për pjesën që të pëlqeu apo nuk të pëlqeu dhe pse?
- Për cilat pyetje para-leximit gjete përgjigje?
- Cilat parashikime para leximit u konfirmuan, cilat u rishikuan?
- Cila është tema e përgjithshme e këtij libri?
- Cilat janë idetë kryesore të këtij libri?
- Çfarë përgjithësime mund të bëhen duke i shfrytëzuar detajet e librit?
- Cilat përfundime mund të nxirren nga libri?
- Cilat raporte shkak-pasojë u paraqitën?
- Cilat lidhje i ke bërë në lidhje me këtë libër?
- A do t'ua rekomandoje këtë libër lexuesve tjerë? Pse do t'ua rekomandoje ose pse nuk do t'ua rekomandoje?

8.2 Leximet e përbashkëta

"Leximi i përbashkët është aktivitet mësimor bashkëpunues ... që imiton dhe zgjeron përvojën e fëmijëve me tregimet para gjumit.»

Ndihmojnë zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit
- Vizualizimit

Prandaj, qëllimi kryesor i leximeve të përbashkëta është t'u ofrojë fëmijëve përvojë të këndshme, t'u prezantojë shumëllojshmëri të autorëve, ilustruesvedhe llojeve të teksteve për t'i nxiturtë bëhen lexues. Qëllimi i dytë, po aq i rëndësishëm, është t'ua mësojë fëmijëve procesin e leximit dhe si të bëhen vetë lexues dhe shkrimtarë.

Teksti gjithnjë zgjidhet nga mësuesja dhe duhet të jetë i dukshëm për nxënësit. Kur lexohet nga teksti shkollor, nxënësit mund ta kenë kopjen e vet para vetes. Nëse mësuesja ka disa kopje të një libri, nxënësit mund t'i ndajnë së bashku. Nëse keni kompjuterë apo tabletë, nxënësit mund të lexojnë nga ekrani. Përderisa mësuesja e lexon tregimin me zë, të gjithë fëmijët mund ta shohin dhe ta vlerësojnë shkrimin dhe ilustrimet. Mësuesja mund të përdorë libra me madhësi të madhe (libra të mëdhenj) me shkronja dhe ilustrime të mëdha.

Leximi i përbashkët, në mënyrë tradicionale bëhet përmes materialeve të shtypura, por tani ka edhe burime elektronike. Për shembull, mësuesja mund t'i projektojë faqet nga kompjuteri në ekran. Librat mund të shkarkohen nga "Arka e Thesarit" online në <http://sq.bep-ks.org/thesari/>.

Leximi i përbashkët ofron mjedis të sigurt mësimor për nxënësit për t'i ushtruar sjelljet e lexuesve të mirë me përkrahje nga mësuesja dhe moshatarët. Që në fazat e para të programit të leximit mund të përdoret literaturë e pasur, origjinale dhe interesante për fëmijë, shkathtësitë e të cilëve për identifikimin e fjalëve nuk do t'i lejonin të kishinqasje në këtë literaturë cilësore. Nxënësit

kanë mundësi që gradualisht të marrin më shumë përgjegjësi për lexim përderisa rriten niveli i shkathtësive të tyre dhe vetëbesimi. Leximi i përbashkët i teksteve parashikuese:

- ofron mundësi që mësuesja ta modelojë leximin për nxënësit;
- zhvillon vetëdijen e funksioneve të shkronjave, njoftimin me modelet e gjuhës dhe shkathtësitë e njohjes së fjalëve përmes ndërveprimit të përsëritur me të njëjtin tekst;
- ofron mundësi për zgjerim të koncepteve dhe gjuhës që nuk do të ndodhte me tekstet të cilat nxënësit mund t'i lexojnë në mënyrë të pavarur;
- mund ta zhvillojë njohurinë e fjalëve fotografike dhe rrjedhshmërinë;
- u lejon nxënësve të ndryshëm të përjetojnë sukses së bashku me lexuesit e rrjedhshëm të cilët sfidohen nga gjuha interesante dhe e natyrshme, përderisa mësuesja përkrah nxënësit të cilët i fitojnë shkathtësitë e leximit më ngadalë;
- u ndihmon të gjithë nxënësve të ndihen të suksesshëm duke ofruar përkrahje për tërë grupin;
- u ofron përkrahjen e nevojshme lexuesve me vështirësi; dhe
- u lejon nxënësve të kënaqen me materialet të cilat nuk mund t'i lexojnë vetëm

Tregime online të lexuara nga të rriturit janë në dispozicion për mësuesit në “Arkën e Thesarit” në <http://sq.bep-ks.org/thesari/>. Fëmijët të cilët hezitojnë të lexojnë apo të cilët kanë rrjedhshmëri të dobët mund ta dëgjojnë tekstin të lexuar me zë përderisa i përcjellin fjalët në të. Dëgjimi i leximit të librit me zë e rrit të kuptuarit e tyre për tekste specifike por shërben edhe si model i rrjedhshmërisë për lexuesit.



“Ka shumë vitamina” - tha Tami

“Më duhet forcë” - tha Pepa

8.3 Librat e nivelizuar

Basic Education Program i USAID-it ka zhvilluar një set librash të rinj tërheqës dhe interesantë për lexuesit fillestarë. Ai ka publikuar 20 libra për lexim sipas klasave, secili me nga 16 faqe, të bazuar në tregime dhe personazhe që motivojnë nxënësit dhe u mundësojnë atyre të lexojnë dhe të kuptojnë që nga mosha e hershme.

Publiku i synuar për librat me tregime janë fëmijët e klasave I dhe II. Tregimet përdorin fjalor të kufizuar dhe të përshtatshëm për moshën e fëmijëve. Ekspertët e Programit kanë zhvilluar listat përkatëse të fjalëve. Librat do të zhvillojnë fjalorin e fjalëve fotografike të lexuesve fillestarë përmes njohjes së fjalëve dhe do ta përmirësojnë rrjedhshmërinë dhe shkathhtësitë e të kuptuarit. Librat janë të ndarë në katër nivele, ku secili nivel ka nga pesë libra. Secili libër përmban 16 faqe, secila me ilustrime.

Tregimet përmbajnë personazhe reale dhe të njohura në kontekste dhe situata të ndryshme. Personazhet kryesore janë fëmijë bashkëkohorë, si nga tiparet fizike dhe karakteri i secilit ashtu edhe nga interesat, dëshirat dhe ëndrrat.

Secili libër përmban një pjesë hyrëse me udhëzime si të lexohet libri; dhe pyetje të cilat duhet të parashtrihen para, gjatë dhe pas leximit.

PARA LEXIMIT

- Lexoni titullin së bashku
- Bëni pyetje në lidhje me kontekstin e tregimit
- Bisedoni për ilustrimet.

Disa fjalë mund të jenë më sfiduese për t'u lexuar. Inkurajoni fëmijën t'i lexojë ato apo lexojini së bashku.

GJATË LEXIMIT

Nëse fëmija ka nevojë për përkrahje gjatë leximit të fjalëve:

- Kërkoni nga fëmijët t'i përcjellin fjalët nga e majta në të djathtë përderisa lexojnë
- Modeloni leximin e fjalëve të vështira duke i ndarë në rrokje
- Përdorni ilustrimet për të biseduar në lidhje me tregimet dhe mësoni kuptimin e fjalëve të reja.

PAS LEXIMIT

Bëni pyetje në lidhje me personazhet dhe motivin e tyre
Diskutoni veprimet dhe pyesni: Çka do të bënit ju?

Ndihmojnë zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimin



8.4 Mini-librat


Basic Education Program i USAID-it, në kuadër të përpjekjeve të veta për të përmirësuar shkathtësitë e leximit të nxënësve të Kosovës, ka krijuar 25 “mini-libra” për fëmijë të klasave I dhe II të cilët do t’i angazhojnë lexuesit e rinj, si dhe do t’i përforcojnë shkathtësitë e tyre të leximit. Mini-librat janë printuar në dy anët e fletëve A4 të cilat mund të priten, palosen dhe të lidhen për të bërë një libër të vogël prej 8 faqesh. Ato janë të lehta për tu krijuare lexuar, dhe synojnë të zhvillojnë vetëbesimin e fëmijëve si lexues dhe t’i ndihmojnë ata për të rritur rrjedhshmërinë. Ilustrimet janë bardh e zi, kështu që nxënësit mund t’i ngjyrosin dhe t’i bëjnë të vetat. Ato janë të dizajnuara për tu fotokopjuar dhe mund të shkarkohen nga “Arka e Thesarit” online në www.bep-ks.org. Librat përfshijnë tema të njohura si ‘stinët’, ‘pesë ndjenjat’ dhe ‘çdo gjë rreth meje’. Përderisa teksti ndonjëherë është sfidues për lexuesit fillestarë, librat përmbajnë gjuhë të përsëritur e cila shpesh herë rimon dhe përcjell modele të parashikueshme. Ilustrimet e secilit libër e përkrahin tekstin për t’i ndihmuar lexuesite vegjël t’i dekodojnë fjalët.

Ndihmojnë zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit

Si t’i krijoni mini-librat

1. Shkarko dhe printo faqet në të dy anët. Ndoshta do të keni nevojë të eksperimentoni pak deri sa të siguroheni që faqet janë të printuara mirë dhe që faqja e dytë është e dukshme pas ballinës.
2. Preje faqen në gjysmë përgjatë vijës së theksuar
3. Vendose faqen numër 3 pas faqes së ballinës
4. Palose faqen përgjysmë përgjatë vijës së ndërprerë
5. Kontrolllo për t’u siguruar se faqet janë në radhëne duhur dhe pastaj lidhi, qepi apo ngjiti së bashku.
6. Inkurajoni nxënësit t’i ngjyrosin ilustrimet para apo pasi ta lexojnë tekstin.



Përderisa disa fëmijë i ngjyrosin vizatimet, përdore këtë kohë për të dëgjuar disa lexues individualë. Përdor të njëjtën teknikë si me librat për lexim sipas klasave:

PARA LEXIMIT

- Lexoni titullin së bashku
- Bëni pyetje në lidhje me kontekstin e tregimit
- Bisedoni për ilustrimet.



Disa fjalë mund të jenë më sfiduese për t’u lexuar. Inkurajoni fëmijën t’i lexojë ata, ose lexojini së bashku.

GJATË LEXIMIT

Nëse fëmija ka nevojë për përkrahje gjatë leximit të fjalëve:

- Kërkoni nga fëmijët t’i përcjellin fjalët nga e majta në të djathtë përderisa lexojnë

- Modeloni leximin e fjalëve të vështira duke i ndarë në rrokje
- Përdorni ilustrimet për të biseduar në lidhje me tregimet dhe mësoni kuptimin e fjalëve të reja.

PAS LEXIMIT

Bëni pyetje në lidhje me personazhet dhe motivin e tyre

Diskutoni veprimet dhe pyetni: Çka do të bënit ju?

8.5 Leximi me zë i udhëzuar

Leximi me zë i udhëzuar është mjet i mrekullueshëm për përmirësimin e rrjedhshmërisë. Fëmijët përfitojnë nga kjo strategji në zhvillimin e shkathtësive të saktësisë dhe njohjes së fjalëve, e që janë dy komponentët e rrjedhshmërisë. Në këtë aktivitet, një i rritur punon një-me-një me një fëmijë. Fëmija e lexon tekstin me zë, që është në nivelin e tij të leximit të pavarur apo pak më lart se ai, së bashku me të rriturin i cili e udhëheq. Roli i të rriturit nuk është ta korrigojë leximin e fëmijës, por ta udhëheqë në zbatimin e strategjive të përshtatshme për kuptimin e tekstit. Për shembull, nëse lexuesi has në fjalë të panjohur, i rrituri mund ta nxisëtëpërdorë fonetikën për tëshqiptuar secilin tingull dhe pastaj t'i bashkojë për ta thënë fjalën e plotë. Në mënyrë të ngjashme, nëse fëmija lexon pa shprehje, i rrituri mund t'i parashtrijë pyetje në lidhje me emocionet që mund t'i ketë me fjalë të caktuara dhe ta ndihmojë t'i shprehë ato gjatë leximit me zë.

Ndihmojnë zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit

Leximi i përsëritur

Leximi i përsëritur bazohet në supozimin se kur "kërkohe vëmendje për dekodim të saktë, nuk mbetet shumë për të kuptuar atë që është lexuar". Përderisa rritet rrjedhshmëria, dekodimi dhe identifikimi i fjalëve bëhet më automatik. Nuk ka nevojë që vëmendja të përqendrohet më në dekodimin e fjalëve. Prandaj, nxënësit mund ta shfrytëzojnë vëmendjen e lirë në të kuptuarit e materialit të lexuar.

Leximet e përsëritura janë dëshmuar në rritjen e nivelit dhe saktësisë së leximit. Nxënësit i transferojnë shkathtësitë që i marrin në tekstet tjera.

Ofroji secilit nxënës material të zgjedhur leximi të nivelit të tij/saj. Përdor kopjen tënde për tëshënuar gabimet e nxënësit. Përcille këtë rutinë:

1. Mate leximin e nxënësit për një minutë. Shënoje fjalën e fundit që ka lexuar brenda një minute në kopjen tënde.
2. Ofro informatë kthyesë për nxënësin në lidhje me numrin e fjalëve që ka lexuar saktë brenda një minute, dhe diskuto gabimet në njohjen e fjalëve.
3. Mbay shënim në një tabelë (grafik) për fjalët të cilat nxënësi i ka lexuar saktë brenda një minute. (shih tabelën model).
4. Kërko nga nxënësi ta ushtrojë leximin e pjesës së tyre në mënyrë të pavarur apo me një partner.
5. Mate sërish kohën e nxënësit. Nxënësit mund të dëshirojnë të vazhdojnë të lexojnë deri sa e arrijnë qëllimin e numrit të fjalëve për një minutë të cilin e kanë përcaktuar për vete.

Leximi i përsëritur ndihmon lexuesit me vështirësi duke u ofruar atyre caqe të arritshme dhe afatshkurtra, si përfundimi i një pjese për kohë më të shpejtë (shpejtësia), rritja e numrit të fjalëve të lexuara saktë (saktësia) dhe leximi duke e kuptuar tekstin më mirë (të kuptuarit). Përvojat e mira të nxënësve në lexime të përsëritura zhvillojnë vetëbesimin e tyre, dhe i inkurajojnë të investojnë më shumë kohë dhe të përpiqen më shumë për arritjen e shkathtësisë së rrjedhshmërisë.

Në mënyrë që të nxiten leximet e përsëritura, kërko nga nxënësit t'i lexojnë një nxënësi që është në klasë më të ulët, ta regjistrojnë leximin e tyre, apo të përgatisin një version të Teatrit të Lexuesve për pjesën e zgjedhur.



8.6 Leximi me jehonë

Leximi me jehonë është një strategji e thjeshtë e leximit e cila u ndihmon lexuesve ta zhvillojnë rrjedhshmërinë, leximin me zë, fjalorin dhe të kuptuarit. Ju nevojitet një libër në nivelin e lexuesit dhe një nxënës për të jehuar.

Ndiq këtë rutinë:

1. Të gjithë lexuesit kanë nga një kopje të tekstit. Mësuesja apo lexuesi kryesor (që mund të jetë një nxënës) lexon një varg të tekstit. Sasia e leximit të pandërprerë varet nga mosha dhe niveli i aftësisë së nxënësve. Filloni me një fjali dhe pastaj shtoni kur të jeni të sigurt se nxënësit tuaj ndihen rehat.
2. Përderisa lexuesi lexon me zë, me shprehje dhe me shpejtësi të duhur, pjesa tjetër e grupit e përcjellin në tekst.
3. Pasi që lexuesi ta lexojnë fjali, të tjerët e lexojnë me zë. Ata duhet të mundohen ta imitojnë mënyrën si ka lexuar lexuesi kryesor gjatë aktivitetit të leximit me jehonë.

Leximi me jehonë përfshin mësimdhënësin apo lexuesin kryesor që modelon shkathtësitë të cilat janë të rëndësishme për një lexues të suksesshëm. Leximi me jehonë i ndihmon nxënësit të njohin fjalët e reja dhe të lexojnë me shpejtësinë e duhur e cila e lehtëson të kuptuarit.

Modifikime të Leximit me Jehonë

Aktivitetet e leximit me jehonë mund të mos funksionojnë njësoj për të gjithë nxënësit në çdo klasë. Në vijim janë disa modifikime të cilat u ndihmojnë lexuesve me vështirësi:

1. Përdor një libër të madh me një grup të vogël për ta praktikuar leximin me jehonë. Shumë libra të thjeshtë me ilustrime janë bërë libra të mëdhenj për t'u shfrytëzuar në klasë fillore apo në klasë përmirësuese. Në këtë rast, nxënësit nuk i kanë tekstet e tyre para vetes, por duhet të

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit

jenë në gjendje të shohin fjalët në librin e madh. Gjatë leximit me jehonë është me rëndësi që nxënësit të jenë në gjendje ta përcjellin tekstin në libër e jo vetëm t'i përsërisin fjalët që i thotë mësuesja.

2. Kur aftësitë e leximit të nxënësve përmirësohen, ata mund të bëhen lexues kryesorë të aktiviteteve të leximit me jehonë për nxënës të tjerë. Kjo ndihmon në ngritjen e vetëbesimit të tyre.
3. Edhe vjershat mund të shfrytëzohen për lexim me jehonë. Vjershat janë kryesisht të shkurtra dhe mund të kopjohen në një faqe, kështu që nxënësit mund ta kenë kopjen e tyre kur marrin pjesë në aktivitete të leximit me jehonë.

8.7 Leximi në dyshe

Leximi i përsëritur në dyshe përdoret për të përmirësuar shqiptimin dhe metrikën (dallimet në intonacion, theks dhe ritëm); leximi i përsëritur në dyshe përfshin edhe një masë të vetë-vlerësimit dhe vlerësimit të moshatarëve. Hulumtimet sugjerojnë se përdorimi i rregull i leximit të përsëritur në dyshe mund të përmirësojë ndjeshëm rrjedhshmërinë verbale dhe të kuptuarit.

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit

Nxënësit punojnë në dyshe. Të dy e kanë nga një fletë për regjistrim. Ndiq këtë rutinë:

1. Një nxënës zgjedh një pjesë për lexim që është në nivelin e tij të leximit të pavarur.
2. Partneri dëgjon me kujdes përderisa lexuesi e lexon pjesën "ftohtë". Pas leximit të pjesës, lexuesi vlerëson veten dhe e shënon atë vlerësim lidhur me leximin #1 në pjesën e sipërme të fletës për regjistrim; (dëgjuesi nuk shënon asgjë deri pas leximit të dytë)
3. Lexuesi e lexon sërish pjesën e njëjtë dhe sërish e vlerëson performancën e vet. Këtë herë edhe dëgjuesi shënon në fletën e vet, duke i shënuar pjesët ku partneri ka treguar përmirësim.
4. Leximi përsëritet për herë të tretë, ku të dy nxënësit mbajnë shënime në format e veta.
5. Pastaj ndërrojnë rolet dhe e përsërisin procesin.

Leximi në Kor

Leximi në kor është një aktivitet tjetër një-me-një i dobishëm për fëmijë. Në këtë aktivitet, lexuesit në dyshe ulen pranë njëri-tjetrit me një kopje të tekstit. Të dy e lexojnë tekstin me zë, ku i rrituri (apo lexuesi më i mirë) lexon pak më shpejt se tjetri. Përderisa dyshja lexon, i rrituri (apo lexuesi më i mirë) duhet t'i përcjellë fjalët në faqe me gisht për tandihmuar lexuesintjetër që ta përcjellë. Kjo e inkurajon fëmijën të përqendrohet tek fjalët në tekst.

8.8 Teatri i lexuesve

Teatri i lexuesve është një aktivitet i mrekullueshëm për punë me tërë klasën apo me një grup të vogël për të përmirësuar rrjedhshmërinë. Mund të përdoret çdo pjesë drame. Adaptime të librave, filmave, përrallave,

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit

ngjarjeve historike apo emisioneve të njohura TB mund të shkruhen për të krijuar prezantime të teatrit të lexuesve.

Qëllimi i teatrit të lexuesve është të rritet vetëbesimi në lexim duke ushtruar lexime të shumta të një teksti, e në këtë mënyrë përmirësohet të kuptuarit, rrjedhshmëria dhe saktësia. Nxënësit bëhen më të mirë në saktësi dhe e përmirësojnë rrjedhshmërinë përmes përsëritjes, si dhe bëjnë ushtrime të vlefshme duke lëvizur nga dekodimi i fjalëve të shkruara drejt tingujve dhe njohjes automatike dhe të rrjedhshme të fjalëve.

Në teatrin e lexuesve, lexuesi “performon” duke përdorur vetëm zërin e vet. Edhe pse shpesh herë hutohet me dramë apo aktrim, TL është krejtësisht ndryshe; nuk ka kostume, prova dhe më e rëndësishmja nuk ka memorizim. Në vend të kësaj, grupeve të nxënësve u jepet detyrë të lexojnë pjesë të ndryshme të skenarit. Nxënësve u caktohen role për të luajtur dhe u ofrohet mundësia për ta lexuar në heshtje disa herë skenarin. Ata e lexojnë atë me zë duke u fokusuar në rrjedhshmëri. Mësuesja duhet t’i udhëzojë nxënësit për ta përdorur shpejtësinë, shprehjen dhe frazimin e duhur.

Teatri i lexuesve është më i dobishëm kur skenari lexohet disa herë me zë sepse kjo i jep lexuesve mundësi të shumta për ta ushtruar leximin në mënyrë të rrjedhshme. Kjo strategji është veçanërisht e dobishme në zhvillimin e komponentit të metrikës në rrjedhshmëri.

Teatri i lexuesve mund të adaptohet për t’iu përshtatur mjediseve të ndryshme të të nxënësve.

Skenarët mund të dallojnë në gjatësi varësisht nga niveli i nxënësve tuaj, por një skenar i mirë do t’i ofronte secilit nxënës së paku dy ose tre rreshta për të lexuar. Rolet mund të përfshijnë disa personazhe, si edhe narratorin/tregimtarin i cili udhëheq tregimin. Lexuesit më të avancuar e më të guximshëm mund të zgjedhin pjesë më të mëdha, ndërsa lexuesit më të dobët apo më të tërhequr mund të zgjedhin më pak fjali.

Nëse grupi është i vogël, një skenar mund të ketë më shumë role se lexues. Në atë rast, mund t’i caktoni më shumë role një lexuesi, apo të kombinoni dy role në një. Nëse grupi është i madh, mund të caktoni më shumë se një narrator/tregimtar apo t’i ndani personazhet për të krijuar dy apo më shumë pjesë folëse. Mund të caktoni edhe personazhe të heshtura për të ndihmuar me tregimin apo të caktoni role që nuk flasin. Skenat e shumë personazhe mund të përfshijnë grupe të lexuesve shtesë.

Fëmijët mund të shkruajnë edhe tabela të tregimit dhe udhëzime për ta aktruar video-filmin.

Video-kamerat dhe telefonat mobilë mund të përdoren për të regjistruar leximin me zë të fëmijëve. Kjo u mundëson fëmijëve ta vetë-vlerësojnë performancën e tyre.

8.9 Leximi i pandërprerë në heshtje

Edhe pse mësuesit i japin vëmendjen kryesore përmirësimit të rrjedhshmërisë me zë përmes aktiviteteve me tërë klasën që bëhen me zë dhe në bashkëpunim, është me rëndësi të mos harrohet se leximi është detyrë individuale, e cila duhet të bëhet vetëm dhe në qetësi, si dhe për një kohë më të gjatë. Prandaj, është me rëndësi të ndahet koha për lexim individual të pandërprerë në heshtje, gjatë së cilës fëmijët kalojnë një kohë të caktuar duke lexuar tekste në heshtje të cilat i kanë zgjedhur vetë. Qëllimi i këtij aktiviteti është t'u ofrohet mundësia për tu angazhuar në lexime të këndshme dhe të pandërprera. Është me rëndësi që fëmijët të jenë të lirë të zgjedhin vetë atë që do të lexojnë gjatë këtij aktiviteti sepse zgjedhja e rrit motivimin dhe aftësinë për tu fokusuar. Gjithashtu është thelbësore që perioda e leximit të pandërprerë në heshtje (LPH) të jetë e papenguar, në mënyrë që të kenë kohë të ndërveprojnë me tekstin dhe të reflektojnë mbi të. Prindërve mund t'u kërkohet të kujdesen që fëmijët të lexojnë në shtëpi. Leximet e pandërprera me zë të këtilla duhet të plotësohen me diskutim të asaj që është lexuar – dhe sërish, prindërit duhet të inkurajohen për t'u angazhuar në diskutime me fëmijët e tyre në lidhje me atë që kanë lexuar.

Leximi i heshtur mund të ofrohet edhe si detyrë e rregullt shtëpie, duke përdorur ditarin e leximit për të regjistruar atë që nxënësit kanë lexuar çdo ditë së bashku me komente, kur është e përshtatshme. Nga prindërit mund të kërkoni t'i kontrollojnë shenjat e ditarëve të leximit të nxënësve.

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit



8.10 Gjëgjëza me zë

Kush jam unë – Mbaj një objekt në dorë apo pas shpine, në mënyrë të atillëqë objekti të mos shihet. Krijë një gjëgjëzë duke dhënë 2 ide: tingullin e parë dhe një informatë ndihmëse.

Për shembull: “Kam diçka që fillon me /gjggjgj/. Nuk ka këmbë dhe zvarritet në tokë.”

Ndihmon në zhvillimin e:

- Dëgjim-kuptimit
- Vetëdijes tingullore
- Fonetikës

Përqëndrimi - Siguro 5-10 objekte apo fotografi që fillojnë me të njëjtin tingull. Lejoji fëmijët t’i studiojnë objektet përderisa ju e mbani secilin objekt lart dhe thoni tingullin e parë të emrit të objektit apo fotografisë. (Pasi t’i prezantoni edhe tingujt e tjerë, mund t’i vendosni objektet me dy tinguj të ndryshëm në tavolinë). Mbulojni objektet me një material dhe largojeni një objekt me kujdes që fëmijët të mos e shohin. Largojeni materialin dhe kërkoni nga nxënësit t’i studiojnë objektet sërish. Ofroni ide nëse ka nevojë, një nga një deri sa fëmijët ta zbulojnë cili objekt po mungon. Shembull: “Fillon me /LLL/. Është i hollë e i gjatë. E përdorim për të shkruar.”

Cili është tingulli im? - Pasi t’i mësoni disa tinguj, provoni t’i vendosni 5 ose 6 objekte apo fotografi që fillojnë me të njëjtin tingull mbi tavolinë. Kërkoni nga fëmijët t’i studiojnë objektet dhe ta thonë emrin e secilit në mendje. “A po vëren ndokush diçka të veçantë në lidhje me këto objekte?” Nëse askush nuk vëren se të gjitha objektet fillojnë me të njëjtin tingull, pikasni te secili me radhë dhe thoni fjalën, duke theksuar tingullin e parë, e pastaj pyesni sërish.

Për shembull, nëse të gjitha objektet fillojnë me tingullin /t/. Ndihmohuni ta izoloni tingullin /t/. (Shqiptojeni qartë pa tinguj të tjerë pasues - mos e shqiptoni si tëhi, tëja, tuhi). Ftoni fëmijët të pikasin objekte tjera në dhomë të cilat fillojnë me /t/, apo ndonjë nxënëse emri i së cilës fillon me /t/. Tregojeni shkronjën “t” në tiketë të shkronjave.

Unë shoh - Vendos dy objekte apo fotografi me 4 apo 5 shkronja të prezantuara më parë. Thoni “Unë shoh me sytë e mi të vegjël diçka që fillon me /d/ dhe është i verdhë”. Apo “Unë shoh me sytë e mi të vegjël diçka që fillon me /gj/ dhe është i gjatë”. Mendo një karakteristikë që i dallon dy gjëra që kanë të njëjtin tingull fillestar. Bëje këtë ushtrim më efektiv duke e mbajtur lart apo duke pikasur në shkronjën përkatëse.”

Treni i Tingujve - Thuaj “Ja ku po vjen treni me tingullin /m/. Mund të hipni në trenin tim nëse e thoni një fjalë që fillon me /m/. ” (Mbajeni lart tiketën me shkronjën “m”). Fëmija thotë, “macja.” Mësuesja thotë, “Hip në tren.” Fëmija rreshtohet pas mësueses. Fëmija thotë, “mami.” Mësuesja thotë, “Hip në tren.” Jepni ide fëmijëve të cilët hasin në vështirësi. Pasi të hipin 5 apo 6 fëmijë në tren, thoni, “Whoooo, çaf, çuf, çaf, çuf.” Fëmijët e përcjellin lokomotivën përreth klasës. provoni sërish me një tren me tingull tjetër.

Gjarpri Gjin – Ky është Gjarpri Gjin. Atij i pëlqejnë gjërat që fillojnë me /gj/. Çka i pëlqen atij? Vizatoje Gjarprin Gjin në tabelë. Shëno nën tëtë gjitha gjërat që i thonë fëmijët të cilat fillojnë me /gj/. Nënvizë shkronjën e parë “gj” në secilën fjalë apo shkruaje me ngjyrë tjetër. Përsërite me personazhe të tjera për secilin tingull. Për shembull: Ariu Aldo, Qeni Qani, Kali Klod.

8.11 Ecim me fjali

Ndihmon në zhvillimin e:

- Dëgjim-kuptimit
- Vetëdijes tingullore
- Fonetikës

Ndarja e fjalive në fjalë

1. Udhëzoji nxënësit të bëjnë një hap për çdo fjalë në fjali. (p.sh. Macja është e zezë). Përsërite procesin me fjali të tjera. Kontrollloji fëmijët një nga njënjëse e kanë zotëruar.
2. Udhëzoji nxënësit ta thonë fjalinë e plotë dhe pastaj ta heqin nga një fjalë prej fundit të fjalisë deri sa të mbetet vetëm një fjalë.
3. Thuaje një fjali të plotë dhe pastaj kërko nga nxënësit ta përsërisin fjalinë duke u rënë shuplakave për secilën fjalë.
4. Secilit nxënës u ndahen fjalë të ndryshme nga mësuesja. Të ulur në karrige, nxënësit me radhë presin sinjalin për të thënë një fjalë në mënyrë që të krijojnë një fjali. Mësuesja së bashku me nxënësit vendosin për sinjalin që do të përdorin.



Ndarja e Fjalëve në Rrokje

5. Secili nxënës me radhë e thotë emrin e vet me rrokje. Ai/ajo mund tu bie shuplakave apo gishtërinjve për rrokjet në emrin e tyre.
6. Modelo ndarjen e fjalëve me dy rrokje duke filluar me të dy grushtet e mbyllur. Duke e theksuar secilën rrokje ktheje kokën dhe hapi shuplakat.
7. Nxënësit mund të bëjnë sajuese me rrokje. Jepni nxënësve fotografi të fjalëve dy-rrokëshe të ndarë në dy pjesë të sajuses. Ata duhet ta bashkojnë për ta bërë figurën të plotë. (Disa fjalë/fotografi mund të përfshijnë (shporta, pica, topi, hëna, molla, etj.)



8.12 Rimë dhe këngë

Pëshpërit rima: Recito një vjershë duke pëshpëritur dhe thuaji me zë të lartë fjalët që rimojnë.

Ndarja e rimave: Thuaje një vjershë në dy grupe. Grupi i parë e thotë fillimin e vargjeve ndërsa grupi i dytë i thotë fjalët me rimë.

Dëgjimi i rimave: Recitoje vjershën deri në fjalën e dytë që rimon. Pastaj ndalo dhe thuaj “Thoni dy fjalë që rimojnë.»

Kush s’e ka vendin: Thuaj tri fjalë nga vjersha dhe kërko “Thoni cilat janë dy fjalët që rimojnë.»

Unë shoh foto: Vendos disa fotografi në tabelën me xhepa dhe thuaj “Unë shoh diçka që rimon me ____.”

Bashko rimat: Ftoji nxënësit t’i zgjedhin dy fotografi nga shporta dhe t’i vendosin në tabelën me xhepa nëse rimojnë.

Hidh hapin: Thuaj dy fjalë. Nëse rimojnë, nxënësit ecin një hap para. Nxënësit që gabojnë ecin një hap prapa.

Rimat me jehonë mikrofon: Lexo një vjershë. Ndalo pas fjalës së dytë që rimon dhe thuaj “Tregomi dy fjalë që rimojnë. Tani mendo për një fjalë tjetër që rimon”. (Fjalët pa kuptim janë të pranueshme). Nxënësit përdorin mikrofonin me jehonë për tu përgjigjur.

Hedhja e topit që rimon: Hidhe një top dhe thuaje fjalën. Nxënësi tjetër e thotë një fjalë që rimon me fjalën e parë. Kur harxhohen idetë fillo prej fillimit me një fjalë tjetër.

Kap rimën: Merr një objekt. Thuaje emrin e objektit dhe kërko nga nxënësit të thonë fjalë të vërteta dhe pa kuptim të cilat rimojnë.

Libri me rimë: Kërko nga nxënësit të vizatojnë fjalë të cilat rimojnë dhe t’i përmbledhin në një libër të klasës.

Tregimete çmendura: Kërko nga nxënësit ta krijojnë një personazh kafshë emri i të cilit rimon – si *Lopa Bopadhe Kali Tali* – dhe pastaj diktoje një tregim të klasës. Ri-lexoje tregimin gjatë ditëve në vazhdim dhe kërko nga nxënësit të bashkohen në emrin e personazhit.

Ndihmon në zhvillimin e:

- Dëgjim-kuptimit
- Vetëdijes tingullore
- Fonetikës
- Lexim-kuptimit

8.13 Tiketatat dhe pllakat e alfabetit

Pllakat e alfabetit

Pllakat dhe tiketatat e shkronjave të vogla dhe të mëdha të alfabetit është lehtë për t'i krijuar, duke i printuar të gjitha shkronjat e alfabetit në katrorë në letër të trashë dhe duke i prerë.

Pllakat e alfabetit mund të përdoren në shumë aktivitete të dizajnuara për mësimdhënien e vetëdijes tingullore dhe korrespondencës tingull-shkronjë.

Për shembull:

Vendosi të gjitha pllakat me fytyrë lart

- Klasifikoji pllakat sipas atyre që janë në emrin tënd dhe atyre që nuk janë (apo, p.sh. në emrin e shoqes së klasës)
- Klasifikoji pllakat sipas radhës së alfabetit
- Vendosi emrat e shokëve të klasës sipas radhës së alfabetit
- Thuaji tingujt e shkronjave përderisa e klasifikon
- Gjej shkronjat që vijnë pas një shkronje të caktuar
- Trego nëse një shkronjë i takon gjysmës së parë apo të dytë të alfabetit; para apo pas një shkronje të caktuar.



Tiketatat me shkronja apo fjalë

Tiketatat mund të përdoren në shumë mënyra për mësimdhënien e fonetikës, si:

- Tiketatat e shkronjave për ndërtimin e fjalëve apo aktivitete që bashkojnë apo ndajnë fjalë
- Tiketatat me familje të fjalëve
- Tiketatat e fjalëve të shpeshta
- Tiketa me fjalë të lehta për dekodim.

Tiketatat me fjalë janë ideale për mësimin e fonetikës.



Teli për tharje

Krijo fjalë në telin për tharje duke përdorur tiketatat me shkronja.

Vendosi shkronjat të përziera dhe kërko nga nxënësit t'i vendosin ato në radhën e duhur.



8.14 Shkronjat dhe fjalët që mungojnë

Rrënjët dhe mbaresat e fjalëve

Krijto tiketa me rrënjë dhe mbaresa të ndryshme të fjalëve. Kërko nga nxënësit t'i bashkojnë ato.

Kërko nga nxënësit që një tiketë me rrënjë të fjalës ta bashkojnë me sa më shumë mbaresa që i takojnë asaj dhe formojnë fjalë me kuptim.

Për shembull:

	I
	IT
LAPS	IN
	A
	AVE
	AT

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fonetikës
- Rrjedhshmërisë
- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit

Gjeje fjalën

Në vijim janë paraqitur disa hapësira të zbrazëta

Loja është të qëllohen shkronjat në fjalë deri sa të identifikohet ajo. Nxënësit kanë deri në 10 raste për të qëlluar në mënyrë që të fitojnë.

Këto hapësira mund të vizatohen në tabelë nga mësuesja dhe nxënësit mund ta udhëheqin aktivitetin për tërë klasën, një grup apo në çifte. Kjo mund të bëhet edhe si garë në mes të grupeve - **kush i qëllon shumicën e fjalëve?**

Ushtrimet me zbrazëtira

Testi me zbrazëtira është një ushtrim, test apo vlerësim që përmban një pjesë të tekstit ku një numër i fjalëve është hequr, ndërsa nga nxënësit kërkohet t'i vendosin fjalët që mungojnë. Për shembull, mësuesja mund t'ua ofrojë nxënësve pjesën në vazhdim:

Sot shkova në _____ për të blerë qumësht dhe vezë. E dija se do të binte shi, por harrova të merrja _____ time dhe kështu u laga rrugës për në _____.

Nga nxënësit kërkohet t'i plotësojnë zbrazëtirat me fjalët që më së miri e kompletojnë pjesën e tekstit. Përmbajtja e fjalisë dhe kuptimi i fjalëve është thelbësor në testet me zbrazëtira. Para zbrazëtirës së parë është lidhëza "në", prandaj pasohet me një emër. Fjalët "qumësht" dhe "vezë" janë të rëndësishme për ta plotësuar zbrazëtinë; "shitore" është përgjigje e mundshme, edhe pse, varësisht nga nxënësi mund të përdoren edhe fjalët dyqan, shitore, apo treg ndërsa fjalët çadër apo xhaketë janë të përshtatshme për zbrazëtinë e dytë.

Ushtrimet me zbrazëtira mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë rrjedhshmërinë dhe të kuptuarit duke i inkurajuar të fokusohen në informata të gramatikës dhe të kontekstit.

8.15 Kategorizimi i koncepteve dhe fjalëve

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit

Klasifikimi i koncepteve dhe fjalëve është aktivitet i kategorizimit. Nxënësit klasifikojnë objektet, fotografitë dhe/apo fjalët sipas kuptimit të tyre. Ato përdoren për ta prezantuar apo përforcuar fjalorin, u ndihmojnë nxënësve t'i dallojnë raportet e zakonshme në mes të fjalëve, u mëson të mendojnë në mënyrë kritike në lidhje me termat dhe konceptet si dhe e zhvillon aftësinë e tyre për të bërë ndërlidhje të thella dhe me kuptim në mes të fjalëve dhe koncepteve. Ato gjithashtu e përforcojnë aftësinë e nxënësve për të logjikuar.

Kategorizimi i fjalëve përmes përdorimit të tiketave të fjalëve i përgatit nxënësit për lexim duke i ftuar të klasifikojnë fjalë të ndryshme të nxjerra nga teksti. Nxënësit duhet të jenë në gjendje ta identifikojnë çështjen apo temën kryesore dhe perspektivën e autorit për çështjen apo temën, duke i studiuar fjalët apo identifikuar frazat dhe duke i mbledhur në kategoritë fjalëve.



Ekzistojnë dy lloje të ndryshme të kategorizimit:

- **Kategorizimi i hapur:** nxënësit i grupojnë konceptet apo fjalët në çfarëdo grupimi që dëshirojnë përderisa mund ta shpjegojnë arsyen e grupimit dhe idenë pse secili koncept apo fjalë i takon atij grupi
- **Kategorizimi i mbyllur:** nxënësit i grupojnë konceptet apo fjalët në kategori të caktuara nga mësuesja; për shembull, mund t'iu kërkohet t'i grupojnë fjalët sipas pjesëve të fjalisë (emra, folje, ndajfolje) apo sipas koncepteve (liberale, konservatore). Kategorizimet e mbyllura të fjalëve sigurojnë një 'kornizë' për nxënësit gjatë angazhimit në aktivitete të kategorizimit të fjalëve.

Një alternativë e përdorimit të tekstit të plotë është përzgjedhja e 15 deri 30 fjalëve apo frazave nga një pjesë e tekstit të cilat mund të jenë të reja apo problematike për nxënësit

Procedura për kategorizimin e koncepteve

- Mblidhi nxënësit përreth një tavoline të madhe apo një tabele me xhepa.
- Zgjedh diçka për të klasifikuar. Për nxënësit e vegjël, përdor objekte apo fotografi. Për nxënësit pak më të mëdhenj, përdor fjalë. Mundësitë për klasifikim të koncepteve përfshijnë objekte, si nxënës (djem/vajza, ngjyra e flokëve, ngjyra e syve, mosha, ngjyra më e pëlqyer), këpucë (të djemve/vajzave, e djathtë/e majtë, me lidhëse/ngjitëse/pa asnjërën), pallto (të shkurtra/gjata, me pulla/patentë, me kapelë/pa kapelë), dhe pulla (numri i vrimave, formave, ngjyrave, madhësive). Mundësitë mund të përfshijnë njësi për studim, si grupe të ushqimeve, kafshëve, forma të transportit dhe çështje të tjera me rëndësi.
- Fillo me një klasifikim të hapur: Lejo nxënësit të përcaktojnë se si do të klasifikojnë duke u bazuar në njohuritë dhe përvojën e tyre.
- Kërko nga nxënësit të përshkruajnë si ngjasojnë gjërat në secilën kategori.
- Vendos për një fjalë kryesore apo frazë përshkruese për ta etiketuar secilën kategori.
- Modelo shkrimin e fjalëve kryesore. Gjithashtu, shkruaj etiketa individuale për secilin artikull gjatë klasifikimit të objekteve apo fotografive.
- Lejo klasifikimin individual, duke përdorur klasifikimin e mbyllur. Vendosi artikujt dhe etiketat në dispozicion të nxënësve për t'i klasifikuar individualisht apo me partner gjatë kohës së lirë apo kohës qendrore.

Procedura për klasifikimin e fjalëve

- Ndaje klasën në çifte apo grupe prej tre vetash
- Siguro një pjesë leximi në lidhje me një çështje apo koncept të cilin jeni duke e adresuar
- Kërkoni nga grupet t'i rishikojnë të gjitha fjalët në pjesën e leximit dhe identifikojnë fjalët apo frazat për të cilat nuk janë të sigurt (syno për 15 deri 30 fjalë)
- Zhvillo të kuptuarit e fjalëve/frazave përmes diskutimit, shfrytëzimit të kontekstit apo duke kërkuar për definicione
- Kërko nga grupi t'i klasifikojnë dhe grupojnë fjalët; siguroi nxënësit se është në rregull nëse nuk mund t'i përfshijnë disa nga fjalët në grupim
- Ekspozoj grupimet e fjalëve dhe ftoj nxënësit të ecin përreth për të parë si i kanë grupuar fjalët grupet tjera
- Ofro mundësi për nxënësit t'i kthehen grupimeve të veta dhe t'i rishikojnë pasi që i kanë parë grupimet e të tjerëve
- Ftoj nxënësit të spekulojnë për çështjen kryesore apo perspektivën/pozitën që mban pjesa të cilën do ta lexojnë duke marrë parasysh grupimet e fjalëve dhe asaj që sugjerojnë.

Gjërat që duhet marrë parasysh kur bëhet kategorizimi i fjalëve

- Klasifikimi manual është shumë më i lehtë nëse përdorni etiketa me fjalë – printo secilën fjalë apo frazë në etiketa të veçanta, letra ngjitëse apo copa të letrës.
- Është shumë me rëndësi që mësuesja ta modelojë aktivitetin në mënyrë që nxënësit të arrijnë sukses më të madh në aktivitetin e klasifikimit të fjalëve.
- Variacione dhe përmirësime të aktiviteteve themelore të kategorizimit të fjalëve mund të përfshijnë:
- Lejo nxënësit t'i manipulojnë fjalët në kategori tjera. Për shembull, mollët dhe dardhat janë 'lloje të frutave' dhe 'gjëra që rriten në pemë'.

- Kërko nga nxënësit ta shpjegojnë arsyen për klasifikimin e tyre të fjalëve; shpesh herë kjo mund t'iu ofrojë ide ku kanë nevojë nxënësit për ndihmë dhe përkrahje në kuptimin e raporteve në mes të fjalëve.
- Përdor 'strukturat tashmë të identifikuar të fjalive', kërko nga nxënësit të formojnë fjali duke përdorur fjalët të cilat i kanë klasifikuar për të demonstruar se e kanë kuptuar përdorimin e saktë të fjalëve.

8.16 Tiketatat me fjalë

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Rrjedhshmërisë dhe kompozimit me shkrim

Tiketatat me fjalë janë mjet thelbësor për t'i ndihmuar nxënësit në zhvillimin e fjalorit të fjalëve fotografike. Duke i përdorur tiketatat me fjalë, mësimdhënësi gradualisht i prezanton fjalët e reja para nxënësve. Përderisa ata njihen me fjalët, përmes përsëritjes, edhe i mbajnë mend ato.

Nxënësit kanë nevojë të ballafaqohen me një fjalë disa herë para se ta kenë atë fjalë në bankën e tyre të memories së fjalëve fotografike. Ata duhet gjithashtu të ndihen të suksesshëm për ta zhvilluar vetëbesimin për "zhvillim" të vazhdueshëm të repertorit të tyre të fjalëve fotografike.



Fjalori i murit

Mbajtja e fjalëve në dispozicion të fëmijëve dhe në vend të dukshëm është thelbësore për ekspozim të përsëritur. Fjalorët e murit janë të mirë për këtë gjë. Fjalori i murit i ka xhepat për t'i mbajtur tiketatat me fjalë. Ato mundësojnë që fjalët të jenë në dispozicion gjatë tërë kohës dhe

janë mënyrë praktike e përdorimit të radhës alfabetike. Fjalori i murit është i dobishëm në shkolla me ndërrime ku klasat e ndryshme mund të kenë nevojë për mësimin e fjalëve të ndryshme. Fjalori i murit mund të largohet lehtë nga muri dhe të zëvendësohet me një tjetër fjalor të murit të klasës tjetër, apo mund të ndërrohen fjalët që janë të vendosura në të.



Përtëkrijuar fjalorin e murit duhet të qepni numër të mjaftueshëm xhepa për çdo shkronjë të alfabetit dhe t'i etiketoni ato. Mund të krijoni fjalorë alfabeti edhe për gjuhë të huaja. Vetëm sigurohuni që të keni numrin e mjaftueshëm të xhepeve. Lejoni hapësirë në kryedhe fund të fjalorit të murit për të vendosur nga një shtagë apo mbajtëse të fjalorit të murit. Kjo e mban drejt fjalorin e murit dhe në të vendoset litar për ta varur në mur. Mësuesja apo fëmijët mund t'i përgatisin etiketat me shkronja për t'i ngjitur në xhepa. Mësuesja mund të vendosë disa fjalë themelore në fjalorin e murit por fëmijët duhet t'i krijojnë etiketat për secilën fjalë të re që e mësojnë dhe ta vendosin në xhepin përkatës.


Nxënësit mund ta përdorin fjalorin e murit në çdo kohë për t'iu ndihmuar ta mësojnë gërmëzimin dhe njohjen e fjalëve të reja. Ai është i mirë edhe për ushtrimin e radhës së alfabetit dhe për t'i mësuar nxënësit si ta përdorin një fjalor të vërtetë.

Muri i fjalëve

Për ta bërë murin e fjalëve, mësuesja dhe nxënësit i shkruajnë fjalët në tiketa dhe i ekspozojnë në mur ashtu që të gjithë fëmijët t'i shohin ato (sidomos nga qendra e leximit në klasë). Në klasat e ulëta, mësuesja mund t'i shkruajë fjalët (p.sh. 20 fjalët më të shpeshta në gjuhën shqipe) por nxënësit shumë shpejt do të dëshirojnë t'i shkruajnë vetë këto fjalë.

Në klasat më të ulëta, muret e fjalëve mund të ekspozojnë fjalë të cilat nxënësit i hasin gjatë leximeve të tyre dhe fjalë të tjera të shpeshta. Fjalët e reja mund të shtohen çdo javë në murin e fjalëve. Përderisa "muri i fjalëve" shtohet, nxënësit ndihen kërenarë kur shohin sa shumë fjalë kanë mësuar.

Shikimi i fjalëve në mur u ndihmon fëmijëve të jenë më të interesuar për fjalë dhe të kuptojnë se fjalët janë të rëndësishme dhe mund të përdoren gjatë tërë kohës. Muri i fjalëve u ndihmon t'i mësojnë shkronjat, radhën e alfabetit dhe raportin shkronjë-tingull. Ai ofron ekspozim dhe sfidë shtesë për nxënësit të cilët janë në nivele të ndryshme të shkathhtësisë dhe interesimeve. Nxënësit mund t'i referohen murit të tyre të fjalëve gjatë projekteve të shkrimit dhe shkrimit të ditarëve. Muret e fjalëve u japin



nxënësve vazhdimisht ide për mësim. Nxënësit mund ta përdorin murin e fjalëve si një fjalor të madh dhe ta shikojnë murin e fjalëve kur nuk janë të sigurt si ta shkruajnë një fjalë.

Mësimdhënësit e klasave 4 & 5 mund t'i përdorin muret e fjalëve për ekspozimin e fjalëve më të sofistikuara të cilat mund t'i zëvendësojnë fjalët më të shpeshta, e në këtë mënyrë edhe zhvillimit të një fjalori më të gjerë të nxënësve.

Zhvillimi i murit të fjalëve mund të integrohet lehtë në aktivitetet e përditshme. Fjalët kryesore dhe/ose terminologjia që ndërlidhet me njësinë mësimore mund të shtohen gradualisht përderisa prezantohen. Muri i fjalëve duhet të organizohet në atë mënyrë që të jetë i dobishëm për nxënësit së bashku me aktivitetet shtesë të cilat i reflektojnë shkathtësitë apo konceptet që mësohen.

Shpeshherë, muret e fjalëve organizohen në mënyrë alfabetike, ku fjalët janë të printuara në letër të trashë dhe të ngjitura apo vendosura në mur/tabelë.

Mësuesja mund ta krijojë me lehtësi një mur të fjalëve duke përdorur letër/kartuç të thjeshtë dhe markerë.

Pse të përdoret muri i fjalëve?

- Ofron model të vazhdueshëm për fjalët e shpeshta
- Ndhmon nxënësittë shohin modele dhe raporte në mes të fjalëve, dhe kështu i zhvillojnë shkathtësitë e fonetikës dhe germëzimit
- Ofron përkrahje për fëmijët gjatë aktivitetëve të lexim-shkrimit
 - Përkrah mësimin e fjalëve thelbësore dhe terminologjisë specifike për lëndë të ndryshme
 - Nxit pavarësinë në lexim dhe shkrim duke e zhvilluar fjalorin
 - Ofron ide vizuale për nxënësit e gjuhës
 - Ndhmon nxënësit të mbajnë mend lidhjet në mes të fjalëve dhe konceptëve.

Si të përdoret muri i fjalëve

- Vëri fjalët në dispozicion duke i vendosur aty ku i shohin të gjithë nxënësit. Ato duhet të shkruhen me shkronja të madhësisë së duhur dhe në letër me ngjyra të ndryshme për t'i dalluar fjalët e vështira.
- Përdore murin e fjalëve çdo ditë për t'i ushtruar fjalët, duke përfshirë aktivitete të ndryshme si këndimi, recitimi, tifozllëku, duartrokitja, përcjellja, etj., lojëra për gjetjen e fjalëve si edhe shkrimin e tyre.
- Ofro ushtrime të mjaftueshme ashtu që fjalët të lexohen dhe germëzohen në mënyrë automatike dhe të siguroheni se fjalët nga muri germëzohen saktë gjatë shkrimeve të përditshme të fëmijëve.
- Informata të reja duhet të shtohen rregullisht.
- Murit të fjalëve duhet t'iu referoheni shpesh ashtu që nxënësit ta kuptojnë dhe vërejnë relevancën e tij.
- Përdorimi i letrave me ngjyrë ndihmon në dallimin e konceptëve/termave që i përkasin njësive të ndryshme të mësimin.
- Fotografia apo vizatimi shton qartësim më të madh për nxënësit vizual apo nxënësit e gjuhës angleze.

- Fjalët mund të plotësohen me definicionet e tyre.
- Pjesa e prapme e tiketës së fjalës mund të përdoret për të paraqitur fjalën në mënyrë verbale dhe vizuale, grafikë, definicion dhe karakteristika të fjalës.


Cilat fjalë duhet të vendosen në mur?

Mësimdhënësi do t'i zgjedhë ato varësisht nga qëllimi, për shembull: fjalët fotografike të organizuara sipas alfabetit, fjalë specifike për një njësi mësimore, fjalë të reja. Muret e fjalëve, më të dobishme janë ato që shtohen dhe ndryshojnë gjatë vitit dhe shfrytëzohen si referencë e të nxënës.

- Mësuesit dhe nxënësit punojnë së bashku për të vendosur cilat fjalë duhet të vendosen në mur. Mundohuni të përfshini fjalë të cilat nxënësit i përdorin më së shpeshti në shkrimet e tyre. Fjalët duhet të shtohen gradualisht - një udhëzim i përgjithshëm është pesë fjalë në javë.
- Përdor materiale të përmbajtjes nga kurrikula; zgjedh fjalët më të shpeshta që përdoren nga përdoruesit e mirë të gjuhës - përdorim i shpeshtë - në vend të fjalëve të zgjedhura rastësisht.
- Kërkoni nga nxënësit të dalin në gjueti për fjalë gjatë leximeve dhe shkrimeve të tyre të cilat i përshtaten fonetikës apo modeleve të mësuara të fjalëve. Këto fjalë mund ta përbëjnë murin e fjalëve i cili paraqet shembuj të modeleve të ndryshme të mësuara. Nxënësit duhet ta mbajnë një fletore të mësimin të fjalëve dhe t'i regjistrojnë modelet e njohura dhe të kuptuarit e tyre të ri në lidhje me fjalët, si dhe të luajnë lojëra dhe aktivitete që vejnë në zbatim njohurinë e tyre të re të fjalëve.

Tiketatat me fjali

Tiketatat me fjali mund të jenë të dobishme edhe për zhvillimin e njohjes së fjalëve dhe vendosjes së fjalëve të panjohura në kontekst.



8.17 Aktivitete me hartë

Hartat e fjalëve

Harta e fjalëve është organizues grafik që nxit zhvillimin fjalorit (shih shembullin në vijim). Termi i ri vendoset në mes të hartës. Nxënësit e mbushin pjesën tjetër të hartës – një definicion, sinonime, antonime dhe një vizatim që ndihmon ilustrimin e konceptit të ri.

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Lexim-kuptimit
- Kompozimit në shkrim

Hartat e fjalëve u ndihmojnë fëmijëve të mendojnë për termat apo konceptet e reja në disa mënyra duke parashtruar pyetjet në vijim:

«Çka është kjo?»

«Si duket?» dhe

«A mund të jepni shembuj?»

Ato indihmojnë nxënësittë ndërtojnë mbi njohuritë e tyre paraprake dhe e përfaqësojnë në mënyrë vizuale informatën e re.


Harta e fjalëve është metoda më e mirë për zhvillimin e të nxënës të fjalorit të fëmijës. Si metodat e tjera të udhëzimeve eksplicite, i rrituri (qoftë vetëm apo së bashku me fëmijën) duhet ta shikojë paraprakisht materialin për lexim për të përcaktuar cilat janë fjalët e panjohura. Për secilën fjalë të re, fëmija (me përkrahjen e të rriturit) krijon një organizues grafik për atë fjalë. Në majë apo në mes të organizuesit është fjala e re. Degëzimi i fjalës ka tri kategori: klasifikimi (cilës kategori apo grupi i takon fjala), cilësitë (si duket fjala) dhe shembujt. Këto zbrazëti në të tri kategoritë plotësohen duke përdorur njohuritë paraprake të fëmijës. Hartat e fjalëve i ndihmojnë lexuesit zhvillojnë të kuptuarit e plotë të fjalëve. Kjo strategji përdoret më së miri me fëmijë të klasave 3-12.

Si funksionon kjo?

- Prezanto fjalën e fjalorit dhe hartën për nxënës.
- Mësoji ata si ta përdorin hartën duke e vendosur fjalën e synuar në katrorin në mes.
- Kërko nga nxënës të sugjerojnë fjalë apo fraza për t'i vendosur në katrorët tjerë të cilët japin përgjigje për pyetjet në vijim: «Çka është ajo?» «Si duket?» dhe «Cilët janë disa shembuj?»
- Inkurajo nxënës të përdorin sinonime, antonime dhe një vizatim që ndihmon ilustrimin e fjalës së synuar apo konceptit.
- Modelo si të shkruhet një definicion duke përdorur informata nga harta e fjalëve.




Model i Hartës së Fjalëve



Jep disa shembuj (Përdor fjalën në fjali)

Shembull i Hartës së Fjalës



Hartat e tregimit

Harta e tregimit është përshkrim vizual i vendndodhjes së radhës së ngjarjeve kryesore dhe veprimeve të personazheve të tregimit në formë të organizuesit grafik. Nxënësit përdorin përfaqësime vizuale për të organizuar elementet e rëndësishme të tregimit dhe kështu mësojnë të përmbledhin idetë, personazhet, vendndodhjen dhe ngjarjen e leximit të caktuar. Hartat e tregimit mund ta shtojnë të kuptuarit dhe vlerësimin e nxënësve për tekstin, aftësinë e tyre për t'i treguar, ritreguar dhe shkruar tregimet, si dhe vetëdijen e tyre se personazhet e tregimit dhe ngjarjet janë të ndërlidhura. Organizuesi grafik i hartës së tregimit i ndihmon nxënësit të identifikojnë elementet dhe temën e tregimit. Disa nga shumë elementet e tregimit përfshijnë personazhet e rëndësishme (pamjen e tyre, karakteristikat e personalitetit dhe motivimin), vendndodhjen e tregimit (kohën dhe vendin), problemin me të cilin ballafaqohen personazhet, si i qasen problemit dhe rezultatin.

Përballë është dhënë një organizues i thjeshtë grafik i bazuar në këtë model. Megjithatë, ekzistojnë shumë lloje të tjera të hartave të tregimit të cilat kontrollojnë elemente të ndryshme të tregimit (dhe zbulojnë struktura të ndryshme në një tregim). Disa, si tabela e tregimit janë kryesisht fotografike dhe ilustrojnë ngjarjet kryesore të tregimit në radhë kronologjike. Të tjerat mund të përfshijnë, për shembull:

- fillimin, mesin dhe fundin e tregimit.
- 5 pyetjet: kush, kur, ku, çka dhe si të tregimit.
- titullin, vendndodhjen, personazhet, problemin, zgjidhjen dhe temën e tregimit.
- një zinxhir të ngjarjeve të cilat i përmbledhin elementet kryesore të tregimit, në radhë kronologjike.

Mostra të këtyre organizuesve grafikë dhe të tjerëve mund të shkarkohen nga uebfaqja e BEP-it.

Hartat e tregimeve mund të përdoren me tërë klasën, grupe të vogla, apo për punë individuale, për t'i ndihmuar nxënësit në hulumtimin e komponentëve të ndryshëm të një tregimi apo teksti të dhënë. Ato mund të përdoren me jo-fiksion (d.m.th. identifikimi i ideve kryesore; detajeve) si edhe me fiksion (d.m.th. përcaktimi i personazheve; ngjarjeve). Hartat e tregimeve, si strategji e të kuptuarit, mund të jenë shumë të dobishme për nxënësit që kanë nevojë për ndihmë shtesë. Si ushtrim pas leximit, nxënësit mund të reflektojnë në tregim dhe ta përmbledhin atë duke e përdorur hartën e tregimit.

Hartat e tregimit mund të përdoren edhe si skicë për krijimin e një tregimi apo përmbledhjen e ngjarjeve të tregimit. Ato i ndihmojnë nxënësitt' vizualizojnë njerëzit, vendet dhe ngjarjet e tregimit. Gjatë ushtrimit të shkrimit kreativ, nxënësit e përdorin hartën e tregimit për t'i ndihmuar gjatë procesit fillestar të organizimit të mendimeve të veta para se të vazhdojnë me shkrimin e tregimit.

Vendndodhja

Personazhet

Përshkruaj problemin

Ngjarja 1

Ngjarja 2

Përshkruaj zgjidhjen

Një shembull i një organizuesi të thjeshtë me hartë

Hartat e tregimit ndonjëherë quhen tabelat e tregimit, sidomos kur planifikohet dhe organizohet një video film

Si aktivitet para shkrimit, nxënësit mund t'i skicojnë ngjarjet në fillim, mes dhe ngjarjet përfundimtare si kornizë për tregimet e tyre. Kjo, jo vetëm që do ta përmirësojë të kuptuarit e tyre, por hartat e tregimeve mund të përdoren edhe si korniza për tregimin apo ri-tregimin e tyre, dhe si kornizë për shkrimin e tregimit. Përdorimi i hartave të tregimit indihmon nxënësit të zhvillojnë shprehjen me shkrim.

Krijimi dhe përdorimi i hartave të tregimit

Zgjidh një tekst për ta lexuar, mundësisht një që ka ngjarje të lehtë. Përcakto elementët kryesorë të cilat nxënësit duhet t'i identifikojnë dhe zgjidh njërin model apo krijo një mostër të përshtatshme.

Modelo procedurën për tu siguruar që nxënësit e kuptojnë pse dhe si përdoret strategjia:

- Prezanto tekstin/tregimin që duhet të lexohet dhe ofroji secilit nxënës një mostër të zbrazët.
- Nxënësit fillojnë duke shkruar titullin dhe tekstin e detyrës për Hartën e tregimit.
- Lexo pjesën para nxënësve. Inkurajoni nxënësit t'i vizualizojnë personazhet, vendndodhjet dhe ngjarjet përderisa dëgjojnë.
- Diskuto dhe paraqit personazhet dhe ngjarjet kryesore të tregimit, duke përdorur pyetjet udhëzuese të dhëna në Tabelën xx në vijim:

Tabela xx: Planifikimi i tregimit

Elementet e tregimit	Shembujt
Personazhet	<ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë personazhet e përfshira? • Cilët luajnë rolet më kryesore? • Cilët janë dytësorë?
Vendndodhja	<ul style="list-style-type: none"> • Ku dhe kur ndodhi kjo ngjarje? Në cilën periudhë kohore?
Ngjarja	<ul style="list-style-type: none"> • Problemi/Qëllimi: Çka i bëri ngjarjet të ndodhin? Cilat probleme dolën, apo kush ishin lojtarët kryesorë në vijim? • Ngjarjet/Etapat: hapat apo ngjarjet kryesore që e përmbledhin progresin e situatës.
Zgjidhja/Rezultati	<ul style="list-style-type: none"> • Si u zgjidh problemi? Cili qëllim u arrit?

- Pasi që nxënësit i kompletojnë hartat e tyre të tregimit, ata mund të vetë-vlerësojnë apo t'i vlerësojnë moshatarët duke përdorur rubrikën në vijim, dhe të diskutojnë pse është regjistruar secili element.
- Një hartë e tregimit të klasës mund të krijohet duke vendosur informata në një fletë të madhe letre. Harta diskutohet dhe nxënësit inkurajohen të shtojnë fjalë në kategori apo madje edhe sugjerojnë kategori të reja.

Vlerësimi i hartës së tregimit

Vlerësimi duhet të jetë formativ, duke dhënë komente të bazuara në kritere të dhëna paraprakisht. Ato mund të përfshihen në rubrikë, si në atë të dhënë në vijim. Nxënësit mund ta përdorin një rubrikë të tillë për vetë-vlerësim dhe vlerësim të moshatarëve. Kini parasyshqë variacionet mes hartave të tregimeve nganjënjësit mund të ilustrojnë interpretimet e tyre personale.

Tabelaxx: Shembull i Rubrikës për Vlerësimin e Hartës së Tregimit

Kriteret	E pakompletuar = 1	Mjaftueshëm = 2	Mirë = 3	Shkëlqyeshëm = 4
Personazhet	Nuk është shënuar asnjë personazh kryesor	Disa nga personazhet kryesore janë shënuar	Të gjithë personazhet kryesore janë shënuar; gjithashtu disa personazhe dytësore	Vetëm personazhet kryesore janë shënuar
Vendndodhja	Nuk është identifikuar asnjë vendndodhje	Vendndodhja e shënuar me informata të pjesshme në lidhje me kohën dhe vendin	Vendndodhja e shënuar së bashku me kohën dhe vendin dhe është e saktë	Vendndodhja e shënuar me kohën dhe vendin si dhe detaje shtesë të përshtatshme
Problemi	Nuk është identifikuar asnjë problem	Problemi i identifikuar është i ndryshëm nga ai që është zgjidhur në fund	Problemet e sakta janë identifikuar por të përgjithësuara apo jo të plota	Problemi është i plotë dhe i menduar mirë e i kuptuar
Ngjarjet	Nuk janë përshkruar ngjarjet kryesore	Disa ngjarje janë përshkruar, por disa veprime kryesore janë lënë anash	Shumica e ngjarjeve "të rëndësishme" janë përshkruar; mungojnë disa detaje	Të gjitha ngjarjet "e rëndësishme" janë shënuar në renditje të saktë dhe me detaje relevante
Zgjidhjet	Nuk është identifikuar asnjë zgjidhje	Zgjidhjet e identifikuar nuk ndërlidhen me problemin	Zgjidhjet e identifikuar ndërlidhen deri diku me problemin; mungojnë detajet	Zgjidhjet janë përshkruar mirë dhe ndërlidhen mirë me problemin

Hartat Kllaster

Kllasteri është proces stuhi-mendimesh i ngjashëm me asociacionin e lirë. Ai i ndërlidh idetë në një hartë dy-dimensionale, me lidhje të bazuara thjesht në asociacionet mendoretë vetë nxënësit. Kllasteri ndihmon në aktivizimin e njohurive paraprake të nxënësve si edhe në marrjen e ideve të reja dhe mendimin për lidhjet mes ideve. Hartat e kllasterit u mundësojnë nxënësve të japin mendime dhe t'i shkruajnë idetë në mënyrë të organizuar.

Përdorimi i hartës kllaster në klasë është aktivitet i rëndësishëm për t'i mësuar nxënësit se si t'i organizojnë mendimet e tyre dhe informatat nga hulumtimet. Hartat kllaster quhen gjithashtu harta të koncepteve, organizues grafikë, harta vizuale, dhe harta të ideve.

Kur punojmë me harta kllasteri, duhet t'i inkurajojmë nxënësit të përqendrohen tek lidhjet mes idesë/konceptit qendror dhe ideve/fakteve të mbledhura përreth tij. Përdor hartat kllaster si pika nismëtare për shkrime apo diskutime të klasës. Duke i vizualizuar informatat, nxënësit tuaj do të jenë më të suksesshëm gjatë shkrimit të teksteve kohezivedhe të organizuara.

Gjërat që ju nevojiten

- Libër, tregim apo temë
- Kopja kryesore e hartës kllaster dhe kopje për klasën
- Materiale hulumtimi



Si të krijohet një hartë kllaster

- Kërko nga nxënësit ta plotësojnë rrethin në mes me titullin e librit apo tregimit, një temë apo koncept qendror. Për shembull, nxënësit mund të shkruajnë "ndotja" në rrethin qendror të kopjes së tyre të hartës së konceptit. Në mënyrë alternative, kërko nga ta të shkruajnë informata në qendër të fletës së tyre dhe ta rrethojnë.
- Lexo librin/tregimin së bashku me nxënësit apo kërko nga nxënësit ta plotësojnë hulumtimin së bashku si klasë, apo kërko nga nxënësit të lexojnë apo hulumtojnë në mënyrë individuale.
- Udhëzo nxënësit në ofrimin e nën-idesë në lidhje me të (për shembull "mbeturinat") në një nga rrathët që e rrethojnë idenë qendrore. Nxënësit mund të shkruajnë nën-idenë afër rrethit

kryesor dhe ta qarkojnë. Kërko nga nxënësit ta vizatojnë një vijë nga kyrreth deri te rrethi qendror. Udhëzo nxënësit të ofrojnë ndonjë nën-ide tjetër (për shembull “zhurma”) afër rrethit qendror dhe ndërlidhe me rrethin kryesor.

- g) Vazhdo duke kërkuar nga nxënësit të shkruajnë ide në rrathët e rinj. Rrathët mund ta rrethojnë rrethin kryesor apo ta degëzojnë atë në drejtime të ndryshme. Për shembull, përfshirja e “ujit” në një rreth mund të çojë drejt rrathëve shtesë që krijojnë një kllaster të llojeve të ndryshme të ndotjes së ujit, si oqeanet, liqenet, lumenjtë dhe shiu i ndotur.

Shenjat e kujdesit

Hartat kllaster nuk ka nevojë të përfshijnë vizatimin e rrathëve. Mund të kërkonit nga nxënësit të vizatojnë katrorë, drejtkëndësha, trekëndësha apo çfarëdo forme që preferojnë. Kllasterët e fotografive mund të krijohen nga nxënësit e vegjël. Për shembull, ndihmojenxënësin e vogël në prerjen dhe ngjitjen e fotografisë së një qeni nga një revistë. Ndihmojenxënësin të presë dhe ngjisë gjëra që kanë lidhje me qenin, si një kockë, top apo enë për ujë, përreth fotografisë qendrore dhe të vizatojë vija nga fjalët deri te qeni. Kjo hartë kllaster u mundëson nxënësve të vegjël t’i vizualizojnë gjërat që kanë të bëjnë me qenin.

8.18 Shkrimi i emrit

Ashtu si shumica e shkrimit në përgjithësi, edhe mësimi i shkrimit të emrit nuk është i thjeshtë – por gjithnjë është i këndshëm. Shkrimi i emrit tërheq vëmendjen drejtlidhjeve mes shkronjave dhe tingujve dhe ofron një grup fjalështë cilat mund të jenë fokusi i udhëzimeve (emrat e nxënësve të klasës). Klasa e nivelit parashkollor duhet të ketë shumë aktivitete për shkrimin e emrit. Për shembull:

Ndihmon në zhvillimin e:

- Vetëdijes tingullore
- Fonetikës
- Shkathtësive të dorëshkrimit

- **Shënimi:** Shënimi, siç bëjnë të rriturit nëtakime, është rutinë për fëmijët nëushtrimin e shkrimit të emrit dhe formimit të shkronjave. Mund të kërkonit nga fëmijët të shënohen çdo ditë, në një tabelë me fletë apo një fletë të bardhë pa vija. Më vonë mund t’i vendosni faqet në një regjistror për ta demonstruar zhvillimin e shkrimit me kalimin ekohës.



- **Etiketat:** Kur fëmijët fillojnë të mësojnë ta shkruajnë emrin e vet, formo një numër të etiketave me emra të gjeneruara ngakompjuteri për secilin fëmijë dhe vendosi në tabelën me xhepa. Caktoji secilit fëmijë xhepin e tij apo saj me një etiketë në ballë. Lejo fëmijën ta ngjisë etiketën në punimet e artit dhe shembujt e shkrimit si mënyrë e etiketimit të pavarur të punës së vet.
- **Libri i klasës me fotografi:** Bëj fotografi të nxënësve të klasës me aparat dixhital. Ngjiti fotografitë e nxënësve në tiketa me emra dhe lidhi tiketat së bashku në një libër. Vendose në qendrën e leximit së bashku me letra të pastra për t'i përshkruar dhe vendosi shkronjat e mëdha dhe të vogla nga plastika për t'i bashkuar. Lejoi fëmijët ta shkruajnë emrin e shokut/ shoqes së tyre.
- **Gjuetia e shkronjave:** Mblidh kuti të zbrazëta të biskotave, picave, pastave të dhëmbëve, të cilat fëmijët i njohin. Ua rikujton atyre se shkronjat bashkohen në mënyra të caktuara për t'i formuar edhe fjalët tjera siç bashkohen për ta formuar emrin e tyre. Hulumto disa kuti së bashku dhe zbulo, si për shembull, biskotat "Sempre" fillojnë me shkronjën e njëjtë si emri i Sihanës, tek "Pica" është shkronja C si emri i Cucës. Pastaj lejoni të hulumtojnë të pavarur. Kjo u ndihmon fëmijëve t'i njohin shkronjat në fonte të ndryshme dhe të mësojnë për shkronjat e vogla dhe të mëdha të secilës shkronjë.

8.19 Rripat e fjalive

Rripat e fjalive janë rripa të kartuqit në të cilat mësuesja dhe nxënësit mund të shkruajnë fjali. Në shumicën e rasteve, ato janë të plastifikuara, ashtu që të mund të fshihen dhe të përdoren sërish.

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Shkrimit shprehës
- Shkrimit të rrjedhshëm
- Dorëshkrimit



Ato mund të përdoren për të mësuar renditjen, sintaksën, mekanikën, pikësimin, etj. Zakonisht mësuesit shkruajnë fjali në rripa dhe i presin në fjalë (apo shkronja, varësisht nga njësia mësimore). Ato mund të përdoren së bashku me tabelën me xhepa.

Rripat e fjalive mund të përdoren në shumë mënyra gjatë mëimit të fjalorit. Në vijim janë dhënë dy shembuj:

Gjetja e kuptimit

Fjalët e reja shkruhen në tabelë që nxënësit t'iu referohen. Mësuesja i krijon rripat e fjalive që e përcaktojnë apo në ndonjë mënyrë kanë lidhje me një fjalë të caktuar të fjalorit pa e përdorur atë fjalë në fjali. Për shembull, fjala *sundimtar* lidhet me fjalinë në vijim: *Mbreti i Monakos është person shumë i fuqishëm*. Nxënësi duhet ta lexojë fjalinë para klasës dhe ta bashkojë atë me fjalën përkatëse të fjalorit. Nxënësit mund t'i përdorin rripat e fjalive edhe për t'i formuar fjalitë e tyre duke ilustruar fjalët e reja të fjalorit.

Fjalët në kontekst:

Mësuesja e zgjedh fjalorin e synuar dhe i shkruan fjalitë duke e vënë një vijë të zbrazët për fjalët e synuara. Për shembull, "*Doni ishte i ____ për biçikletën e re.*" Nxënësi e gjen fjalën e synuar që mungon nga tiketat me fjalë (p.sh. *gëzuar*).

Nxënësit punojnë në çifte

Nxënësit e zgjedhin një fjalë për t'i plotësuar fjalitë.

1. Vendosi rripat e fjalive në një grumbull në mes. Vendosi tiketat e fjalëve me fytyrë lart në rreshta.
2. Me radhë, nxënësi i parë zgjedh një rrip me fjali dhe e lexon atë, duke thënë "zbrazët" për fjalën që mungon.
3. Nxënësi i dytë e gjen fjalën, e vendos atë në zbrazëtirë dhe e lexon fjalinë. Nëse fjalia nuk ka kuptim, e zgjedh një fjalë tjetër deri sa të gjendet fjala e saktë.
4. Ndërrohen rolet dhe vazhdohet deri sa të gjitha fjalët bashkohen me fjalitë përkatëse.
5. Vlerësimi i moshatarëve.

Shënime:

8.20 Imitimi i tregimit

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Shkrimit shprehës
- Shkrimit të rrjedhshëm

Mësojini nxënësit të imitojnë tiparet e të shkruarit të mirë.

Nxënësit duhet të ekspozohen ndaj një shumëllojshmërie veprash të përshtatshme për nivelet përkatëse të leximit, të cilat të shërbejnë si shembuj të mirë të strukturës së tekstit, zgjedhjes efektive të fjalëve dhe strukturave të ndryshme të fjalisë.

Në klasat e hershme, mësuesit duhet të lexojnë tekste model me zë të lartë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë zgjedhjes së fjalëve nga autori, strukturës së tërësishme, apo elementeve të tjera të stilit, në përputhje me objektivat mësimore të orës. Për sa u përket fjalëve, për shembull, pasi të lexojnë *Ecja e Rozit* (angl. *Rosie's Walk*, më poshtë), mësuesit mund të përdorin lloje të ndryshme sinonimesh në vend të fjalës *ec*, dhe mund t'i demonstrojnë fizikisht shembujt përkatës para klasës. Më pas, nxënësit mund t'i rendisin fjalët duke filluar me ato që nënkuptojnë lëvizje më të ngadalshme tek ato që nënkuptojnë lëvizje më të shpejtë (p.sh. *zvarritem, shëtis, ec, shpejtoj, nxitoj, dhe vrapoj*).

Nxënësit më pas mund t'i zbatojnë ato që kanë mësuar për të përmirësuar të shkruarit e tyre. Një mënyrë për t'i mbështetur ata në këto përpjekje është të përdoret një kornizë e ngjarjes për të krijuar një tregim të ngjashëm (shih shembullin e mëposhtëm) duke zëvendësuar fjalët në fjali me sinonime, apo duke futur fjalë ose përmbajtje që përshtaten me kontekstin. Ky fokus tek imitimi i modeleve të fjalive apo tek gjetja dhe zëvendësimi i fjalëve në vendet e duhura funksionon posaçërisht me ata që kanë vështirësi në të shkruar ose me nxënësit në klasat e hershme.

Në vijim është një shembull i imitimit të tregimit:

Teksti origjinal i Shëtitja e Rozës, nga Pat Hutchins

Pula Roza doli të shëtisë
përmes oborrit
përreth pellgut
përtej sanës
kaloi mullirin
nëpër gardh
përfundi zgjojeve
dhe arriti me kohë për darkë.

Korniza e Shëtitja e Rozës, e ofruar nga mësuesja si fletë pune

..... doli të
përmes.....
përreth.....
përtej.....
kaloi
nëpër
përfundi
dhe arriti me kohë për.....

Shembull i tekstit të zhvilluar nga nxënësi i klasës së parë

*Mësuesja Ardita doli për shëtitje
nëpër parkun e lojërave
rreth parkingut
mbi litarin e kërcimit
përtej fushës sportive
përmes portës së rrethojës
nën flamur
dhe u kthye në kohë për orën e parë të mësimin*

8.21 Shkrimet e përbashkëta

Në shkrimet e përbashkëta, mësuesja dhe nxënësit përpilojnë së bashkë një tekst, ku të gjithë kontribuojnë me mendimet dhe idetë e tyre gjatë procesit, përderisa mësuesja e luan rolin e shkruarit, duke e shkruar tekstin përderisa përpilohet.

Ndihmon në zhvillimin e:

- Fjalorit të fjalëve fotografike
- Shkrimit shprehës
- Shkrimit të rrjedhshëm

Shkrimi bëhet kryesisht në tabelë apo fletë të madhe. Lapsi përdoret nga mësuesja dhe fëmijët për t'i përfshirë edhe fëmijët në procesin e shkrimit. Mësuesja e kontrollon lapsin por i fton fëmijët të shkruajnë pjesë të cilat i dinë dhe pastaj mësuesja i plotëson ato që nuk i dinë. Përderisa grupi kompozon, mësuesja parashtron pyetje nxitëse për të nxjerrë më shumë detaje dhe për t'i ndihmuar fëmijët për ta bërë shkrimin e tyre më kuptimplotë. Toni i këtij diskutimi duhet të jetë bashkëpunues e jo drejtues. Mësuesja mund të thotë diçka si "Nuk edi nëse duhet të shtojmë më shumë detaje këtu. Si mund ta bëjmë këtë?" në vend që të thotë "Duhet të shtojmë më shumë detaje këtu".

Si në shkrimet me zë, shkrimi i përbashkët u mundëson mësuesve ta bëjnë procesin e të shkruarit më konkret dhe të dukshëm për nxënësit. Duke luajtur rolin e shkruarit, mësuesja i liron nxënësit nga aspektet mekanike të procesit të shkrimit në mënyrë që të fokusohen vetëm në të menduarit që përfshihet në shkrim. Kështu që, duke i liruara ata nga brengat e mekanikës, shkrimi i përbashkët u mundëson nxënësve të fokusohen në shprehje.

Shkrimet e përbashkëta mund të përdoren edhe si model për procesin e rishikimit. Mësuesja mund ta udhëzojë grupin për të shtuar detaje, për të larguar fjalë apo pjesë të panevojshme ose hutuese, apo ta ndryshojë strukturën e tekstit për ta qartësuar kuptimin. Mësuesja mund t'i përdorë shkrimet e përbashkëta edhe për redaktim, duke u fokusuar në mekanikën dhe rregullat si drejtshkrimi, pikësimi, shkronjat e mëdha dhe gramatika.

Temat që përdoren për shkrime të përbashkëta mund të mbulojnë shumëllojshmëri të gjerë të formave, qëllimeve dhe zhanreve. Teksti mund të shërbejë për një qëllim specifik të udhëhequr nga ajo që po ndodh në klasë, apo mësuesja dhe nxënësit mund të japin ide dhe të negociojnë së bashku për këto vendime. Disa tema dhe forma të mundshme përfshijnë tregimin që e përshkruan një ngjarje të kohëve të fundit në klasë, ri-tregimi i një tregimi të dashur, shkrimi i procesit që përshkruan si është zhvilluar një projekt dhe çka është mësuar, një përmbledhje apo reflektim të librit të lexuar në klasë, një listë shënimesh të ndryshme që mund të shtohen në fletoren e shkrimtarit, dhe të tjera. Kompozimi mund të jetë i shkurtër dhe të përfundohet brenda një ore mësimore, apo mund të jetë më i gjatë dhe i zgjeruar gjatë disa orëve mësimore.

Shkrimet e përbashkëta zakonisht përdoren më shpesh në klasat e ulëta dhe në fillim të vitit shkollor kur shkrimtarët në zhvillim kanë nevojë për më shumë përkrahje dhe modelim; por mund të përdoren edhe gjatë vitit shkollor. Ato mund të përdoren me tërë klasën apo me grupe më të vogla të cilat kanë nevojë për më shumë përkrahje.

Shkrimi i përbashkët është një hap në procesin e mësimdhënies, që fillon me hulumtimin e teksteve të botuara; vazhdon me karakteristika relevante të gramatikës, pikësimit apo stilit; dhe përmes shkrimit të përbashkët çon drejt shkrimit individual.



Ekzistojnë tre nivele të shkrimit të përbashkët – demonstrimi, shkrimi dhe shkrimi i përkrahur – dhe nxënësit kanë nevojë ta ushtrojnë secilën detyrë më shumë se një herë.

Demonstrimi

Mësuesja u demonstron si ta shkruajnë një lloj të caktuar të tekstit, duke u shpjeguar çka është duke bërë përdorin e bën atë dhe pse po e bën:

- e ushtron secilën fjalë me zë para se ta shkruajë, duke i diskutuar zgjedhjet në lidhje me fjalorin, radhën e fjalëve dhe kështu me radhë – duke demonstruar se kompozimi kërkon reflektim
- shkruan fjalinë, duke tërhequr vëmendjen në karakteristikat si pikësimi dhe si i kontribuojnë ato këtij efekti
- lexon sërish atë që ka shkruar dhe e kontrollon si tingëllon – dhe ndoshta e përmirëson atë gjatë progresit.

Shkrimi

Mësuesja i përfshin nxënësit në zgjedhjen e fjalëve dhe kompozim. Duke përdorur teknikat e njëjta të ushtrimit-shkrimit-rileximit, ajo i shkruan sugjerimet e tyre dhe i ndan komentet gjatë procesit me ta.

Shkrimi i përkrahur

Nxënësit punojnë në çifte. Secili çift e ka një tabelë dhe një marker. Mësuesja i jep klasës përgjegjësi për një fjalë. Në çifte, fëmijët e ushtrojnë-shkruajnë-rilexojnë, pastaj e mbajnë tabelën lart që mësuesja ta shohë. Mësuesja mund të vendosë edhe sa punë e përbashkët nevojitet. Pasi që nxënësit të kenë marrë bazat e detajuara si të shkruajnë përmes mësimeve të shkrimit të përbashkët, ata janë të gatshëm të kalojnë në shkrim të pavarur.

Duke u fokusuar në kompozim dhe duke ia lënë shkrimin mësueses, shkrimi i përbashkët u lejon të gjithë nxënësve të marrin pjesë në detyrën e shkrimit. Ai inkurajon hulumtim të mbyllur të tekstit, fjalëve dhe mundësive të autorit, si dhe demonstron rregullat e shkrimit, germëzimit, pikësimit dhe gramatikës.

Shkrimi i përbashkët në praktikë

Shkrimi i përbashkët u mësohet grupeve të vogla apo tërë klasës në mënyrë të shpejtë, në njësi prej 5-20 minutash. Mësuesja e shkruan

Shkrimi i përbashkët i tregimit – nga moshë 7-vjeçare e më lart

Klasa e shkruan tregimin së bashku (me kontribut nga secili fëmijë).

- 1) Mësuesja shkruan një fillim të shkurtër të tregimit (“fillimin e tregimit”). Mbaj një listë të klasës ku fëmijët të shënojnë emrin e vet pasi të kenë përfunduar.
- 2) Në fillim, lexo prezantimin e tregimit dhe shpjego aktivitetin (kjo me siguri do të zgjasë deri në fund të ditës).
- 3) Secili fëmijë me radhë duhet të lexojë atë që është shkruar deri në atë moment dhe të shtojë një fjalë për ta vazhduar, dhe pastaj ta lajmërojë personin e ardhshëm në listë për të vazhduar.
- 4) Fëmijët e fundit duhet ta përfundojnë tregimin.
- 5) Në fund të ditës, lexojë tregimin dhe kërko nga fëmijët të tregojnë se si u duket.

tërë tekstin përderisa nxënësit angazhohen në diskutim të pasur në lidhje me mënyrën si duhet të kompozohet teksti.

- Planifiko orët për llojet e shkrimit që prezantojnë sfida të veçanta për nxënësit tuaj.
- Së pari, zhvillo dhe zgjero njohuritë e përgjithshme dhe ato gjuhësore të fëmijëve në lidhje me një temë apo përvojë interesante.
- Vendos për qëllimin e shkrimit dhe mundësinë e angazhimit intelektual që nxënësit të mund t'i zbatojnë mësimet e reja. Nxënësit mund t'i shkruajnë një letër gazetës lokale apo t'i shkruajnë udhëzimet për një lojë të re që e kanë zhvilluar.
- Shkruaj tekstin e plotë para nxënësve (duke përdorur fletëtë mëdha të letrës) përderisa kërkon ide nga nxënësit në lidhje me aspekte të shkrimit ku kanë nevojë më së shumti për ta zgjeruar ekspertizën e vet. Keni parasysh, për shembull, nëse nxënësit tuaj kanë nevojë ta përqendrojnë vëmendjen në strukturën e paragrafit, zgjedhjen e fjalëve apo zgjerimin e fjalive.
- Gjatë shkrimit, modeloni proceset për të cilat kanë nevojë nxënësit tuaj. Për shembull, në një tabelë u demonstroi nxënësve si duhet të fillojnë me rrënjën e një fjale dhe t'i shtojnë parashtesa dhe prapashtesa për ta formuar një fjalë të re.
- Demonstroi aty për aty rishikimin gjatë shkrimit të përbashkët si të domosdoshëm për ta përpiluar një version të mirë. Ri-lexoni kohë pas kohe tekstin me nxënësit për të diskutuar çka ka nevojë të shkruhet në vijim apo për të monitoruar nëse teksti e transmeton informatën në mënyrë të qartë. Shto një fjalë apo largo ato të panevojshmet.
- Mos bëni gabime me qëllim gjatë shkrimeve të përbashkëta. Modeloni ndërtimin e menjëhershëm të versioneve të cilësisë së lartë.
- Lexo tekstin e kompletuar para nxënësve. Ndaj pak kohë që nxënësit ta përmbledhin me zë atë që kanë mësuar në lidhje me të shkruarit gjatë kësaj ore.
- Vendose tekstin në një vend të dukshëm në klasë dhe ofro mundësi për nxënësit që ta lexojnë apo përdorin tekstin disa herë gjatë ditëve apo javëve të ardhshme.

8.22 Shkrimi me zë

Demonstrimi i procesit të shkrimit nga mësuesja është faktor kritik në themelimin e shkrimit të suksesshëm. Sikur edhe leximi me zë, shkrimi i përbashkët dhe leximi i udhëhequr indihmon fëmijëtevegjël të lëvizin drejt leximit të pavarur, kështu që shkrimi me zë dhe strategjitë e tjera të shkrimit bashkëpunues (p.sh. shkrimi i përbashkët) mund t'i ndihmojnë shkrimtarëtevegjël të lëvizin drejt pavarësisht.

Ndihmon në zhvillimin e:

- Shkrimit shprehës
- Shkrimit të rrjedhshëm

“Shkrimi me zë” është qasje e shkallëzuar e mësimi të shkrimit duke përdorur strategji të “mendimit me zë”. Kjo strategji u mundëson nxënësve ta shohin dhe ta dëgjojnë mësuesen gjatë përdorimit të procesit të shkrimit. Mësuesit e ndajnë të menduarit e tyre përderisa e kompozojnë pjesën e tyre të shkrimit para nxënësve dhe me pjesëmarrjen e nxënësve. Ata mendojnë dhe pastaj i praktikojnë strukturat e fjalive që janë pjesë e zhanrit të cilin janë duke e kompozuar.

Të gjitha aspektet e procesit të shkrimit mund të modelohen gjatë shkrimit me zë, edhe pse jo gjithmonë të gjitha në të njëjtën kohë. Mësuesit mund të modelojnë stuhinë e mendimeve,

fazën e gjenerimit të ideve, mendimin me zë në lidhje me temat e mundshme për të cilat mund të shkruajnë, cilat aspekte të temës së zgjedhur, kush mund të jetë audienca dhe qëllimin e shkrimit, në mesin e gjërave që merren parasysh. Në vijim, mësuesit bisedojnë përgjatë procesit të të menduarit përderisa e përpilojnë pjesën e tyre. Mësuesit mund ta përdorin edhe shkrimin me zë për redaktim, duke u fokusuar në germëzim, pikësim, shkronjë të madhe dhe gramatikë, si edhe në përdorimin e koncepteve të fjalisë dhe paragrafëve, sipas nivelit zhvillimor të nxënësve.

Nxënësit duhet t'i shohin të gjitha llojet e teksteve gjatë mësimeve të shkrimit me zë, duke përfshirë tregime, lista, vjersha, jo-fiksion, udhëzime dhe korrespondenca. Shkrimi me zë nuk ka nevojë për një tregim interesant apo informatë të re – temat më të thjeshta janë zakonisht më të mirat. Një mësues kishte arritur rezultate shumë të mira duke kërkuar nga nxënësit t'i ndihmojnë ta ri-kujtojnë rastin kur ajo e derdhi lëngun gjatë kohës së ushqimit. Tema ishte e fokusuar, e thjeshtë dhe e rëndësishme për nxënësit. Kështu që një pjesë e shkurtër në lidhje me një përvojë të përbashkët që ka ndodhur në klasë, një listë e gjërave që nevojiten për një projekt të klasës, apo diçka e ngjashme është më së miri. Pika më e rëndësishme është që nuk duhet të jetë diçka në lidhje me atë që vetëm mësuesja ka njohuri të dobishme.

Disa pjesë duhet të jenë të shkurtra dhe të kompletohen gjatë një ore mësimore; të tjerat mund të jenë më të gjata dhe të vazhdojnë për disa orë mësimore. Kjo u lejon nxënësve ta shohin shkrimin si proces të vazhdueshëm e të zgjeruar, si dhe u mundëson mësuesve t'i modelojnë strategjitë e shkrimit kritik si ri-leximi i tekstit të cilin sapo e keni shkruar para se të vazhdoni të shkruani.

Shkrimi me zë mund të përdoret në çdo klasë gjatë tërë vitit shkollor; por përdoret më shumë në klasat e ulëta dhe në fillim të vitit. Për fëmijët e vegjël, mësuesja zgjedh fjalor të thjeshtë dhe të përshtatshëm për nivelin e klasës së tyre, i thekson fjalët ngadalë dhe me kujdes dhe fillon ta prezantojë strukturën e fjalive, zgjedhjen e fjalëve, detajeve, mbiemrave, germëzimit dhe kështu me radhë.

Shkrimi me zë në praktikë

Shkrimi me zë u mësohet grupeve të vogla apo tërë klasës me një hap pak më të shpejtë, njësi prej 10-15 minutash. Nxënësit duhet të ulen në mënyrëqë të jenë sa më afër shkrimit. Shumë mësues krijojnë hapësira të rehatshme me një qilim në një kënd të qetë të klasës vetëm për këtë qëllim. Aty duhet të jetë një sipërfaqe e dukshme për shkrim si një tabelë apo mbajtëse letrash të mëdha, apo edhe një projektor apo ekran. Mësimi është kryesisht i shpejtë dhe i fokusuar në një apo dy elemente të procesit të shkrimit.

Modelo shkrimin tënd të tekstit të shkurtër, duke zgjedhur kryesisht një aspekt të caktuar të një zhanri për shkrimin me zë (si paragrafi fillestar apo përfundimtar për një ese më të gjatë apo dialog në mes të personazheve).

Orë model për shkrimin me zë

- 1) Zgjidh një pjesë të shkurtër dhe shumë interesante dialogu nga një tregim i njohur për të gjithë nxënësit. Shkruaje në tabelë. Shkruaje këtë ide të shkurtër, apo ndonjë tjetër, përfundi dialogut: "Analizo zhvillimin e personazhit në..."

- 2) Tregoju nxënësve se do t'i dëgjojnë me kujdes mendimet e tua përderisa e lexon dialogun e shkurtër me zë dhe nuk u lejohet të të ndërpresin me pyetje gjatë leximit tuaj. Lexo dialogun e shkurtër me zë dhe ndërpriteleximin shpesh me komente koncize në lidhje me kontekstin e ngjarjes dhe në lidhje me atë çka thonë personazhet dhe pse i thonë ato. Fokusohu në të kuptuarit, jo në zhvillimin e personazheve gjatë leximit të parë.
- 3) Pas leximit, kërko nga nxënësit të mendojnë nëse e kanë kuptuar tekstin më mirë pasi i ke thënë me zë mendimet tuaja në vend që ta lexosh në mënyrë pasive pa mendime aktive. Përgjigjet e tyre do të jenë "Po", nëse e kanë lexuar në mënyrë efektive. Ua rikujton nxënësve shkurt që të dëgjojnë me kujdes dhe mos të ndërpresin.
- 4) Tregoju nxënësve se tanido tëmësojnë një strategji të rëndësishme të të menduarit dhe se do t'i dëgjojnë mendimet e tuasi një shkrimtar me përvojë. Tregoju se mendimet e tua nuk do të jenë se çkaduhet të mendojnë ata. Tregoju se ata mund ta përmirësojnë mënyrën se si mendojnë.
- 5) Tregoju nxënësve se do të japin ide për esenë e analizës së personazhit gjatë Leximit me zë. Thekso fjalën *jepniide* në tabelën e Procesit të shkrimit dhe trego se do ta bëni këtë Shkrim me zë vetëm për këtë pjesë të procesit. Rikujtoji nxënësit se duhet t'i dëgjojnë mendimet tuaja me kujdes, por se nuk lejohen të ndërpresin me pyetje gjatë aktivitetit.
- 6) Tanilexoji idetë me zë dhe përcakto analizën si "ta zbërtheni temën dhe ta shpjegoni secilën pjesë të saj" sikur të jesh duke e përkujtuar veten për definicionin. Ri-lexo dialogun me zë dhe ndërpriteleximin shpesh me komente koncize në lidhje me mënyrën sesi i thonë personazhet fjalët e tyre. Shkruaj komentet e tua përfundi dialogut në organizuesin grafik. Shpjego se do të përdoret harta e organizuesit grafik, d.m.th. kllasterin rrethor, për stuhi mendimesh rrethideve të tyre sepse kjo do t'indihmojë të organizojnë mendimet e tyre dhe do t'u mundësojë të shtojnë mendime të reja përderisa mendojnë për to. Fokusoji komentet (dhe shkrimin) tënd në këto katër komponentë: personalitetet e personazheve, përshkrimet, motivet dhe zgjedhjen e fjalëve nga autori. Pyet nëse organizimi dhe komentet kanë kuptim për lexuesin. Mos vazhdo me tregimet tuaja personale. Komento më shumë për tekstin se sa për lidhjet tua personale me tekstin.
- 7) Pas leximit kërko nga nxënësit të tregojnë nëse dëgjimi i mendimeve të tua dhe shkrimi i tyre indihmoi të kuptojnë si e thonë personazhet atë që po e thonë. Përgjigja e tyre do të jetë "Po". Kërko nga nxënësit ta përsërisin atë që ke thënë e që ika ndihmuar më së shumtipër ta kuptuar procesin tëndtë mendimit. Kërko nga nxënësit të tregojnë çka mendojnë ndryshe në lidhje me atë që do të shkruhet, nëse ata do t'ua mësonin Shkrimin me zë.
- 8) Vendos dy dialogje të reja në tabelë me të njëjtat ide si më parë.
- 9) Grupoji nxënësit në çifte dhe kërko që të praktikojnë Shkrimin e tyre me zë, duke i përdorur të dy dialogjet. Kjo mund të jetë e zhurmshme, kështu që përcaktoji pritshmëritëe tua dhe përkujtoji nxënësit se do t'ikthehen organizuesit të tyre grafik.
- 10) Përsërite procedurën e Shkrimit me zë me komponentëtë tjerëtë procesit të shkrimit, me apo pa ide, si dhe me detyra dhe zhanre të ndryshme.

8.23 Hamburgeri me paragrafë

Ndihmon në zhvillimin e:

- Shkrimin shprehës
- Shkrimin të rrjedhshëm


Nxënësit kanë nevojë të mësojnë ta strukturojnë shkrimin e tyre në paragrafë. Një paragraf është një grup fjalish të organizuara në një pjesë të dallueshme apo në një temë të vetme. Në përgjithësi, do të ketë një "fjalë të temës" në fillim dhe një fjalë përfundimtare në fund. Këto e bëjnë paragrafin të jetë një njësi e përbashkët koherente. Në mes, duhet të ketë fjalë të tjera. Aty duhet të theksohet ideja kryesore e paragrafit dhe të tjerat japin detaje përkrahëse. "Ideja kryesore" është ajo për çka bëhet fjalë kryesisht në tregim apo paragraf; "detajet përkrahëse" janë fjalë që përkrahin idenë kryesore.

"Hamburgeri me paragrafë" është organizues i të shkruarit që i përcakton në mënyrë vizuale komponentet kryesore të paragrafit në formë hamburgeri (shih në vijim). Secili nga elementet kryesore të një paragrafi të mirë formon një "pjesë" të ndryshme të hamburgerit. Secila fjalë e temës dhe fjalë përfundimtare ndodhet në gjysmën e sipërme dhe të poshtme të bukës. "Ide kryesore" është mishi; dhe "detajet përkrahëse" janë shtesat e perimeve, turshive dhe keçapit. Ky lloj organizuesi grafik mund të përdoret për të demonstruar në mënyrë konkrete si ndërliiden informatat, dhe si organizohen apo strukturohen konceptet/idetë. Kjo ndihmon nxënësitt' organizojnë idetë në një paragraf koheziv.


Si të përdoret hamburgeri me paragrafë

- 1) Diskuto katër komponentët kryesorë të një paragrafi, apo tregimi.
 - a) Hyrja (buka e sipërme)
 - b) Informatat e brendshme apo përkrahëse (shtesat)
 - c) Ide kryesore (mishi)
 - d) Përfundimi (buka e poshtme)
- 2) Tregoju nxënësve shembuj të paragrafëve të shkruar mirë dhe kërko që t'i identifikojnë pjesët (apo lejoji t'i studiojnë individualisht duke iu ofruar disa paragrafë me pjesët e etiketuara).
- 3) Ofroju nxënësve shembuj ku disa pjesë janë të plotësuara. Për shembull, ofro fjalë të "fillit" dhe kërko nga nxënësit të shkruajnë një fjalë të mirë hyrëse dhe një përmbyllëse.
- 4) Ofroju nxënësve një shembull të plotësuar komplet. Kërko që t'i presin pjesët dhe t'i ri-organizojnë ato.
- 5) Kërko nga nxënësit ta gjejnë një paragraf në tekstet e tyre shkollorë. Shiko nëse mund të identifikojnë pjesët e ndryshme të atij paragrafi. Nëse është e domosdoshme, kërko ta rishikojnë paragrafin e tekstit shkollor.
- 6) Kërko nga nxënësit ta zhvillojnë një paragraf për një temë të dhënë:
 - a) Kërko t'i thonë paragrafët me zë para se t'i shkruajnë. Përdor shkallëzimin. Për shembull "Çfarë ke dëshirë të më tregosh në lidhje me (emri i qenit të fëmijës)". "Përse është qejf të luash me *qenin*?" (nxjerr detaje". "Atëherë, çka më ke treguar në lidhje me *qenin*?" (përfundimi).

- b) Kërko nga nxënësit të shkruajnë një fjali të temës e cila thekson qartë se për çka do të flitet në atë paragraf.
- c) Kërko nga nxënësit të shkruajnë pikën kryesore, e cila është gjëja më e rëndësishme që keni për të thënë në lidhje me temën.
- d) Kërko nga nxënësit të shkruajnë një deri tri fjali përkrahëse që japin më shumë informata në lidhje me temën.
- e) Kërko nga nxënësit të shkruajnë një fjali përfundimtar që rithekson fjalinë e temës.









Organizuesi grafik - Hamburgeri me paragrafë



PJESA 9: BURIME PËR KLASËN TUAJ

Pako e leximit - Lista e artikujve

Nr.	Përshkrimi i artikullit	Ilustrimi	Nr.	Përshkrimi i artikullit	Ilustrimi
1	<p>Fjalori i murit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pëlhurë cilësore e kaltër - Dim. 90 x 90 cm. - Me 36 xhepa të verdhë (9 xhepa x 4 rreshta) - Dim. i xhepave 10 x 10 cm. - Në çdo xhep, një shkronjë e shtypur - Me shufra druri poshtë e lartë për ta mbajtur të tërhequr dhe me varëse 		4	<p>Komplet i kartave me shkronja të mëdha të shtypit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komplet i përmban 50 karta - Dim. i kartave është 8 x 5 cm. (letër gloss 200 gr.) - Secila kartë në njërën anë ka shkronjën, ndërsa në tjetrën një fjalë që fillon me atë shkronjë dhe figurën e asaj fjalë. - Ofertuesi do të marrë nga porositësi listën e fjalëve për secilën shkronjë. - Kartat duhet të kenë kutinë e vet. 	
2	<p>Shiriti i fjalive</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ceradë e hollë, ose pëlhurë cilësore e kaltër - Dim. 100 x 80 cm. - Më shirita horizontale prej materialit të tejdukshëm, për të futur karta nga sipër. Gjithsej 9 shirita të trashësisë 3 cm., në largësi identike nga njëri tjetri - Me shufra druri poshtë e lartë për ta mbajtur të tërhequr dhe me varëse 		5	<p>Komplet i kartave me fjalë e fjali</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dy komplete me nga 120 karta (për dy nivele) - Dim. i kartave është 6 x 13 cm. (letër gloss 200 gr.) - Secila kartë njërin kënd do ta ketë në formë harkore. - Secila kartë në njërën anë e ka një fjalë dhe në tjetrën një fjali që përmban atë fjalë - Ofertuesi do të marrë nga porositësi listat e fjalëve dhe fjalive. - Kartat duhet të kenë kutitë e veta 	
3	<p>Komplet i kartave me shkronja të vogla të shtypit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komplet i përmban 50 karta - Dim. i kartave është 8 x 5 cm. (letër gloss 200 gr.) - Secila kartë në njërën anë e ka shkronjën, ndërsa në tjetrën një fjalë që fillon me atë shkronjë dhe figurën e asaj fjalë. - Ofertuesi do të marrë nga porositësi listën e fjalëve për secilën shkronjë. - Kartat duhet të kenë kutinë e vet 		6	<p>Spango për tharje të rrobave me kapëse</p> <ul style="list-style-type: none"> - Spango në gjatësi prej 5 metra - Komplet prej së paku 30 kapëseve 	
7	<p>Kuti plastike</p> <p>Dim. e përafërta 40 x 30 x 17 cm.</p>				

Lista e fjalëve kryesore për t'u mësuar në klasën I dhe II

k1 s1	k1 s2	k2 s1	k2 s2
ai	asaj	afër	andej
ajo	aty	art	ashtu
ata	bën	atje	bardhë
ato	cila	bukur	bashkë
bëj	cili	dëgjoj	buzëqesh
dje	dal	duhet	çfarë
dy	dhe	ecte	dashuri
flej	dhjetë	është	desha
ha	di	faleminderit	dëshiroj
jam	disa	flet	dhashë
janë	do	humb	do të
je	dola	im	fshij
jemi	dua	ime	gjatë
jeni	eci	isha	gjelbër
ju	edhe	jap	hëngraj
ka	eja	kë	hyj
kam	erdha	ky	jonë
kanë	flas	laj	juaj
katër	fliste	larg	kaltër
ke	gjashtë	leh	këndeje
këtu	gjej	lehtë	kështu
ku	hap	mbyll	këta
kur	kaloj	më fal	këto
luaj	kap	mendoj	kishte
marr	keq	mirupafshim	kuqe
me	këtë	mua	ndaloj
më	kjo	mund	ndër
mire	kujt	ndërtoj	ndihmoj
ne	lexoj	notoj	ngas
në	madh	ose	nget
nesër	mbi	pastroj	ngrohtë
një	mori	por	njëzet
pa	nën	prapa	pashë
pak	nëntë	punova	pastaj
pas	nga	pushoj	plotësoj
pesë	nuk	qaj	poshtë
prej	para	qesh	prek
punoj	pi	ruaj	rëndë
që	rri	saktë	shpejt
sa	sepse	shëtit	shpejtoj
së	shtatë	shikoj	tanë
shkoj	shumë	shkova	them
shoh	tetë	shkruaj	tonë
si	tij	të lutem	ujit
sot	tregoj	thashë	vendos
tani	tyre	ulem	verdhë
të	vetë	vesh	vetëm
ti	vogël	vjetër	vizatoj
tre	vrapoj	vonë	yte
unë	zero	ynë	zi


Burimet online për lexim dhe shkrim

LIBRAT E NIVELIZUAR


bletapunetore.org



ARKA E THESARIT




LIBROTEKA



Teknika për krijimin e librave


Libri i thjeshtë për nxënësit e klasave 1-5

Hapi i parë




Palosen fletët në dysh dhe bashkohen të gjitha së bashku.

Hapi i dytë




Me gërshërë presim një formë trekëndëshi të vogël nga skajet e fletëve dhe mesi i fletëve.

Hapi i tretë




Marrim njëlidhëse ose shirit zbukurues dhe e kalojmë nga ana e brendshme nëvrimën e mesit - nëmënyrëqë dy pjesët e shiritit të takohen nga ana e jashtme e vrimës së mesme.

Hapi i katërt



Dy pjesët e lidhëseve bashkohen dhe lidhet një fjongo.

Përgatitja e librave me kopertinë të fortë




Hapi parë:

Dy copat letre të trashë (kartuç) priten në pjesëtë barabarta.

Hap i dytë:

Dy copat e kartuçit vendosen në njëmbështjellës (p.sh. pjesë tekstili ose mbështjellësdhuratash) dhe mbështillen me këtë mbështjellës i cili paraprakisht është lyer me ngjites. Në mes të kartuçave duhet të lihet pak hapësirë në mënyrë që të mund ta mbyllim kopertinë kur në të t'i vendosim fletët e tjera.

Hapi i tretë




Merren letrat dhe palosen të gjitha në dysh. Duhet pasur kujdes që letrat të kenë madhësimet e vogël se kopertina, sepse ato do të shërbejnë si "fletë libri". Pas palosjes në dysh, të gjitha letrat bëhen bashkë, kapen me kapëse që të mos lëvizin dhe në mes iu shpohen vrimat nëpërtë cilat do të kalojë peri.

Hapi i katërt


Lyeni pjesën e brendshme të kopertinës dhe në të ngjiteni një fletë, e cila pastaj do të të ngjitet me fletën e parë të 'fletëve të librit' që kemi përgatitur. Lyeni me ngjites fletën që keni ngjitur në kopertinë dhe ngjiteni atë me fletën e parë të fletëve të palosura (fletëve të librit).

Krijimi i librave të thjeshtë me penj dhe gjilpërë

a.




b.




Hapi i parë:

Disa fletë (sasia sipas dëshirës) i palosim në mes (Fig. a) dhe i grupojmë në një vend (Fig. b).



Hapi i dytë:

Në mes të këtyre fletëve të bashkuara shpojme pesë vrima me largësi të njëjtë nga njëra-tjetra.



Hapi i tretë:

Fillon "qepja" me pe e gjilpërë. Fillohet nga vrima e mesit, duke e lënë një pjesë të perit jashtë (shih vizatimin).

Krijimi i librave me formuese (në anglisht “pop-upbooks”)



1

2

3

Fletët i palosni në dysh - një fletë apo disa fletë në të njëjtën kohë. Në fletët e palosura vizatoni dy vija me gjatësi të barabartë si në fig. 3.



4

5

6

I prisni fletët nëpër vijat e vizatuara, paloseni pjesën e prerë (fig. 5) dhe shtypeni skajin e pjesës së palosur (fig. 6)



7

8

9

Pjesën e prerë e ktheni prapë në pozitën e vet, letrën e hapni si kulm shtëpie (fig. 8) dhe pjesën e prerë e futni brenda letrës (fig. 9)





10

11

12

Mbylleni letrën, shtypeni (fig. 11) dhe pastaj hapeni fletën, e në pjesën e brendshme të saj do të keni fituar një shtresë në formë karrigeje (fig. 12) e cila do të ju shërbejë si mbajtëse për figurat tuaja dhe në këtë mënyrë do të krijoni librin tuaj me formuese (pop upbook) sinë figurën 13.

13

Figurat që përdorni për të krijuar forma brenda librit mund të jenë të ndryshme, varësisht prej temës që keni zgjedhur për librin tuaj me formuese (pop upbook).



14

Një ide tjetër për të krijuar libër me formuese mund të jetë forma e paraqitur në fig. 14

Disa nga faqet e internetit ku mund të gjeni ide dhe teknika tjera të krijimit të librave:

<http://www.artistshelpingchildren.org/bookmaking-crafts-make-books.html>

<http://pinterest.com/adcreek/book-binding-creative-binding-ideas/>

<http://www.youtube.com/playlist?list=PL2F704E01F80BA1E9>

Poashtu, mund të kërkoni në Google apo You Tube me fjalën BOOKBINDING, pasi që në gjuhën angleze kërkimi ju jep më shumë rezultate.

Shembull i tekstit për të kuptuarit me pyetje dhe shpjegime

Kompjuteri

Ishte dita e parë e javës. Ora e parë e mësimit filloi si zakonisht. Mësuesi ua tërhoqi vëmendjen nxënësve tek tabela e librave të lexuar. Të gjithë nxënësit kishin shënuar titujt e librave që i kishin lexuar gjatë muajit. Vetëm rubrika e Tonit ishte e zbrazët. Toni kishte ulur kokën dhe bëntesikur nuk dëgjonte. Kur i erdhi radha të fliste, ai tha me zë të ulët se nuk e kishte respektuar orarin e vet ditor. Mësuesi kërkoi të kuptojë arsyen. Toni me gjysmë zëri u përgjigj se kishte kaluar shumë kohë në kompjuter. Atëherë mësuesi e pyeti nëse kishte mësuar ndonjë gjë të re nga kompjuteri. Toni i ngazëllyer nisi menjëherë të tregontese kishte luajtur lojëra matematikore të cilat i kishin pëlqyer shumë. Mësuesit i erdhi mirë që nuk e kishte kaluar kohën kot së koti në kompjuter. Atëherë i erdhi një ide. U drejtua nga nxënësit dhe u tha se për detyrë shtëpie kishin për të lexuar në kompjuter për temën që u intereson më së shumti.

Toni buzëqeshi dhe tha me vete "kompjuteri mund të jetë shumë i dobishëm kur përdoret me arsye".

1. Çfarë ditë ishte? (ehënë)
2. Cila orë e mësimit filloi?(ora e parë)
3. Për çfarë u shërbente tabela e librave? (për të mbajtur shënime për librat e lexuar, lektura)
4. Çka kërkoi mësuesi nga nxënësit? (të shikojnë nga tabela e librave)
5. Rubrika e kujt ishte e zbrazët? (e Tonit)
6. Pse ishte e zbrazët rubrika e Tonit? (sepse nuk kishte lexuar asnjë libër gjatë muajit)
7. Si u arsyetua Toni? (nuk e ka respektuar orarin e vet ditor)
8. Pse nuk e ka respektuar Toni orarin e vet ditor? (ka kaluar shumë kohë në kompjuter)
9. Çka kishte bërë Toni në kompjuter? (kishte luajtur lojëra matematikore)
10. Simendoni, a ka vepruar mirë Toni? (po/jo, pse?)
11. Si u ndje para mësuesit dhe nxënësve? (në fillim keq, pastaj i ngazëllyer)
12. Pse u ndje keq e pse i ngazëllyer? (nuk kishte lexuar dhe kishte ushtruar matematikë)
13. Çfarë ideje i erdhi mësuesit? (t'u jepte detyrë shtëpie të lexonin në kompjuter)
14. Kur vendosi mësuesi t'u jepte detyrë shtëpie të lexonin në kompjuter? (pasi dëgjoi që Toni kishte luajtur detyra matematike në kompjuter)
15. Pse Toni qëndroi kokulur? (sepse nuk e kishte lexuar librin)
16. Pse Toni fliste me zë të ulët? (sepse ndihej keq)
17. Si reagoi Toni kur mësuesi e pyeti nëse kishte mësuar diçka të re nga kompjuteri?(filloi të flistei ngazëllyer)
18. A mendoni se duhet te rrimë gjatë në kompjuter? Pse? (jo)
19. Pse bëhej Toni kinse nuk po dëgjonte? (sepse i vinte keq)
20. Pse i erdhi mirë mësuesit për kohën që kishte kaluar Toni në kompjuter? (sepse kishte ushtruar matematikë)
21. Si mendoni se i kishte gjetur Tonit këto aktivitete matematikore? (ka hulumtuar në kompjuter)
22. Pse në këtë rast mësuesi nuk e qortoi, por vetëm e këshilloi? (sepse nuk e kishte kaluar kohën kot)
23. Si do të vepronit ju në vend të Tonit?
24. Si ndiheni ju kur nuk i kryeni detyrat e shtëpisë?(keq, të mërzitur, të penduar)
25. A ju ka ndodhur ndonjë rast i ngjashëm me të Tonit?(po,jo)
26. Tregoni për një ngjarje të tillë.(varësisht nga nxënësi)

PJESA 10: Referenca

Leximi dhe Hulumtime rreth Leximit / Reading and Reading Research

Starting Out Right: A Guide to Promoting Children's Reading Success. Available from ERIC: <http://www.eric.ed.gov/PDFS/ED439781.pdf>

Report of the National Reading Panel. Teaching children to read. <http://www.nationalreadingpanel.org/Publications/summary.htm>

National Institute for Literacy (2006). A Child Becomes a Reader. http://www.taadas.org/publications/prodimages/a_child_becomes_a_reader-kindergarten_through_grade_3.pdf

Mësimdhënia e Leximit / Teaching Reading

Reading Rockets (n.d.). Classroom Strategies. <http://www.readingrockets.org/strategies/>

What Does Excellent Reading Instruction Look Like in Elementary Classrooms? April, 2008

The Essentials of Early Literacy Instruction. National Association for the Education of Young Children. <http://www.naeyc.org/files/yc/file/200303/Essentials.pdf>

Dëgjim-Kuptimi / Listening Comprehension

Let's Talk about Listening. Ontario, Canada. http://www.edu.gov.on.ca/eng/literacynumeracy/inspire/research/Talk_about_listening.pdf

Listening. Chapter 2 of Language Arts Essentials. Pearson. http://www.pearsonhighered.com/assets/hip/us/hip_us_pearsonhighered/samplechapter/0131720066.pdf

Education Scotland. Experiences and Outcomes, Literacy and English, Listening and Talking. <http://www.educationscotland.gov.uk/myexperiencesandoutcomes/languages/literacyandenglish/listeningandtalking/index.asp>

Oral Comprehension Sets the Ceiling on Reading Comprehension. *The American Educator*, Vol 27 No. 1, Spring 2003. <http://www.aft.org/newspubs/periodicals/ae/spring2003/hirschsboral.cfm>

Vetëdija Fonemike / Phonemic Awareness

Phonemic Awareness and the Teaching of Reading: A Position Statement from the Board of Directors of the International Reading Association <http://www.reading.org/General/AboutIRA/PositionStatements/PhonemicAwarenessPosition.aspx>

'Phonemic awareness instruction helps children learn to read: evidence from the National Reading Panel's meta-analysis', *Reading Research Quarterly* 36.3, 2001, pp. 250–287

Reading Rockets (n.d.). Reading 101: Phonemic Awareness. <http://www.readingrockets.org/teaching/reading101/phonemic/>

What Are the Best Practices in Phonemic Awareness Instruction? <http://www.appstate.edu/~kopenhagen/rcoe/s10/5710/q1/PAinstrucAshley.pdf>

Fonetika / Phonics

Phonics and Word Recognition Instruction in Early Reading Programs: Guidelines for Accessibility. <http://www.idonline.org/article/6316>

Strategies to Develop Phonics Skills. Portsmouth, NH: Heinemann. <http://www.heinemann.com/shared/onlineresources/e00356/chapter4.pdf>

Teaching the Alphabetic Code: Phonics and Decoding. (November, 2000). Every Child Reading: A Professional Development Guide.<http://www.readingrockets.org/article/275/>

Phonics and early reading: an overview for headteachers, literacy leaders and teachers in schools, and managers and practitioners in Early Years settings. <http://core.roehampton.ac.uk/digital/general/teachphon.pdf>

Rrjedhshmëria / Fluency

Five surefire strategies for developing reading fluency. <http://www.scholastic.com/teachers/article/5-surefire-strategies-developing-reading-fluency>

Reading Fluency.Macmillan/McGraw-Hill. http://activities.macmillanmh.com/reading/treasures/html/Hasbrouck_Author_paper.pdf

Oral reading fluency norms: A valuable assessment tool for reading teachers. *The Reading Teacher* Vol. 59, No. 7 April 2006, (pp. 636–644),

Reading Fluency: Building Capacity for Comprehension. Ontario, Canada. http://www.edu.gov.on.ca/eng/literacynumeracy/inspire/research/reading_fluency.pdf

Fluency: Instructional Guidelines and Student Activities.Texas Education Agency (2002). <http://www.readingrockets.org/article/3416/>

Fjalori / Vocabulary

Learning to Read Words: Theory, Findings, and Issues. *Scientific Studies of Reading*, 9(2), 167–188

Development of Sight Word Reading: Phases and Findings. (Blackwell Handbooks of Developmental Psychology) <http://www.pitt.edu/~perfetti/PDF/Ehri.pdf>

The Importance of Early Vocabulary for Literacy Achievement in High-Poverty Schools. 13:426–451, 2008. <http://josephrodgers.wiki.westga.edu/file/view/Vocabulary.pdf>

Vocabulary Development During Read-Alouds: Primary Practices. 63(3), 202-211. <http://www.readingrockets.org/article/39979/>

Strategies for Vocabulary Development.Prentice Hall e-Teach:http://www.phschool.com/eteach/language_arts/2002_03/essay.html

A Precision Teaching Approach to Teaching Sight Vocabulary and Improving Fluency.<http://www.education.ie/en/Education-Staff/Information/NEPS-Literacy-Resource/NEPS-Resource-Precision-Teaching-Approach.pdf>

Shared Reading: An Instructional Strategy for Teachers Grades K–3 <https://www.ocps.net/cs/services/cs/curreas/read/IR/bestpractices/SZ/Shared.Reading.pdf>

How Words Are Learned Incrementally Over Multiple Exposures(PDF). *The American Educator*, Vol 27 No. 1, Spring 2003. http://www.aft.org/pdfs/americaneducator/spring2003/AE_SPRNG.pdf#page=6

Word Walls. Available from: <http://www.edu.gov.on.ca/eng/studentssuccess/thinkliteracy/files/ThinkLitWordWalls.pdf>

Lexim-Kuptimi / Reading Comprehension

Seven Strategies to Teach Students Text Comprehension<http://www.readingrockets.org/article/3479/>. *Put Reading First: The Research Building Blocks for Teaching Children to Read*, pp. 49-54. http://www.nifl.gov/partnershipforreading/publications/reading_first1text.html.

Strategies That Work: Teaching Comprehension for Understanding and Engagement 2nd Ed. Portland, Maine, USA

QAR: Enhancing comprehension and test taking across grades and content areas. *The Reading Teacher*, 59, 206-221.

Improving reading comprehension in kindergarten through 3rd grade: A practice guide (NCEE 2010-4038). U.S. Department of Education. www.whatworks.ed.gov/publications/practiceguides

Proof, practice and promise: Comprehension strategy in the primary grades. *The Reading Teacher* Vol. 57 No. 7, pp. 598-609, April 2004

Të Shkruarit / Writing

Teaching elementary school students to be effective writers: A practice guide (NCEE 2012- 4058). U.S. Department of Education. http://ies.ed.gov/ncee/wwc/publications_reviews.aspx#pubsearch

Early Childhood Building Blocks: Writing in Preschool. http://rec.ohiorc.org/orc_documents/orc/recv2/briefs/pdf/0005.pdf

A Guide to Effective Instruction in Writing, Kindergarten to Grade 3 http://www.eworkshop.on.ca/edu/resources/guides/Guide_Writing_%20K_3.pdf

Developing Early Writing: The National Literacy Strategy, London. <http://www.eric.ed.gov/PDFS/ED472275.pdf>

The Teachers College Reading and Writing Project <http://readingandwritingproject.com/>

Lexuesit me Vështirësi / Struggling Readers

Assisting students struggling with reading: Response to Intervention and multi-tier intervention for reading in the primary grades. U.S. Department of Education. <http://ies.ed.gov/ncee/wwc/publications/practiceguides>

Preventing reading difficulties in young children. Washington, DC: National Academy Press. http://www.nap.edu/catalog.php?record_id=6023

Seeking Help for a Struggling Reader: Seven Steps for Teachers. <http://www.readingrockets.org/article/4528/>

Effective Interventions for Struggling Readers. NEPS Good Practice Guide. <http://www.education.ie/en/Publications/Education-Reports/Effective-Interventions-for-Struggling-Readers-A-Good-Practice-Guide-for-Teachers.pdf>

Motivimi dhe Përfshirja e Prindërve / Motivation and Parent Involvement

A Child Becomes a Reader. Kindergarten through Grade 3. http://www.taadas.org/publications/prodimages/a_child_becomes_a_reader-kindergarten_through_grade_3.pdf

Reading Motivation: What the Research Says. <http://www.readingrockets.org/article/29624>

Educational Partnerships and Family Involvement Unit, *Reading Tips for Parents*, Washington, D.C., 2003. <http://www2.ed.gov/parents/read/resources/readingtips/readingtips.pdf>

The Scottish "Journey to Excellence" online resource page on "Developing parents' support for their children's learning": <http://www.journeytoexcellence.org.uk/partnership/improvementguides/developingparentssupportfortheirchildrenslearning.asp>

Vlerësimi Formativ / Assessing Formatively

Student Self-Assessment. Capacity Building Series, Literacy and Numeracy Secretariat, Ontario, Canada. <http://www.edu.gov.on.ca/eng/literacynumeracy/inspire/research/studentselfassessment.pdf>

Assessment for Learning Key Stages 1 and 2: Northern Ireland Curriculum http://www.nicurriculum.org.uk/docs/assessment_for_learning/training/afl-guidance-ks12.pdf

Response to Intervention in Primary Grade Reading: http://dww.ed.gov/Response-to-Intervention-Reading/topic/index.cfm?T_ID=27

Aspekti Gjinor / Gender

Gender bias in textbooks: a hidden obstacle on the road to gender equality in education. *Education for All Global Monitoring Report 2008 Education for All by 2015: will we make it?*

Gender and Reading Preferences. *Young Adult Literature Exploration, Evaluation, and Appreciation*, by K. Bucher, M. L. Manning, 2006 edition, p. 44-45.

How to Reduce the Gender Gap in Reading Literacy. Department of Teacher Education and School Development, University of Oslo, Norway. <http://www.pisa.no/pdf/Nordisk%20rapport/kap3.pdf>

TH Q X SH Ë A LL XH Q X RR GJ
A Z GJ V X S Z NJ V A S Z XH V X RR GJ
S L NJ DH S L GJ DH S L NJ DH S L NJ
C K O J T SH K O C K O J T SH K O C
T RR K O J T SH ZH JT RR K O J T SH
F I ZH G F XH ZH JT RR K O J T SH
P N H U B P N H U B P N H U B P N H
Ç XH TH R I Ç Y R XH TH R I Ç SH
LL Q E Y D Ë LL E RR TH Q E D Y Ë LL E Y